

DEREK PRINCE



BASHKËSHORTË  
& ETËR

Originally published in English under the title:  
Husband and Fathers  
Copyright 2000  
Derek Prince Ministries International  
All right reserved

Derek Prince Ministries – International  
P.O. Box 19501  
Charlotte, North Carolina, 28219-9501  
U.S.A.

Përkthimi në shqip botohet me leje nga  
Copyright 2000  
Derek Prince Ministries – International

Përkthimi: Rudina Straub  
Redaktoi dhe korektoi Hervin Fushekati dhe Iva Çipuri

Layout: Vernon Publishing  
Shtypi: Vernon Publishing  
Tiranë, Shqipëri 2011  
Tirazhi: 1500 kopje

Botimi 1. në shqip Prill 2011

ISBN 978-9928-104-03-8

# Përmbajtja

Parathënie 5

Pjesa 1: Nga jeta personale

1. Si u bëra baba 9

Pjesa 2: Bashkëshortë

2. Martesa është besëlidhje 17

3. Roli i bashkëshortit 27

4. Roli i bashkëshortes 35

5. Përbërësi që mungon 41

6. Autoriteti frymëror i një martese të harmonishme 49

Pjesa 3: Etër

7. Zbulesa më e lartë e Perëndisë 57

8. Ati si prift 67

9. Ati si profet 75

10. Ati si mbret 85

11. Portret i dy etërve 93

12. Kur etërit dështojnë 97

13. Ndoshta keni dështuar edhe ju? 107

14. Por ju mund të dilni me sukses! 115

15. Atësi frymërore 121

16. Ku janë etërit frymërorë? 133

17. Një fjalë për ata që nuk kanë etër 141



# Parathënie

Njerëzit u besojnë më shumë veprave të kryera, sesa fjalëve të thëna. Këtë mund ta themi edhe kur bëhet fjalë për Derek Prince. Ai ka futur jetën personale në veprën e tij dhe ne të gjithë përfitojmë nga kjo.

Dereku ka shkruar një libër të cilin babai, jo vetëm që duhet ta lexojë për vete, por duhet t'ia lexojë edhe gjithë familjes. Zoti e bekoftë që na sjell kaq afër të vërtetat e Perëndisë.

DR. EDWIN LOUIS COLE

Themelues dhe president i Rrjetit të Burrave Kristianë





Pjesa 1

# Nga jeta private





# 1

## Si u Bëra Baba

Kur hedh pas vështrimin te koha e fëmijërisë dhe rinisë sime, habitem sesi është e mundur të shkruaj sot këtë libër. Asokohe nuk dukej të kisha shumë cilësira për përballimin e një detyre të tillë.

Unë kam lindur në Angli, në gjirin e një familjeje ushtarakësh dhe isha fëmijë i vetëm. Me sa më kujtohet, çdo anëtar mashkull i rrethit tonë familjar kishte shërbyer si oficer në ushtrinë britanike. Në moshën nëntë vjeçare prindërit më dërguan në një shkollë private të veshur me kostumin karakteristik prej tuidi dhe me kapën në formë pjepri. Pas kryerjes së shkollës private u regjistrova në Eton dhe prej andej në Kolegjin Mbretëror të Kembrixhit. Pesëmbëdhjete vjet me radhë jetova në konvikte të ndryshme dhe kaloja jo më shumë se tre muaj të vitit në shtëpinë prindërore. Pas pesë vitesh studimi në Kembrixh, shkrova një disertacion me titull: “Zhvillimi i metodës së Platonit mbi përcaktimin” dhe u zgjedha për anëtarësi në Kolegjin Mbretëror. Gjatë gjithë periudhës së arsimimit mësuësit i kisha të gjithë pa përjashtim, burra. Në Kembrixh pata zënë disa shoqe, por mekanizmat e brendshëm të personalitetit femëror mbeten për mua një gjëzë, gjëzë të cilën nuk kisha ndonjë dëshirë të madhe ta zbërtheja!

Duke qenë student i një Universiteti me emër, kisha para vetes një rrugë të sigurt karriere, por kjo karrierë u ndërpre ashpërsisht nga fillimi i Luftës së Dytë Botërore. Kur u thirra në shërbimin ushtarak, zgjedha trupat joluftuese dhe mora përsipër një funksion në Korpusin Sanitar të Ushtrisë Mbretërore Britanike. Mora vendim që edhe në

ushtri të vazhdoja punën për karrierën time akademike duke studiuar Biblën, të cilën e vlerësoja si një vepër thjesht filozofike. Shumë pjesë të saj mezi i kuptoja, por i pata vënë vetes detyrë ta lexoja të gjithën, nga Zanafilla deri te Zbulesa. Vetëm kështu do të isha në gjendje të jepja një gjykim të pjekur rreth saj.

Pas rreth nëntë muajsh, diku aty nga libri i Jobit, pata një takim të papritur me Autorin e Biblës, i cili m'u zbulua në personin e Jezu Krishtit. Ky takim solli te unë një ndryshim rrënjësor për të gjithë jetën. Këtu e sipër m'u kujtua se edhe vetë Platoni ishte i detyruar të pranonte se, "Nuk kemi asnjë fjalë nga Perëndia", ndërkohë që Bibla pohonte pa ngurrim të ishte pikërisht kjo: "Fjala e Zotit". Sa më shumë e studioja atë dhe zbatoja në jetën time ç'ka lexoja, aq më shumë bindesha brenda vetes se ky pohim ishte i vërtetë. Këtu vërtet Perëndia i zbuloihej njeriut.

Pak më vonë ushtria më dërgoi në Lindjen e Afërme. Pasi kalova tre vjet nëpër shkretëtirat egjiptianë, libianë dhe sudanëze, më në fund u stacionova në Jeruzalem. Atje njoha dhe u martova me një mësuese nga Danimarka, Lydia Kristensen. Lydia gjendej mu në mes të një karriere të suksesshme si mësuese në sistemin shkollor shtetëror të Danimarkës, kur Zoti i foli të braktiste gjithçka dhe të shkonte në Jeruzalem. Atje ajo, e udhëhequr nga besimi, u kujdes për fëmijët jetimë.

Lydia solli me vete në martesën tonë tetë vajza jetime të cilat i kishte adoptuar. Qysh nga ky moment unë mora përsipër përgjegjësi atërore. Gjashtë vajza ishin me prejardhje izraelite, një arabe dhe një me prejardhje angleze. Vajzat ishin në moshat 3-18 vjeç. Mua, që s'kisha pasur kurrë ndonjëherë motra e vëllezër, me ra tani barra e përgjegjesisë për dhjetë gra – për Lydian, tetë vajzat e saj dhe për shërbyesën tonë arabe, Jameelen. Në fillim mezi u përshtatëm me situatën e re. Nganjëherë mendoja se kisha marrë një përgjegjësi tepër të rëndë mbi vete. Padyshim që edhe Lydia ka pasur momente kritike, kur i bënte vetes pyetjen nëse kish bërë mirë që ishte martuar me mua. Por gjithsesi, dashuria dhe hiri i Zotit na ndihmuan në atë periudhë të vështirë.

Përveç vështirësive që Lydia dhe unë kishim në marrëdhëniet tona si çift, gjendeshim nën një trysni të madhe edhe për shkak të

rrethanave të jashtme. Gjatë dy viteve të para të martesës përjetuam nga shumë afër lindjen e shtetit të ri të Izraelit. Në ato vite na u desh të braktisnim dy herë në mes të natës shtëpitë ku banonim, për të shpëtuar jetën. Dhe në të dyja rastet nuk patëm më mundësi të ktheheshim në ato shtëpi.

Një herë tjetër na ndanë nga katër vajzat tona më të rritura, por Zoti mbajti dorën e tij mbi ne dhe na solli në Angli të bashkuar si familje. Më vonë, pasi kishim mbetur vetëm me dy vajzat tona më të vogla (të tjerat ishin rritur tashmë dhe kishin zgjedhur rrugët e tyre në jetë), Lydia dhe unë shkuam për pesë vjet në Kenia, ku unë punoja si drejtor i një qëndre arsimimi për mësuesit afrikanë. Në këtë kohë ne adoptuam vajzën tonë të nëntë, një bebe të vogël afrikane, nëna e së cilës kishte vdekur gjatë lindjes. Vajzën e kishin gjetur në një kasolle, të shtrirë në dyshtemenë prej dheu.

Tre vjet pasi Zoti e mori Lydian pranë vetes, u martova me gruan time të dytë, Ruthin. Kaluam bashkë njëzet vjet martese, derisa edhe Ruthi shkoi në shtëpinë e Atit. Ruthi solli në familjen tonë tre fëmijë të adoptuar, të gjithë me prejardhje judaike. Prandaj unë sot kam lidhje atërore me një duzinë (12) njerëz.

Me natyrën e saj të ngrohtë dhe të përzemërt, Ruthi i fitoi shumë shpejt zemrat e anëtarëve të tjerë të familjes. Duke pasur aftësi të veçanta në fushën e administrimit dhe të redaktimit, ajo kontribuoi dhe plotësoi në mënyrë të shkëlqyer shërbesën time si mësues biblik. Gjatë njëzet vjetëve të martesës me Ruthin shërbimi im mori përmasa të cilat as që nuk i kisha përfytyruar ndonjëherë. Mësimi im biblik në formë librash, audiokasetash, videokasetash, emisionesh radiotelevizive, u përhap në të gjithë botën, deri në Antarktikë. Bashkëpunëtorët e mi më raportojnë në zyrë se materiali ynë ndërkohë dërgohet në të gjitha vendet ku lejohet posta amerikane dhe se shumë pjesë të materialeve janë përkthyer në gjashtëdhjetë gjuhë të ndryshme.

Familja jonë po rritet kaq shpejt, sa që unë nuk jam në gjendje ta ndjek. Po të llogaris edhe ata që janë shtuar me anë të martesave dhe të lindjeve, ne bëhemi 150 persona në numër! Anëtarët e familjes sonë jetojnë në vënde të ndryshme: Izrael, Britani e Madhe, Kanada, SHBA dhe Australi. Duke jetuar kaq të shpërndarë nuk kemi mundësi të

mbajmë atë kontakt të ngushtë që dëshirojmë. Megjithatë e ndjejmë se jemi një familje.

Unë nuk kam qenë bashkëshort dhe atë i përkryer. Por, në përgjithësi jeta ime familjare ka rrjedhur e lumtur dhe e suksesshme dhe për këtë gjithë nderi i takon Perëndisë. Gjatë viteve kam nxjerrë shumë mësimë dhe unë besoj se Perëndia dëshiron që me anë të këtij libri, ato që kam mësuar t'i ndaj me të tjerë.

Në të kaluarën, gjatë shërbimit tim frymëror ka pasur një kohë kur unë vija në rrezik planin e Perëndisë për martesën dhe familjen time. Asokohe udhëtoja vazhdimisht nga një takim në tjetrin dhe nga konferenca në konferencë, ku predikoja para shumë njerëzve të cilët reagonin pozitivisht ndaj fjalëve të mia. Një mbrëmje, në një nga këto konferenca, njëri nga folësit e tjerë përmendi ashtu si rastësisht: “Eksperti është një burrë me çantë aktesh në dorë, larg shtëpisë së vet.”

Këto fjalë më hynë thikë në zemër.

“Ky e ka fjalën për mua”, mendova. Unë jam ai burri me çantë aktesh në dorë, larg shtëpisë. Të gjithë më mbajnë për ekspert të mbaruar, ndërsa unë as që e kam idenë se ç'bëhet në shtëpinë time.

Perëndia më bëri një sfidë të re duke më treguar qartë se, së pari dhe mbi të gjitha, unë duhet të arrija sukses si bashkëshort dhe atë, në vend që të kërkoja suksesin diku gjetkë.

Kështu, nisa të analizoj motivet që më shtynin. Përse kaloja kaq shumë kohë në udhëtime? Përse e ndjeja veten kaq të stimuluar kur flisja nëpër takime? Dalëngadalë arrita të dalloj një element të fortë ambicieje personale në motivet e mia. Provoja shumë kënaqësi kur dilja në podium para publikut të gjerë. Ngrohësia nën diellin e namit të mirë që kisha fituar si folës “i vajosur”.

Duke i bërë analizën viteve që kisha kaluar në shërbesën frymërore publike, m'u bë e qartë se unë më shumë preokupohesha për të ruajtur emrin tim të mirë si predikues, sesa për nevojat personale dhe emocionale të Lydias. Shumë herë më interesonte sukcesi në shërbesë më shumë se mirëqenia e familjes sime.

Falë Zotit, puna nuk arriti kurrë deri aty sa të shpërthente ndonjë krizë serioze në familjen tonë. Po, në ato kohë familja më qëndroi shumë më besnike nga ç'e meritoja. Sot falenderoj Zotin për secilin prej

anëtarëve të saj! Që t'i bie shkurt, arrita në përfundimin se realizimi i ambicieve personale në kurriz të jetës familjare është një problem serioz në jetën e shumë burrave. Këta burra, bota i mban për shumë të aftë e të zotë dhe ata gjithashtu e mbajnë veten për të tillë. Por e vërteta është se ata kanë brenda vetes një bërthamë të fortë egoizmi, e cila i mban larg komunikimit të përzemërt dhe të përkushtuar brendapërbrenda familjes, larg atij komunikimi i cili përbën esencën e një marrëdhënieje të suksesshme familjare.

Ndoshta puna nuk arrin kurrë deri aty sa të ankohesh për krizë familjare dhe ndoshta as të shkon mendja se martesë jote ndodhet në rrezik, por shtëpia jote nuk ofron sigurinë dhe përmbushjen për të cilat kanë nevojë anëtarët e familjes. Shpesh babai ka aq shumë detyrime jashtë shtëpisë, sa që ai nuk e ka idenë se sa shumë e lë në baltë familjen e vet.

Unë jam i mendimit se në rrethanat e jetës së sotme, shumë burra duhen ballafaquar me këtë temë. Le të kenë ata sukses në shumë sfera – si bankierë të rangut të lartë, mjekë, avokatë, ekspertë kompjuterash apo lojtarë të zotë golfi. Po, madje mund të korrin goxha sukses edhe në shërbimin frymëror. Por, ama, në shtëpi kanë dështuar.

Po e them hapur mendimin tim: Kush korr sukses në shumë funksione por dështon si bashkëshort dhe atë, ai ka dështuar në sytë e Zotit. Këtë dështim nuk mund ta kompensojë asnjë sukses tjetër, sado i madh qoftë.

Kam pohuar shpesh se problemi kryesor i shoqërisë sonë qëndron te burrat që kanë harruar detyrimet. Ata dështojnë në sferat më të rëndësishme të përgjegjësisë: Si bashkëshortë dhe si etër.

Sot kemi mundësi të lexojmë libra të ndryshëm mbi martesën dhe familjen, por një familje me të vërtetë e suksesshme mund të ndërtohet vetëm atëherë kur të jenë kuptuar siç duhet këto dy funksione themelore: Bashkëshort dhe Atë. Ky është themeli i domosdoshëm i një vatre të lumtur dhe të harmonishme familjare.

Në këtë libër dua t'ju tregoj në mënyrë të thjeshtë dhe praktike se ç'është të jesh bashkëshort dhe atë i suksesshëm. Duke u nisur nga këto premisa, mund të arrini pastaj të keni me të vërtetë sukses në fusha të tjera të jetës. Por, para së gjithash, do të bëheni bekim për njerëzit më të afërt – për gruan dhe fëmijët tuaj.





Pjesa 2

# Bashkëshortë





## 2

# Martesa Është Besëlidhje

Për të trajtuar më tej temën mbi bas hkëshortët, po ia nis me martesën, sepse vetëm nëpërmjet martesës burri bëhet bashkëshort.

Tre lidhjet më të rëndësishme, të qëndrueshme njerëzore janë këto:

1. Lidhja e besimtarit me Perëndinë
2. Lidhja midis çiftit të martuar
3. Lidhja e besimtarëve me njëri-tjetrin

Fëmijët, që janë fryti i besëlidhjes midis burrit dhe gruas së tij, janë të përfshirë në qëllimin e kësaj besëlidhjeje të bërë nga prindërit me Perëndinë.

Në bazën e çdo marrëdhënieje qëndron një besëlidhje, forma më solemne dhe lidhëse e përkushtimit të përkruar në Bibël. Sipas parimeve biblike, pa besëlidhje nuk mund të krijohet një marrëdhënie e qëndrueshme.

Dy vargje nga Bibla na bëjnë të qartë se martesa është besëlidhje.

“(Dituria ka) për të të shpëtuar nga gruaja e tjetrit, nga e huaja që përdor fjalë mikluese, që ka braktisur shokun e rinisë dhe ka harruar besëlidhjen e Perëndisë”

(Fja. 2:16-17)

## Bashkëshortë

Ky varg flet për faktin se një grua jobesnike ndaj burrit të vet, harron ose thyen besëlidhjen që ka bërë me këtë burrë para Perëndisë. Sipas kësaj, martesë është një besëlidhje e bërë midis burrit dhe gruas para Perëndisë.

Edhe te libri i Malakias, Perëndia thotë se martesë është një besëlidhje. Izraelitët ishin ankuar tek ai: “Ne po lutemi gjithë kohën. Mbetëm vazhdimisht në tempull. Përse ti nuk i dëgjon lutjet tona?” Perëndia ua kthen:

“Megjithatë ju thoni :”Përse?” Sepse Zoti është dëshmitar midis teje dhe bashkëshortes së rinisë sate, ndaj së cilës je sjellë me pabesi, ndonëse ajo është shoqja jote dhe bashkëshorte e besëlidhjes sate.”

(Mal. 2:14)

Në këtë pasazh Perëndia u drejtohet burrave të cilët kanë vepruar pabesisht ndaj grave të tyre, ose për ta thënë më copë, që kanë tradhëtuar gratë e tyre. Perëndia thotë: “Nuk ka rëndësi se sa shpesh lutesh ose sa herë shkon në bashkësi. Nëse ti nuk i përmbahesh detyrimit të besëlidhjes kundrejt gruas sate, unë nuk kam për t’i dëgjuar lutjet e tua.” Perëndia thotë se burra të tillë thyejnë besëlidhjen.

Për këtë arsye, si për burrin, ashtu edhe për gruan, vlen fakti se kushdo qoftë ai që shkel besnikërinë e betimit martesor, thyen një besëlidhje. Prandaj tradhtia bashkëshortore është një mëkat shumë më i rëndë sesa sjellja e përdalë. Sjellja e përdalë – një marrëdhënie e pamoralshme e dy personave të pamartuar – është mëkat por nuk cënon ndonjë besëlidhje. Ndërsa tradhtia bashkëshortore është një sjellje e pamoralshme e cila thyen një besëlidhje dhe për këtë arsye është një mëkat shumë më i rëndë.

## E Fshehta e Besëlidhjes

Besëlidhja është një nga të fshehtat e Perëndisë. Një besëlidhje në aspektin biblik mund të kuptohet vetëm nëpërmjet një zbuluese. Vetëm Perëndia mund të na bëjë në gjendje të kuptojmë nga Shkrimi i Shenjtë se çfarë është besëlidhja. Psalmisti thotë:

## Martesa është një besëlidhje

“Sekreti i Zotit u tregohet atyre që kanë frikë prej tij dhe ai u bën atyre të njohur besëlidhjen e tij.”

(Psa. 25:14)

Pra, besëlidhja është një nga sekretet e Perëndisë dhe këtë sekret Ai ua zbulon vetëm atyre që jetojnë me frikën e Perëndisë në zemër. Njerëzit me frikë Perëndie në zemër arrijnë të kuptojnë dhe të hyjnë në një besëlidhje.

Tek Efesianëve 5:22-31 Pali thotë se marrëdhënia bashkëshortore midis burrit dhe gruas është një shëmbëlltysë ose simbol për marrëdhënien midis Krishtit dhe bashkësisë së tij. Prandaj ai shton aty: “Ky sekret është i madh” ose “Ky mister është i madh” (vargu 32). Tani le të shohim se ç’do të thotë saktësisht fjala “sekret” apo “mister”, ashtu siç e përdor Pali në këtë pasazh.

Në kohën e atëhershme ekzistonin të ashtuquajturat “Besime (sekte) të mistershme”. Këto sekte i ofronin sekrete të veçanta vetëm atyre që i nënshtroheshin një procedure pranimit të mbikëqyrtur rreptësisht. Nëse nuk kishe kryer procedurën e pranimit, nuk mund t’i mësoje sekretet e tyre. Kur Pali e cilëson martesën si një mister, kjo do të thotë ndër të tjera se, ne nuk mund të kuptojmë thelbin e saj të vërtetë nëse nuk i jemi nënshtuar atij procesi përkates të pranimit. Ky proces presupozon se dhëndri dhe nusja, në kornizën dasmore, bëjnë një besëlidhje me njëri-tjetrin dhe me Perëndinë. Ata nisin të kuptojnë thelbin e vërtetë të martesës vetëm kur tregohen të gatshëm të përmbushin detyrimet e kësaj besëlidhjeje. Çiftet që nuk janë të gatshëm të përmbushin këto kushte përjetojnë aspektin ligjor dhe fizik të martesës, ndërsa natyra e saj e vërtetë mbetet e fshehtë për ta. Pra, është dhe mbetet një mister – një sekret.

Këtu nuk duhet të harrojmë të përmendim se martesa nuk është thjesht një kontratë shoqërore e shpikur nga njeriu. Martesa është qysh nga fillimi dhe në radhë të parë, një koncept biblik. Ai që dëshiron të zbulojë misterin e martesës për veten e tij, duhet të ketë të qartë se çfarë nënkupton Bibla me fjalën “besëlidhje”. Prandaj, për ne është e dobishme që së pari të shqyrtojmë shkurtimisht në Bibël parimet që qëndrojnë në themel të çdo besëlidhjeje.

## Parimet e një Besëlidhjeje

Duke u bazuar te disa pasazhe nga psalmet, nga letra drejtuar hebrejve dhe nga libri i Zanafillës bëhet e qartë mënyra sesi Perëndia zbulon natyrën e besëlidhjes.

Citati i mëposhtëm nga psalmet tregon se me cilët persona bën besëlidhje Perëndia:

“Ai (Zoti) do të thërresë qiejtë nga lart dhe tokën për të gjykuar popullin e tij, dhe do të thotë: ‘Mblidhni shenjtorët e mi, që kanë lidhur një besëlidhje me mua me anë të flijimit’ ”.

(Psa. 50:4-5)

Cilët janë besimtarët, shenjtorët e Perëndisë? Bibla thotë se janë ata që kanë bërë me Të një besëlidhje mbi bazën e një flijimi. Çdo besëlidhje kërkon një flijim.

Hebraishtja nuk përdor termin “bëj besëlidhje”, por “pres një besëlidhje”. Kjo shprehje e figurshme të çon në mendje një thikë e mprehtë dhe gjak që derdhet. Kjo na kujton edhe një herë se një besëlidhje kërkon flijim dhe se flijimi është dhënie e gjakut dhe jetës.

Te Hebrejve 9:16-17, autori thotë se një testament hyn në fuqi vetëm atëherë kur personi që e ka hartuar, vdes. Fjala greke për “testament” quhet “diatheke”: kjo është fjala normale greke për termin tonë “besëlidhje”. Nëse e përkthejmë në këtë mënyrë, këto vargje nxjerrin në pah një fakt me rëndësi thelbësore përsa i përket konceptit të besëlidhjes.

“Sepse atje ku ka një testament duhet të ketë medoemos edhe vdekje të trashëgimlënësit. Testamenti është i vlefshëm vetëm pas vdekjes, sepse nuk ka kurrfarë fuqie deri sa trashëgimlënësi ende rron”.

Kur bëni një besëlidhje, ju faktikisht nënshkruani dënimin tuaj me vdekje! Ky është një akt serioz dhe solemn, dorëzim përfundimtar.

Efektin e jashtëm të një marrëdhënieje mbi bazën e besëlidhjes e shohim qartë në jetën e Abrahamit. Zoti dhe Abrahami kishin një marrëdhënie të mrekullueshme personale me njëri-tjetrin. Një natë, Perëndia i tha Abrahamit se do t’i jepte si trashëgimi vendin e Kanaa-

## Martesa është një besëlidhje

nit. Abrahami e pyeti: “Zot, Zot, nga mund ta di unë që do ta kem si trashëgim?” (Zan. 15:8). Perëndia iu përgjigj Abrahamit me anë të besëlidhjes së prerjes (therjes).

Me fjalë të tjera: Premtimi përfundimtar i Perëndisë në çdo fushë është besëlidhja. Ku Perëndia bën një besëlidhje, puna është krejtësisht e përfunduar.

Në “prerjen” e kësaj besëlidhjeje Perëndia i tha Abrahamit të bënte një gjë që në ato kohëra ishte fare e zakonshme ndër popujt e Lindjes së Afërme: në fillim thereshin kafshë të caktuara, pastaj ato ndaheshin përgjysmë dhe të dy gjysmat vendoseshin të shtrira në një largësi të caktuar nga njëra-tjetra. Pas kësaj, të dyja palët që kishin bërë bashkë një besëlidhje, kalonin midis këtyre dy gjysmave të flijimit. Bibla nuk na jep sqarime për kalimin e Abrahamit midis dy gjysmave të flijimit, por përshkruan kalimin e Perëndisë në mes:

“Por me të perënduar dielli dhe me të zbritur errësira, u duk një furrë që nxjerr tym dhe një pishtar i zjarrtë që kalon përmes kafshëve të ndara.”

(Zan. 15:17)

Vetë Perëndia kaloi në atë flakë zjarri midis dy gjysmave të flijimit. Te Hebrejve 12:29 rikujtojmë se Perëndia është “zjarr gllabërues”.

Ç’do të thotë të kalosh midis dy gjysmave të flijimit? Do të thotë se kalon midis flijimit, shikon trupat e vdekur dhe thua: Kjo është vdekja ime. Tani e tutje unë jam i vdekur ndaj vetvetes dhe jetoj vetëm për atë me të cilin kam bërë besëlidhjen. Abrahami hoqi dorë nga jeta e vet për të jetuar në besëlidhje me Perëndinë. Por mos harroni se edhe Perëndia bëri po të njëjtën gjë për Abrahamin.

Në një besëlidhje, seicili nga palët pjesëmarrëse ka të drejtë të pretendojë të ketë atë që i përket tjetrit. Dhe me të vërtetë, duke u bazuar te besëlidhja, Zoti më vonë i tha Abrahamit:

“Merr tani birin tënd, birin tënd të vetëm, atë që ti do, Isakun, shko në vendin e moriahëve dhe ofroje si holokaust në një nga malet që do të të tregoj”

(Zan. 22:2).

Abrahami e mbajti besëlidhjen. Ai as nuk debatoi e as nuk nguroi, por tha: “Si të duash ti, o Perëndi, ja ku më ke. Do të shkoj atje dhe do ta bëj flijimin”. Herët në mëngjesin tjetër ai u ngrit dhe shkoi te vendi i caktuar.

Por në çastin e fundit, kur Abrahami kishte ngritur thikën për ta futur në trupin e të birit, Zoti i tha: “Mirë, Abraham, s’ka nevojë ta bësh këtë gjë. Tani e di se ti ke frikë prej meje, sepse nuk kurseve as birin tënd të vetëm. Çfarë besëlidhjeje!

Veçse kjo histori nuk mbaron me kaq. Gati 2000 vjet më vonë, Zoti tha: “Abrahami dhe pasardhësit e tij kanë nevojë për një flijim. Për këtë flijim ekziston vetëm një person i përshtatshëm – Biri Im. Abrahami ishte i gatshëm të flijonte birin e vet. Tani do të flijoj unë Birin Tim për të”. Kjo ishte ana tjetër e besëlidhjes së bërë mbi malin Moria. Perëndia Atë dha Birin e Tij Jezus në Golgota si flijim mëkati. Ky qe flijimi i fundit dhe tërësisht i mjaftueshëm. Kështu Perëndia iu përmbajt detyrimeve të besëlidhjes që pati bërë.

Parë nga ky këndvështrim, historia botërore s’është gjë tjetër veçse vënie në jetë e besëlidhjeve që Perëndia bëri me popullin e tij. Nuk gjej dot fjalë të përshtatshme për të theksuar sa duhet domethënien dhe seriozitetin e një besëlidhjeje.

Tani le ta mbartim këtë kuptim mbi besëlidhjen bashkëshortore. Kur një burrë kristian dhe një grua kristiane martohen, ata kalojnë së bashku midis flijimit të Jezusit në kryq. Secili prej tyre thotë me Palin: “U kryqëzova bashkë me Krishtin; por rroj, jo më unë, po Krishti rron në mua...” (Gal. 2:20).

Pasi kanë shpallur detyrimin ndaj njëri-tjetrit, ata kthehen përsëri me vështrimin nga kryqi. Burri thotë: “Kur kalova midis këtij flijimi, unë vdiqa. Dhashë jetën. Tani këtë jetë që kam, e jetoj te ime shoqe. Ajo është shprehja e jetës sime”. Gruaja thotë po të njëjtën gjë: “Kur kalova midis këtij flijimi unë vdiqa. Tani nuk jetoj më për veten time, por jetoj për atë person me të cilin kam bërë besëlidhjen”. Secili prej tyre dorëzon jetën e vet për tjetrin. Kjo është baza e martesës kristiane dhe e vetmja bazë mbi të cilën mund të ketë sukses një martesë.

Për fat të keq, në kohët e sotme shumë njerëz kanë një qëndrim krejt të kundërt me atë ç’ka thashë më sipër. Sot, shumë njerëz hyjnë në marrëdhënie martesore duke i bërë vetes këtë pyetje: “Ç’përfitoj

## Martesa është një besëlidhje

unë nga kjo martesë?” Mirëpo kjo nuk shkon. Qëndrimi biblik është: “Çfarë mund të jap unë në këtë martesë?” Kjo po, ia vlen!

### Qëllimi i Besëlidhjes Martesore

Martesën nuk e shpiku Adami. Atij as që i shkonte mendja se kishte nevojë për një grua. Martesën e krijoi Perëndia. Atij i takon merita për të gjitha rregullat e martesës si dhe për qëllimin e saj të vërtetë.

Me martesën Perëndia dëshiron të vendosë unitet midis partnerëve. Por Bibla na e bën të qartë se ka vetëm një bazë për unitet të plotë midis njerëzve, qofshin këta burra, apo gra: besëlidhja. Bibla e përshkruan martesën si më poshtë:

“Për këtë arsye burri do të lërë babanë dhe nënën e vet dhe do të bashkohet me gruan e vet, dhe do të jenë një mish i vetëm.”

(Zan. 2:24)

Këto dy fjalë janë çelësi i martesës: “braktis” dhe “bashkoj”. “Bashkimi” nuk funksionon pa “braktisjen”. Nëse nuk jeni të gatshëm të braktisni mjedisin prindëror dhe t’ia nisni nga e para, nuk mund të arrini kurrë një unitet të vërtetë me partnerin. Në disa shoqëri martesat shpesh nuk funksionojnë, pasi në këto shoqëri thuhet se burri duhet të bashkohet me babanë dhe nënën dhe jo me gruan e tij. Detyrimi ndaj prindërve qëndron si pykë midis tij dhe gruas.

Duhet të kuptojmë patjetër se martesa, ashtu siç përshkruhet në Bibël, nuk është thjesht çështje e zakoneve shoqërore apo kulturore. Por sipas zakoneve të një shoqërie të caktuar, ka mënyra të ndryshme për nisjen e një martese ose festimin e një dasme. Për shembull, në Izrael judejtë kanë zakonet e tyre dasmore, arabët kanë të tjera dhe armenët prapë të tjera. Kjo është krejtësisht legjitime. Por natyra e martesës u përcaktua nga vetë Perëndia qysh në fillimin e historisë njerëzore: Burri do të braktisë babanë dhe nënën dhe do të bashkohet me gruan e vet. Kjo është e vetmja bazë mbi të cilën burri dhe gruaja arrijnë një unitet të mirëfilltë.

Sot qarkullon edhe një keqkuptim tjetër në lidhje me martesën. Shumë njerëz flasin dhe veprojnë sikur martesa të ishte një eksperi-

ment. Ky është gabim. Martesa është zotim, jo eksperiment. Është absurditet të flasësh për një “zotim eksperimental”.

Perëndia do t'i dhurojë Hirin e Tij burrit dhe gruas, që këta të jetojnë në unitet me njëri-tjetrin, vetëm kur të ekzistojë ky detyrim i ndërsjellë.

### Natyra Profetike e Martesës

Gjëja më madhështore te Perëndia i Biblës është se Ai ka gëzim t'u zbulohet njerëzve. Zbulesa e Atij vetë si person është një nga thesaret më të mëdha që Ai na dhuron. Kjo zbulesë na jepet në radhë të parë nëpërmjet Biblës. Por një privilegj edhe më i madh është kur Perëndia jo vetëm që na zbulohet, por dëshiron t'u zbulohet edhe të tjerëve nëpërmjet nesh.

Këtë Perëndia e ka bërë shpesh nëpërmjet profetëve të Dhjatës së Vjetër. Për të paralajmëruar banorët e Judesë nga robërimi i afërt, Perëndia e udhëzoi Jeremian të varte në qafë litarë dhe zgjedhë (krahaso Jer. 27:2). Për të përshkruar pushtimin e ushtrisë babilonase që i kanosej Jeruzalemit, Perëndia i tha Ezekielit të hapte një vrimë në mur dhe të bënte sikur po shpëtonte nga rrethimi (krahaso Eze. 12:4-5). Për të treguar faljen plot dashuri që Perëndia ka për Izraelin, Osea, me urdhër të Perëndisë, duhej të martohej me një prostitutë (krahaso Ose. 1:2). Dhe shembuj të tillë e të tjerë, ka plot.

Këtu një gjë bëhet e qartë: Ne mund të jemi profetë jo vetëm kur themi diçka, por edhe kur e tregojmë profecinë me veprimet tona. Duke e parë në këtë aspekt, martesa kristiane merr përsipër funksionin e një lajmi të mrekullueshëm profetik.

Së pari, marrëdhënia personale midis burrit dhe gruas së vet tregon atë lidhje uniteti të cilën mund ta sjellë vetëm një marrëdhënie e besëlidhur.

Por një martesë e mirëfilltë kristiane, përcjell edhe një tjetër lajm edhe më të mrekullueshëm. Pali thotë tek Efesianëve 5:25: “Ju, burra, duajini gratë tuaja, sikurse edhe Krishti deshi kishën dhe dha veten e tij për të”. Një bashkëshort i krishterë ka privilegjin ta dojë gruan e vet me të njëjtën dashuri plot sakrificë dhe përkushtim me të cilën Krishti do bashkësinë e vet.



## Martesa është një besëlidhje

Nga ana tjetër, Pali thotë tek Ef. 5:24: “Ashtu si kisha i nënshtrohet Krishtit, kështu edhe gratë t’u nënshtrohen burrave të tyre në gjithçka”. Për analogji, edhe gruaja e krishterë ka privilegjin të tregojë në marrëdhëniet me burrin e vet të njëjtën dashuri plot respekt që bashkësia ka për Krishtin, Zotin e saj.

Shoqëria e sotme nuk ka kohë të shpalojë të tilla qëndrime themelore të cilat burojnë nga dorëzimi i jetës personale. Prandaj është e rëndësishme që, të krishterët, në martesat e tyre, të pasqyrojnë me besnikëri marrëdhënien e dashurisë së Jezusit me bashkësinë e tij. Nganjëherë dëshmia e jetës sonë është më e efektshme sesa fjalët që nxjerrim nga goja. Ashtu si profetët e Dhjatës së Vjetër, edhe ne mund të jemi profetë jo vetëm me fjalë, por edhe me vepra.



# 3

## Roli i Bashkëshortit

Në fillim të historisë njerëzore Perëndia i dorëzoi Adamit, bashkëshortit të parë, një sferë të veçantë përgjegjësie: “Zoti Perëndi e mori, pra, njeriun dhe e futi në kopshtin e Edenit, me qëllim që ta punonte dhe ta ruante” (Zan. 2:15). Domethënia fillestare e fjalës “ruaj” është “mbroj”. Fjala moderne hebraike për “roje nate” rrjedh prej kësaj rrënje. Perëndia e bëri Adamin përgjegjës për “mbrojtjen” e kopshtit. Prej kujt duhej ta mbronte ai kopshtin? Prej gjithë kafshëve të fushës” (Zan. 2:20), që nuk e kishin vendin në kopsht. Menjëherë në kapitullin tjetër bëhet e qartë se Adami nuk qe në gjendje ta mbante këtë përgjegjësi. Gjarpri që ishte një “kafshë e fushës”, depërtoi në kopsht.

Detyra tjetër e Adamit ishte të mbronte gruan e tij nga sulmi hileqar i Satanit. Edhe te kjo detyrë ai dështoi. Shkrimi nuk na kallëzon se ku ndodhej Adami në atë çast kur gjarpri mashtroi Evën, por e qartë është se Eva u la vetëm.

Në këtë pikë, mëkati i Evës vetëm sa i shtohet mëkatit të Adamit. Ajo hyri në bisedë me gjarprin, iu nënshtrua tundimit të tij dhe hëngri frutin e ndaluar. I dha pastaj edhe të shoqit dhe ky gjithashtu hëngri.

Nga kjo del e qartë se dy mëkatet e para të historisë njerëzore ishin mëkate të lënies pas dore (indiferencë). Adami mëkatoi jo duke bërë diçka të caktuar, por duke lënë pas dore diçka të caktuar.

Mëkatet e lënies pas dore çuan pastaj te mëkati i kryer. Mëkatin e

tretë e kreu Eva, e cila e la veten të tundohej prej gjarprit dhe hëngri nga fruti i ndaluar. Përfundimisht tërhoqi aty dhe të shoqin, të cilit i dha po ashtu të hante nga ky frut. Mëkati i parë i burrit ishte mëkati i lënies pas dore – ai bëri faj. Mëkati i lënies pas dore të Adamit i hapi pastaj rrugën mëkatit të kryer nga Eva.

Na është bërë zakon të tregojmë butësi ndaj mëkateve të lënies pas dore, porse Bibla na nxjerr një tjetër tablllo para syve. Te Mateu 25:31-46 gjejmë një shëmbëllturyrë profetike të Jezusit mbi gjyqin përfundimtar ndaj kombeve të cilat paraqiten si “dele” apo si “cjepë”. Mbi “cjeptë” Ai shpall një nga gjykimet më të frikshme që janë shpallur ndonjëherë: “Largohuni nga unë, të mallkuar, në zjarr të përjetshëm, të përgatitur për djallin dhe engjëjt e tij!” (Vargu 41)

Ç’kishin bërë këto kombe për të merituar një gjykim kaq të tmerrshëm? Përgjigjja është fare e thjeshtë: asgjë! Ata nuk u dhanë të tjerëve asgjë për të ngrënë, asgjë për të pirë, asgjë për të veshur dhe nuk treguan dhembshuri! Por për këto mëkate të lënies pas dore (indiferencë e plotë), ata u mallkuan me mundimin e përjetshëm.

Modeli i dështimit të dyfishtë të Adamit dhe Evës do të përsëritet nga të gjithë brezat e mëvonshëm.

Mëkati primar, karakteristik i burrit është mëkati i lënies pas dore, jo mëkati i kryer. Ai dështon në përgjegjësinë që ka – së pari ndaj gruas së vet dhe pastaj ndaj gjithë familjes. Mëkati karakteristik i gruas qëndron në atë që ajo kapërcen kufijtë e autoritetit të saj dhe rrëmben në mënyrë të padrejtë funksionet e burrit. Dështimi i vazhdueshëm i burrit dhe gruas pasqyrohet te një varg pasojash fatkeqe, një prej të cilave është edhe lëvizja agresive feministe. Por rëndësi ka të kemi të qartë se gabimi i burrit vepron si një shkëndijë fillestare, e cila i jep shkas gruas të braktisë pozicionin e vet dhe të uzurpojë funksionet e burrit. Për mendimin tim, faji i burrave është problemi më i rëndë shoqëror në Botën Perëndimore. Po ashtu, edhe faji i prindërve ka për pasojë një rini që gjithashtu bën faje të rënda.

Dështimi i Adamit dhe Evës dëmtoi shumë përsosjen që Perëndia pati parashikuar për ta në marrëdhëniet me njëri-tjetrin. Por parimi themelor mbi të cilin duhej të ndërtohej marrëdhënia e tyre, mbeti në fuqi. Këtë parim unë po e quaj “parimi i ndërveprimit (relacionit) midis iniciativës dhe reagimit”. Sipas këtij modeli, Adami, bashkëshorti,

kishte përgjegjësinë për të ndërmarrë iniciativën, ndërsa Eva, gruaja e tij, kishte përgjegjësinë për të reaguar ndaj kësaj iniciative.

Dëshiroj ta konkretizoj këtë me anë të një shembulli praktik: Tek akti seksual burri shpesh është më i ngadaltë (flegmatik) dhe nuk shfaq ndonjë reagim të fortë, ndërsa gruaja përdor gjithë artin e vet femëror. Por në fund të fundit, akti i bashkimit kryhet vetëm kur burri ndërmerr iniciativën. (Kjo është edhe arsyeja pse shumë gra feministe preferojnë një stil “homoseksual” jetese. Ato nuk duan të jenë nën vartësinë e iniciativës së një burri). Unë besoj se Krijuesi këtë parim e mendoi si një model i cili duhet të riprodhohet në çdo aspekt të marrëdhënies midis partnerëve. Roli i burrit është të jetë iniciator dhe roli i gruas reagimi.

Por në shoqërinë e sotme ky parim i iniciativës dhe reagimit nuk ekziston më edhe në shumë aspekte të tjera të marrëdhënies midis dy sekseve. Burrat nuk marrin përsipër përgjegjësinë parimore dhe gratë marrin përsipër rolet e burrave. Pasoja e pashmangshme qoftë në një familje, në një komb apo në një qytetërim të tërë, përmblihet në një fjalë të vetme: Konfuzion (rrëmujë)!

## Sferat e Përgjegjesisë së Bashkëshortit

Cilat janë pikat qëndrore, në të cilat burri duhet të ndërmarrë iniciativën? Dhjata e Re përmend gjashtë sfera përgjegjësie.

### 1. Të dojë bashkëshorten

Ky nuk është as propozim e as rekomandim, por një urdhërim i formuluar qartë dhe prerë tek Efesianët 5:25: “Ju, burra, duajini gratë tuaja...” Konkretisht kjo do të thotë: Nëse nuk e doni gruan tuaj, tregoheni të pabindur ndaj Biblës.

Po në të njëjtin varg thuhet sesi duhet të duan: “...sikurse edhe Krishti deshi kishën dhe dha veten e tij për të”. Vini re se kjo dashuri nuk merr, por jep – ajo jep vetveten. Bashkëshorti duhet të ndërmarrë iniciativën duke u përkushtuar – ndaj gruas së vet dhe për gruan e vet.

Shoqëria jonë e sotme shpesh e kupton dashurinë si diçka thjesht emocionale. Por ky është një aspekt i pjesshëm. Dashuria e vërtetë

del në pah nëpërmjet një akti të vullnetit. Davidi, në Psalmin Davidi mori një vendim. Dashuria e tij për Zotin doli në pah nëpërmjet një akti të vullnetit.

Fjala “dashuri” e përdorur këtu nga Davidi, ka të bëjë me fjalën hebraike “të përbrendshmet” ose “bark nëne”. Është ajo që në gjuhën e sotme moderne e quajmë “ndjenjë e këndshme”. Prandaj në këtë dashuri janë përfshirë si vullneti, ashtu edhe emocionet. Dhe pikërisht këtë dashuri duhet të ketë edhe një burrë për gruan e vet.

Në kohërat biblike ishin prindërit ata që vendosnin se me kë duhet të martohesh. Në shumë pjesë të botës kjo praktikohet edhe sot. Por kjo nuk do të thotë se nuk ekzistonte një dashuri e thellë dhe e përzemërt midis burrit dhe gruas vetëm ngaqë martesë bëhej me ndërmjetës. Përkundrazi: vendet në të cilat martesat edhe sot e kësaj dite lidhen sipas modelit të sipërpërmendur sjellin përpjesëtueshmërisht më shumë martesë të suksesshme sesa i ashtuquajturi Perëndim “i lirë”, ku shkalla e divorceve përbën pothuajse pesëdhjetë për qind.

Kjo nuk do të thotë se unë jam ndonjë mbrojtës i flaktë i martesave me mblesëri. Me këtë dua të them se suksesi i një martese, në fund të fundit, nuk varet nga mënyra e lidhjes, por nga mënyra e sjelljes së burrit dhe gruas, kur këta martohen. Nëse këta të dy administrojnë me besnikëri sferat e përgjegjësisë të përcaktuara në Bibël, martesë do të jetë e suksesshme dhe bashkëshortet do ta duan sinqerisht njëri-tjetrin.

## 2. Kapja e sinjaleve

Bashkëshorti duhet të krijojë gjithnjë hapësirë, me qëllim që gruaja e tij të thotë e papenguar se çfarë e preokupon dhe ai duhet të tregojë sensibilitet për mendimet dhe ndjenjat e saj edhe kur ajo nuk shprehet dot me fjalë. Shpeshherë ndjenjat e saj të pashprehura janë ato më të fuqishmet dhe duhet të regjistrohen nga burri i saj me kujdesin më të madh. Presupozohet se mungesa e komunikimit është një nga faktorët më të mëdhenj përgjegjës për dështimin e martesës.

Burri nuk duhet të harrojë se gruaja e tij ka një lloj të veçantë mençurie, shpeshherë të cilësuar me fjalën “Intuitë”. Kështu, ka të ngjarë që ai, pas një procesi të lodhshëm mendimi, arrin në një përfundim dhe këtë ia parashtron gruas, e cila për çudinë e tij, i thotë: “këtë unë e dija qysh në fillim”.

### 3. Marrje vendimesh

Sapo të vendoset komunikimi i papenguar dhe plot respekt midis burrit dhe gruas, lind nevoja e marrjes së vendimeve praktike për shumë gjëra. Në këtë pikë, përgjegjësinë për të marrë vendimin përfundimtar e ka burri. Kur komunikimi bashkëshortor është i mirë, gruaja nuk e ka fare problem që kjo përgjegjësi mbulohet nga burri.

### 4. Aftësi vepruese

Kur merret një vendim, gjëja më logjike është që ky vendim të pasohet nga një veprim. Si rregull, e ka burri përgjegjësinë për të marrë masa që të zbatohet ky vendim. Edhe pse shpeshherë burri është i detyruar t'i ngarkojë gruas një numër detyrash të përditshme praktike (ai punon jashtë shtëpisë, ndërkohë që gruaja, duke qenë në shtëpi ka kohë për kryerjen e porosive), ai duhet të ketë kujdes dhe të mos ia veshë të tërë barrën gruas, sidomos kur çifti ka edhe detyra prindërore. Në këtë ndarje të punëve atyre mund t'u shërbejnë si orientim talentet frymërore të secilit. Përveç kësaj, gruaja duhet të ketë besim se burri e përkrah, kur ajo konfrontohet me një krizë të cilën nuk është e zonja ta përballojë vetëm.

### 5. "Ushqim dhe përkujdesje"

Për të përshkruar qëndrimin e burrit ndaj gruas së tij do të mjaftonte një fjalë: e veçantë. Çdo burrë duhet t'i thotë vetes: "Gruaja ime është njeri i veçantë. Asaj nuk i gjendet shoqja." Për këtë arsye ai duhet të ketë me të një lidhje që nuk e ka me asnjë grua tjetër. Kjo nuk vlen vetëm për sferën seksuale, por edhe për mënyrën sesi ai flet e mendon për të dhe për mënyrën se si e trajton. Pali thotë tek Efesianët 5:28-29, se burri duhet të kujdeset dhe ta doje gruan e tij në një mënyrë tepër personale:

"Kështu burrat duhet t'i duan gratë e tyre si trupat e tyre. Kush do gruan e vet, do vetveten. Sepse askush nuk e urreu kurrë mishin e vet, por e ushqen dhe kujdeset me ngrohtësi për të, sikurse edhe Zoti bën me kishën".

Këto dy fjalë, "ushqim" dhe "përkujdesje", shprehin një qëndrim

impenjimi shpirtëror, tek i cili përfshihet edhe vëmendja ndaj detajeve që duken disi të vogla e të parëndësishme. Burri duhet të tregojë interes për shëndetin e gruas, pamjen e saj të jashtme, llojin e frizurës dhe parfumin që ajo përdor. Çdo gjë që i takon asaj, duhet t'i takojë edhe atij. Gruaja duhet të ketë sigurinë se ajo është personi më i rëndësishëm në botë për burrin e saj.

Ju bashkëshortë, ju siguroj se po të "mbillni" një farë të tillë te gruaja juaj, do të "korrni" me shumë bollëk.

## 6. Lavdërimi

Pjesa e fundit e kapitullit të fundit të Fjalët e Urta përshkruan dhe lëvdon karakterin e gruas shtëpiake të "zellshme" ose të "shkëlqyer". Aty nxirren në pah meritat e saj të shumta dhe në fund gjejmë këto fjalë lavderuese:

"Bijtë e saj ngrihen dhe e shpallin të lume; edhe burri i saj e lëvdon duke thënë: 'Shumë bija kanë bërë gjëra të mëdha, por ti i tejkalon të gjitha ato'."

(Fja. 31:28-29)

Disa bashkëshortë tregohen shumë të kursyer kur bëhet fjalë për lavdërimin e grave të tyre. Ky lloj kursimi është i gabuar. Ata do të habiteshin po t'ju bëhej e qartë sesa shumë e dëshiron gruaja lavdërimin dhe sa pozitivisht reagon ajo. Lavdërimi i gruas është një nga investimet më të mira që mund të bëni. Kur burri ka një grua besnike dhe të angazhuar vlera e saj nuk ka të paguar. Ashtu si Salomoni thotë: "Vlera e saj është më e madhe nga ajo e margaritareve". (Fja.31,10)

Lavdërimi i gruas me fjalë të sinqerta është gjëja më e paktë që mund të bëjë një bashkëshort.

## Edhe Një Sfidë

Dikush u interesua njëherë te një kristian me përvojë për një person të caktuar. "Kristian i mirë është ai?" Kristiani me përvojë i përgjigjet: "Nuk di ç'të them. Nuk kam pasur rastin t'ia njoh të shoqen". Kjo që një përgjigje e mençur. Sukses i burrit shihet te gruaja.



Bëja njëherë këtë test vetes sate, nëse je bashkëshort. Ndoshta duhet të kujdeseni më pak për veten dhe më shumë për gruan. Bëji vetes edhe gruas këto pyetje për të parë se ku je: A e ndjen ajo veten të sigurtë dhe të përmbushur? A jam unë krenar për të? Nëse përgjigjet janë “po”, atëherë ti je bashkëshort i suksesshëm.

Por nëse duket qartë se disa sfera të personalitetit të gruas janë të paplota, nëse ajo është e tensionuar, e mbingarkuar dhe e ndjen veten të pasigurt, duhet ta rishikoni mirë sjelljen tuaj si bashkëshort. Them se do t’ju bënte mirë të lexonit edhe një herë sferat e përgjegjesisë së bashkëshortit të trajtuara deri tani. Nëse arrini të dalloni se në disa pika keni bërë faje, pendohuni para Zotit dhe lutuni që Ai t’ju japë hir për të përmirësuar gjendjen.



## 4

# Roli i Bashkëshortes

Tema kryesore e këtij libri është “Bashkëshorti”, por çdo përshkrim i rolit të burrit do të ishte i mangët, pa përshkruar qoftë edhe shkurtimisht rolin e bashkëshortes. Një martesë funksionon rrjedhshëm vetëm atëherë kur çdo partner hyn në rolin e vet të përcaktuar nga Bibla. Pra, le të shohim se çfarë thotë Bibla për gruan.

### 1. Ajo është ndihmëse

“Pastaj Zoti Perëndi tha: Nuk është mirë që njeriu të jetë vetëm; unë do t’i bëj një ndihmë që i përshtatet”.

(Zan. 2:18)

Kjo mund të përkthehet edhe kështu: “Unë do t’i bëj një ndihmë që ta plotësojë”, gjë që nënkupton se një burrë pa gruan e vet është i paplotë. Përkthimi nga hebraishtja nuk është aq i lehtë, por le të përqendrohemi te pika kryesore: Perëndia e krijoi gruan si ndihmëse.

Sot shumë gra mendojnë: “Po të jem ndihmëse, jam inferiore”. Ky është gabim. Në trupin e Krishtit nuk ka persona superiorë apo inferiorë. Secilit prej nesh i është dhënë një funksion i caktuar. Perëndia kërkon prej nesh besnikëri në vendin e posaçëm dhe në funksionin konkret që na ka besuar.

Te Gjoni 14:16-17 Jezusi tregon se si do të kujdeset për dishepujt pasi të jetë larguar prej tyre: “Dhe unë do t’i lutem Atit dhe ai do t’ju japë një Ngushëllues tjetër, ... Frymën e së Vërtetës...” Kështu pra, Jezusi e cilëson Frymën e Shenjtë si ndihmës, por a do të thotë kjo se Fryma e Shenjtë është inferior? Përkundrazi: Ai është Perëndi!

Po ashtu, një grua që përmbush rolin e saj të dhënë nga Perëndia, rolin si ndihmëse, nuk është në asnjë mënyrë inferiore. Unë falenderoj Perëndinë për secilën nga gratë e mia, të cilat kanë qenë për mua ndihmëse të mrekullueshme. Pa gruan time të parë, Lydian dhe pa gruan time të dytë, Ruthin, nuk do të kisha arritur kurrë këtu ku jam sot.

## 2. Ajo i nënshtrohet të shoqit

Koncepti i nënshtimit shkakton që prej shumë vitesh diskutime të forta, por Pali thotë shkoqur tek Efesianët 5:21-22:

“Nënshtrojuni njëri-tjetrit në frikën e Perëndisë! Ju, gra, nënshtrojuni burrave tuaj porsì Zotit”.

Shumë prej këtyre diskutimeve rrjedhin nga fakti se pjesa e dytë e vargut është shkëputur nga konteksti biblik (në versionin tim biblik, botuesi madje ka ndarë vargun 21 nga 22 dhe ka futur aty si pykë një mbishkrim). Vargu direkt përpara asaj pjese aq të diskutuar i drejtohet të gjithë kristianëve dhe thotë: “Nënshtrojuni njëri-tjetrit në frikën e Perëndisë!” Kjo është forma primare e nënshtimit në trupin e Krishtit – nënshtimi i ndërsjellë i të gjithë kristianëve. Ky duhet të jetë tipari më spikatës i të gjithë kristianëve: një qëndrim zemre i butë dhe i nënshtuar kundrejt vëllezërve të besimit.

Në këtë kontekst nënshtimi reciprok, gruas i jepet një privilegj i veçantë dhe i pakrahasueshëm: Nëpërmjet qëndrimit ndaj burrit të vet ajo mishëron qëndrimin e bashkësisë ndaj Jezusit. Po ta shohim nga kjo anë, nënshtimi nuk është një detyrim që e rëndon gruan, por shumë më tepër një privilegj i veçantë që i bëhet asaj.

Por çfarë ndodh nëse gruaja nuk nënshtrohet dhe burri nuk e merr mundimin të zërë vendin si kreu i familjes? Kjo lloj familjeje nuk ka mbrojtje frymërore. Ajo i përngjan një anijeje në det të trazuar e cila është e predestinuar të mbytet, pasi kapiteni i saj nuk ndodhet në timon.

Shkaku kryesor i mungesës së stabilitetit dhe i çrregullsive në shoqërinë tonë janë para së gjithash këto familje të pambrojtura. Ka vetëm një zgjidhje të efektshme të këtij problemi: Në familjet tona duhet rivendosur rregulli i dhënë nga Perëndia.

Kur u martuam, gruaja ime e parë ishte shumë më e madhe sesa unë në moshë. Ajo ishte misionare me përvojë dhe kishte arritur shumë suksese në shërbimin e mundimshëm frymëror. Ishte me edukim të mirë arsimor dhe shumë e zonja në të folur. Po të kishte dashur të zotëronte përmbi mua, mund ta kishte bërë këtë pa pikën e zorit! Por ajo i lejoi një djali të ri pa përvojë të zinte vendin si kreu i familjes dhe kjo e ngre atë shumë lart.

Lydia nganjëherë duhet të ketë vuajtur tortura shpirtërore për shkak të disa sjelljeve të mia! Mos harroni se unë isha fëmijë i vetëm dhe u bëra asokohe, sa hap e mbyll sytë, kreu i një familjeje me tetë vajza. Secili prej nesh vuajti pjesën e vet!

Sikur ajo të kish ngulur këmbë për të qenë edhe pas martesës kreu i punës sonë frymërore, unë do ta kisha kaluar jetën duke qenë thjesht “burri i Lydias”. Por, falë Zotit, Lydia më la të zija vendin që më takonte.

### **3. Ajo përkrah ose mbështet**

Perëndia e ka krijuar njeriun në një mënyrë të tillë, që koka nuk mban dot vetveten. Nëse burri është kreu i familjes, atë duhet ta mbështetë trupi. Përgjegjësinë për këtë, në radhë të parë e ka gruaja.

Ne burrat jemi krijesa të dobëta në shumë drejtime: Ne kemi nevojë për përkrahje! Nga jashtë mund të dukemi moskokëçarës dhe të komandojmë sa djathtas e majtas, por në brendësi jemi minj të lagur.

Një grua besimtare i sheh dobësitë e burrit të saj, por ajo nuk ia kujton atij këto dobësi orë e minutë.

Aq më tepër do ta përkrahë të shoqin me takt e mençuri, ndërkohë që ai përpiqet të mposhtë dobësitë e veta.

### **4. Ajo jep zemër**

Nuk ka gjë më dërrmuese sesa një bashkëshorte që e dekurajon të shoqin. Përfytyroni një predikues që sapo ka mbajtur një predikim

mizerabël, ndaj të cilit dëgjuesit reagojnë jashtëzakonisht të rezervuar. Dhe nëse, duke u kthyer në shtëpi, gruaja e vet i thotë: “Çfarë predikimi skandaloz!”, atëherë ai arrin mu në pikën e fundit të dëshpërimit dhe e ndjen veten të mjerë si një krimb! Por, nëse ajo i thotë: “Ti ke mbajtur predikime më të mira sesa ky i sotmi, megjithatë mua më pëlqeu”, ai mendon: “Mirë pra, ndoshta nuk ka marrë fund gjithçka. Shpresoj ta bëj më mirë në të ardhmen”.

Përmenda më sipër se “ndihmës” është një nga titujt e Frymës së Shenjtë; këtë fjalë mund ta përkthejmë edhe me “zemërdhënës”, “inkurajues”. Kur një grua i jep zemër burrit të vet, ajo në këtë rast vepron njëllor si Fryma e Shenjtë.

### 5. Ajo lutet për burrin e saj

Nganjëherë gratë harxhojnë më shumë kohë duke u merakosur për burrat e tyre, duke i kritikuar dhe duke i ballafaquar me gabimet, sesa duke u lutur për ta. Por një grua që gjuhëzohet dhe falenderon Zotin për burrin e vet, do të korrë frytin e mirë të lutjes së saj.

Njëherë, Ruthi dhe unë ishim miqësuar me dy çifte që kishin probleme në martesat e tyre. Në të dy rastet, burrat kishin dobësi masive dhe probleme në jetën e tyre. Dy bashkëshortet vendosën të takoheshin çdo mëngjes dhe të luteshin për burrat dhe këtë e bënë besnikërisht vite me radhë.

Sot, këta burra janë të suksesshëm – njëri në shërbimin frymëror, tjetri në profesionin e vet. Pa lutjen këmbëngulëse dhe besnike të grave të tyre, këta burra kurrë nuk do të kishin arritur aty ku janë sot. Lutja ndërhyrëse sjell fitime shumë më të mëdha sesa kritika apo ankesat.

### Nderim Kujtimit të Ruthit

Në kohën kur po shkruaja këtë libër, Perëndia e mori gruan time, Ruthin, në qiell pranë vetes. Ne shijuam njëzet vjet me radhë një martesë të lumtur, të frytshme dhe të suksesshme. Kjo kishte disa arsye:

Së pari, ishim të dy kristianë me bindje dhe të angazhuar. Për secilin nga ne, qëllimi më i madh në jetë ishte t'i shërbenim dhe të lartësonim Jezusin.

Së dyti, besonim se ishte plani i Perëndisë që na bashkoi si burrë e grua.

Së treti, ishim të bindur se modeli i Dhjatës së Re për martesën ka vlerë edhe për ditët e sotme. Ne kurrë nuk provuam t'i shtynim mënjandë kërkesat e Biblës, duke i quajtur "të vjetëruara" apo "të papërputhshme" me standardet e shoqërisë në të cilën jetojmë.

Së katërti: Ruthi ishte e pakursyer. Ajo ishte një grua e zonja dhe e talentuar dhe i kishte të gjitha aftësitë për të arritur suksese pa ndihmën e askujt. Por ajo besonte se Perëndia i kishte dhënë për detyrë të më ndihmonte në çdo lloj mënyrë të mundshme, me qëllim që unë të kryeja shërbimin e ngarkuar nga Perëndia. Ajo nuk kishte si qëllim suksesin e saj personal, por timin.

Këtu duhet të shtoj se Ruthi kurrë nuk e bënte veten leckë, apo të më bënte mua lajka, vetëm e vetëm ngaqë më ishte përkushtuar mua dhe shërbimit tim. Nëse ishte e mendimit se po bëja diçka të gabuar, ma thoshte pa iu dridhur qerpiku. Ajo i kushtonte shumë vëmendje mënyrës se si vishesha, me qëllim që veshja ime t'i përshtatej shërbesës që kryeja. Sapo krijonte përshtypjen se unë e lija pas dore pamjen e jashtme dhe nuk kisha kujdes në të veshur, ajo thoshte: "Dukesh si një burrë që nuk ka grua në shtëpi".

Gjatë njëzet viteve të martesës sonë, shërbimi im u përhap në një mënyrë të habitshme. Kur u martuam, unë isha mësues biblik (udhëtoja për referime e predikime nga një kishë në tjetrën), pata botuar disa libra dhe kisha lidhje me disa qarqe të pakta brendapërbrenda trupit të Krishtit. Kur Perëndia e mori Ruthin pranë vetes, shërbimet "Derek Prince" vepronin në mbarë botën. Emisionet e mia radiofonike mbi tema biblike, të filluara një vit pas martesës me Ruthin, përktheheshin ndërkaq në të paktën 12 gjuhë, ndër të tjera rusisht, spanjisht, arabisht dhe katër dialekte kineze. Botova dhe më shumë se 20 libra të tjerë, pjesë të ndryshme të të cilëve janë përkthyer në pothuajse 60 gjuhë. Ruthi dhe unë organizuam konferenca në çdo kontinent përveç Antarktikës. Katër herë udhëtuam së bashku në të gjithë botën për shërbesa frymërore. Në këtë kohë që po shkruaj, ekzistojnë të paktën në 30 vende të botës zyra të shërbimeve "Derek Prince". I përmend të gjitha këto për të nderuar kujtimin e Ruthit, por edhe për të theksuar një fakt të pamohueshëm: Nëse Ruthi nuk do të

## Bashkëshortë

më kishte përkrahur me vetëmohim, e vendosur dhe me gjithë zemër, gjithçka që numërova më sipër nuk do të kishte ekzistuar kurrë.

Pothajse çdo ditë unë i thosha asaj dy gjëra: “Ti je thesari im!” dhe “Ti je kaq e mrekullueshme!”

Po këtë ndiej edhe sot.

Kur të marrim shpërblimin në përjetësi, Ruthi ka për të marrë masën e plotë. Unë gëzohem që do të jem aty për ta parë këtë!

Tani ju ndoshta bëni pyetjen: Kur Dereku dhe Ruthi kaluan së bashku një martesë kaq të lumtur dhe të frytshme, përse atëherë vetëm pak martesa e përjetojnë këtë sukses?

Njëra nga arsyet qëndron te fakti se shumë çifte bashkëshortore lënë mënjane një përbërës thelbësor të martesës. Për këtë bën fjalë kapitulli në vazhdim.



## 5

# Përbërësi Që Mungon

Një udhëheqës i njohur ungjilltar dhe gruaja e tij na treguan hapur disa konflikte që kishin me njëri-tjetrin. Gruaja tregoi se një ditë prej ditësh tensioni i brendshëm i të dyve shpërtheu në një grindje të fortë në dhomën e gjumit.

Burri, ashtu si shumë bashkëshortë, kishte theksuar herë pas here urdhrin biblik të nënshtimit të gruas ndaj burrit. Gruaja, ashtu si shumë gra, kishte theksuar me forcë se nuk kishte ndonjë arsye pse t'i nënshtrohej atij. "E përse të të nënshtrohem unë ty", kishte thënë ajo. "Për ato vendimet e hatashme që merr?"

Në këtë pikë, u ra ndër mend që të dyve se nuk po silleshin si kristianë. Në mënyrë spontane, secili u gjunjëzua në anë të shtratit të vet për t'u lutur.

"Kur bëme këtë", na tregoi gruaja, "m'u duk sikur fryu një erë e freskët përmes dhomës së gjumit. Nuk di sesi, por që të dyve na erdhi në zemër vargu nga Efesianët 5:21 ku thuhet: "Nënshtrojni njëri-tjetrit në frikën e Perëndisë!". Që të dy u bëme të vetëdijshëm se lidhjes sonë i mungonte diçka – frika e Perëndisë. Ne ishim sjellë në mënyrë të tillë, sikur lidhja jonë të gjendej vetëm në nivelin njerëzor. Kishim harruar Perëndinë".

Kur iu bë e qartë kjo, ata u penduan për gabimin, i kërkuan falje njëri-tjetrit dhe Perëndisë. Ky qe fillimi i një marrëdhënieje krejt të re

me njëri-tjetrin, i një marrëdhënieje në të cilën secili prej tyre pranoi vendin e caktuar nga Perëndia.

Mua nuk më dilte më nga mendja skena e dhomës së gjumit, të cilën ajo grua ma përshkroi aq të gjallë. Dalëngadalë nisa të dalloj aty një lloj diagnozë, e cila shpjegonte se përse shumë martesë kristiane nuk e arrinin kurrë standardin e dhënë nga Dhjata e Re. Ato lënë mënjanë një përbërës thelbësor: Frikën e Zotit.

Lydia dhe Ruthi gatuanin shkëlqyeshëm! Që të dyja e kishin zakon të mblidhnin receta gatimi. Në këtë mënyrë unë mësova se shpeshherë në përgatitjen e një ëmbëlsire ka një përbërës thelbësor, nga i cili varet gjithë shija e asaj ëmbëlsire. Mund t' i përziësh të gjithë përbërësit e tjerë në raportin e caktuar, por pa atë përbërësin vendimtar, ëmbëlsira nuk merr shijen e duhur.

Për përgatitjen e kekut të Krishtlindjes ka variante të ndryshme, për shembull, një variant amerikan dhe një anglez. Një përbërës shumë tipik, dallues, i variantit anglez është marsipani (një lloj brumi i ëmbël e i butë bajamesh të bluara), ndërsa keku amerikan i Krishtlindjes përgatitet, si rregull, pa marsipan. Për mua si anglez, keku pa marsipan nuk është kek i vërtetë krishtlindjeje. Ndryshimi kryesor qëndron tek marsipani.

Tani, ç'lidhje ka kjo me martesën kristiane? E po, ja, këtu "marsipani" është frika e Perëndisë. Pa këtë përbërës tipik dallues, martesë midis kristianëve gjendet në të njëjtin nivel me një martesë midis jobesimtarësh. Kjo martesë nuk e arrin kurrë qëllimin që ka Perëndia për të. Asaj do t' i mungojë gjithmonë aroma e veçantë, e cila e dallon atë nga një martesë jokristiane.

## Respekt, Nderim dhe Drojë

Për fat të keq, shumë kristianë të kohës sonë kanë një përfytyrim të gabuar mbi konceptin biblik të "frikës ndaj Perëndisë" ose "perëndishmërisë". Ata e përçmojnë atë si diçka të "vjetëruar", e cila e ka vendin në kohën e Dhjatës së Vjetër dhe që nuk ka rëndësi për krishtërimin e Dhjatës së Re. Por sa larg qëndron kjo nga e vërteta! Përkundrazi: po të bëhet fjalë për cilësi karakteri, frika e Zotit luan në Dhjatën e Re një rol shumë më të madh sesa në Dhjatën e Vjetër.

## Përbërësi që mungon

Ne duhet t'i bëjmë vetes pyetjen: Çfarë nënkupton Bibla me shprehjen "frika e Zotit" ose "Perëndishmëri"? Kjo përfshin tre fjalë me kuptim të përbashkët: Respekt, nderim dhe drojë. Perëndishmëria nuk ka të bëjë fare me një qëndrim të trembur prej skllavi. Ajo është një reagim më se i natyrshëm i krijesës ndaj Krijuesit – ndaj plotfuqisë, madhësisë, lavdisë dhe shenjtërisë së tij.

Te Psalmi 19:9 Davidi thotë: "Frika e Zotit është e pastër, mbetet përjetë". Frika e Zotit nuk bëhet kurrë demode. Ajo është absolutisht e pastër dhe pastruese – diçka që Perëndia dëshiron ta shohë në çdo kohë te populli i vet.

Tek Isaia 11:2 profeti flet për vajosjen shtatëfishe nga Fryma e Shenjtë, vajosje e cila do të dëshmonte Jezusin si Mesian e premtuar, si të Vajosurin. Shtatë aspektet e ndryshme të vajosjes janë: Fryma e Zotit (Fryma që flet në vetën e parë si Perëndi), Fryma e Urtësisë, Fryma e Zgjuarsisë, Fryma e Këshillës, Fryma e Fuqisë, Fryma e Dijes dhe në fund, (si kurorëzim i listës), Fryma e Frikës së Zotit.

Këtu mund të bëhen spekulime se Jezusi, si Bir i dashur i Perëndisë, nuk e ka të nevojshme të tregojë Frikë Perëndie. Por Isaia 11:2 zbulon se Frika e Zotit do të jetë vula përfundimtare e cila dëshmon se Jezusi është me të vërtetë Mesia dhe Biri i Perëndisë. Nëse Jezusi kishte nevojë për këtë vulë perëndishmërie, atëherë si mund të themi ne, dishepujt e Tij, se kjo Frikë për ne nuk ka më vlerë?

## Njohja e Çmimit të Vërtetë të Shpëtimit

Nganjëherë kristianët kanë këtë lloj qëndrimi: meqë Perëndia na pranoi në dashurinë e tij dhe na bëri bij të vet, ne tani nuk e kemi të nevojshme në jetën tonë të praktikojmë Frikë Perëndie. Mirëpo, krejt e kundërta është e vërtetë. Perëndia na bleu dhe na çliroi me çmimin pafundësisht të lartë të gjakut të çmuar të Birit të Tij. Vetëm ky fakt duhet të mjaftonte për të zgjuar te ne vetëdijen plot respekt të përgjegjësive së madhe që kemi për të çuar një jetë e cila i jep Atij lavdi dhe nder.

Te letra e parë e Pjetrit 1:17-19 apostulli thotë se çmimi i paguar për shpëtimin tonë duhet të na frymëzojë një frikë të shenjtë, e cila na bën të aftë të jetojmë duke i dhënë Perëndisë lavdi dhe nder.

## Bashkëshortë

“Dhe në qoftë se e thërrisni si Atë atë që, pa anësi, gjykon sipas veprës së gjithsecilit, kalojeni kohën e shtegtimit tuaj *mbi dhe* me frikë, duke ditur se jo me anë gjërash që prishen, si argjendi ose ari, jeni shpenguar nga sjellja e kotë e dorëzuar nga etërit, por me anë të gjakut të çmuar të Krishtit, si të Qengjit të patëmetë dhe të panjollë”.

Pra, Pjetri këtu thekson se duhet t'i qëndrojmë sa më larg mendimit se tani që u çliruam, Frika e Perëndisë nuk ka më vend në jetën tonë. Ai madje këmbëngul se Frika ndaj Perëndisë duhet të jetë i vetmi reagim i përshtatshëm nga ana jonë!

Kur mundohem të përshkruaj efektin e Frikës së Perëndisë në jetën time, unë përdor këtë përfytyrim: qëndroj mbi majën e një shkëmbi i cili bie thikë mbi një luginë të mbushur plot me copëra gurësh të thepisur. Një parmak më ruan nga rrëzimi në greminë. Në sytë e mi ky parmak simbolizon paralajmërimet e Biblës dhe kërkesën për të bërë një jetë të shenjtë. Pastaj i bëj pyetje vetes: “Po sikur të tregohesha fodull i marrë dhe të kapërceja parmakun e të qëndroja mu në buzë të greminës?” Një hap i vetëm do të mjaftonte për t'u rroposur në shkatërrimin përfundimtar e pa kthim mbrapa. Kur përfytyroj këtë, me kap ngërçi në stomak dhe më kalojnë mornica. Më bie ndër mend paralajmërimi që u bëhet hebrenjve kristianë: “E tmerrshme është të bjerë njeriu në duart e Perëndisë së gjallë” (Heb. 10:31).

Jo vetëm Perëndisë, por edhe fjalës së Tij, Biblës, ne duhet t'i qasemi me respektin dhe drojen më të madhe. Tek Isaia 66:2, Zoti thotë: “Mbi kë, pra, do ta kthej shikimin tim? Mbi atë që është i përlulur, ka frymë të penduar dhe dridhet nga fjala ime”.

Përse duhet të dridhemi para Biblës? Sepse nëpërmjet Biblës hyjnë në jetën tonë Perëndia Atë dhe Perëndia Bir. Gjoni 14:23 thotë: “Jezusi u përgjigj dhe i tha: ‘Nëse ndokush më do, do ta mbajë fjalën time; edhe Ati im do ta dojë dhe ne do të vijmë tek ai dhe do të bëjmë banesën tek ai’”.

Qëndrimi ndaj Biblës zbulon se sa e vërtetë është dashuria jonë për Jezusin dhe na hap derën nëpër të cilën Perëndia vjen në jetën tonë me gjithë mbushullinë e vet. Kur lexojmë ose dëgjojmë Biblën, duhet të kemi një qëndrim të tillë në zemër, a thua se po qëndrojmë ballë për ballë me Perëndinë Atë apo me Perëndinë Bir.

## Një Çelës Gëzimi dhe Pjellorie

Ndryshe nga ç'e mendojmë, ky qëndrim respekti dhe droje ndaj Perëndisë është çelësi për përjetimin e atij gëzimi, të cilin mund ta japë vetëm Perëndia. Në Psalmin 2:11, psalmisti na paralajmëron: "Shërbejini me frikë Zotit dhe gëzohuni me dridhma".

Ky varg na paraqet një barazpeshë të mrekullueshme: Ne gëzohemi për Hirin e Perëndisë, por njëkohesisht dridhemi para madhësisë që të fut frikën – një barazpeshë, të cilën e hasim në bashkësinë e parë. Te Vep. 9:31 thuhet:

"Kështu, në mbarë Judenë, në Galile dhe në Samari kishat kishin paqe dhe ndërtoheshin. Dhe duke ecur në druajtjen e Zotit dhe në ngushëllimin e Frymës së Shenjtë, shumoheshin."

Për një njëri që mendon vetëm në sferën normale, ky pohim është paksa i çuditshëm: Frika e Zotit dhe ngushëllimi i Frymës së Shenjtë. A shkojnë bashkë frika dhe ngushëllimi? Mirëpo ky kombinim ishte çelësi i jetës së gjallë dhe i rritjes eksplozive në bashkësinë e parë.

Ndërkaq, ju ndoshta bëni pyetjen se ç'lidhje kanë këto sqarime mbi frikën ndaj Perëndisë me marrëdhënien bashkëshortore të burrit me gruan. Përgjigja është: Frika e Zotit është GJITHÇKA në këtë marrëdhënie! Duke marrë si bazë përvojën e grumbulluar nga jeta e familjes sime kristiane dhe përvojën në udhëheqjen frymërore të shumë kristianëve me probleme në martesë, unë kam arritur në një përfundim fare të thjeshtë: Nëse burri dhe gruaja nuk kanë frikë Perëndie, atëherë martesë e tyre kristiane nuk do të bëhet kurrë ashtu siç e dëshiron Perëndia.

Frika e Zotit është përbërësi nga i cili varet shija e gjithë ëmbël-sirës. Burri dhe gruaja mund të thonë fjalët e duhura, mund të kenë qëllimet më të mira e të sinqerta dhe mund të konsultohen me më të aftin udhëheqës frymëror që ekziston, por, nëse në jetën e tyre nuk vepron forca aktive e frikës së Perëndisë, martesë e tyre nuk do të arrijë kurrë qëllimin që Perëndia ka për të.

Ky qëndrim thelbësor në jetën e burrit dhe të gruas mund të rezultojë vetëm nga një themel solid: Në fund të fundit, gjithçka varet

## Bashkëshortë

nga marrëdhënia jonë personale me Zotin Jezus. Ai na fton plot hir të kujdesemi për të pasur një marrëdhënie të ngushtë me Të; por, ama, duke mos harruar kurrë se Ai njëkohesisht është zbulesa personale, madhështore dhe e denjë për respekt e Perëndisë Atë. Ai është Shpëtimtari por edhe Gjykatësi ynë, para të cilit do të japim një ditë llogari. Në Dhjatën e Re ketë të vërtetë e sqarojnë dy dishepujt e tij më të afërt, Gjoni dhe Pali.

Në darkën e fundit, Gjoni ishte kaq afër Jezusit, saqë qe mbështetur në gjoksin e tij dhe i pëshpëriste në vesh. Por, më vonë, kur Gjoni papritur u përball me vizionin e Krishtit të Perëndisë aq të lavdishëm e të ngritur në qiell, ai thotë: "... rashë para këmbëve të tij si vdekur." (Zbulesa 1:17)

Edhe Pali kishte një marrëdhënie të qëndrueshme dhe intime me Zotin. Por Pali ishte gjithnjë i vetëdijshëm se edhe ai ashtu si çdo kristian tjetër një ditë do të dilte para fronit gjykues të Krishtit, për të dhënë llogari mbi jetën e tij. Në këtë kontekst ai shkruan te 2 Kor. 5:10-11:

*"Sepse ne të gjithë duhet të shfaqemi para selisë së gjykatës së Krishtit, që secili të marrë shpagimin e gjërave që ka bërë me anë të trupit, në bazë të asaj që ka bërë, qoftë në të mirë apo në të keq. Duke e ditur, pra, frikën e Zotit, ne bindim njerëzit..."*

Lajmi i Palit tingëllon kaq bindës, pasi ai ishte i vetëdijshëm për madhësinë e Krishtit, një madhësi që ngjall respekt dhe drojë.

Kur burri në marrëdhëniet me gruan e vet lejon frikën gjithëdepërtuese të Zotit dhe kur gruaja reagon në po të njëjtën Frymë, martesë e tyre do të përmbushë planin e Perëndisë ashtu siç zbulohet në Bibël. Të dy bëhen të vetëdijshëm për përgjegjësinë e jashtëzakonshme që u është ngarkuar. Burri do t'i vërë vetes si qëllim që të silltet ndaj gruas së tij ashtu si Krishti silltet ndaj nuses, Bashkësisë. Gruaja, nga ana e saj, do të mundohet të reagojë ndaj burrit të vet ashtu si reagon Bashkësia ndaj dhëndrit, Krishtit. Natyrisht, të dyja palët do të bëjnë gabime dhe do të përjetojnë dështime, por këto të meta do të mbulohen, nëse ata të dy pendohen para Zotit dhe i kërkojnë falje njëri-tjetrit.

Frika e Zotit do të zbusë dhe do të largojë zhgënjimet dhe keqkupa-

timet, të cilat janë të pashmangshme në çdo martesë, ashtu si flladi i freskët i një mbrëmjeje vere zbut dhe largon nxehtësinë dhe thatësinë e ditës. Burri dhe gruaja do të gjejnë përmbushje në detyrat e caktuara nga Perëndia dhe do të plotësojnë njëri-tjetrin në atë lloj harmonie që kishte ndër mend Perëndia kur tha: “dhe do të jenë një mish i vetëm”.





## 6

# Autoriteti Frymëror i Një Martese të Harmonishme

Bashkëjetesa në harmoni të plotë e burrit me gruan është një nga bekimet më të ëmbla që jep Perëndia mbi këtë dhé. Por edhe më shumë se kaq: Ajo çel rrugën për te një sferë autoriteti frymëror, të cilin pak kristianë e arrijnë.

Deri tashmë analizuam qëllimin e Zotit kur Ai krijoi një grua për Adamin. Tani le të bëjmë një hap më mbrapa te Zanafilla dhe të shtrojmë pyetjen se ç'qëllim pati Perëndia kur krijoi njeriun.

“Kështu Perëndia krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së vet, sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë e krijoi; Ai i krijoi mashkull e femër. Dhe Perëndia i bekoji; dhe Perëndia u tha atyre: ‘Jini të frytshëm dhe shumëzohuni, mbushni tokën e nënshtrojeni dhe sundoni mbi peshqit e detit, mbi zogjtë e qiellit dhe mbi çdo qenie që lëviz mbi tokë’.”

(Zan. 1:27-28)

Zoti nuk ia ngarkoi vetëm Adamit sundimin mbi tokën. Ai i foli Adamit dhe Evës. Ai pati për synim që Adami dhe Eva të zotëronin së bashku tokën në emër të Tij (Perëndisë).

Për mendimin tim, një çift bashkëshortor që bashkëjeton në harmoni dhe unitet përbën elementin më të fortë në luftën frymërore dhe

## Bashkëshortë

në ushtrimin e autoritetit frymëror. Me anë të këtij kanali, Perëndia ende vazhdon të ushtrojë sundimin e Tij. Jo burri me kokë të vet, as gruaja me kokë të vet, por burri dhe gruaja të bashkuar në një martesë, e cila funksionon sipas planit të Perëndisë. Që të dy ata kanë privilegjin e sundimit në emër të Perëndisë. Domethënien tepër të madhe të këtij fakti e kuptojmë sapo dallojme se ne, si kristianë, jemi të përfshirë në një luftë për jetë a vdekje, në një luftë me pushtetet e padukshme e të liga, të cilat duan të na asgjesojnë. Pali e përshkruan këtë konflikt tek Efesianëve 6:12:

“Sepse beteja jonë nuk është kundër gjakut dhe mishit, por kundër principatave, kundër pushteteve, kundër sunduesve të përbotshëm të errësirës së kësaj jete, kundër frymërave të liga në vendet qiellore”.

Tek Efesianëve 6;18 Pali shpjegon se ndeshja jonë zhvillohet në arenën e lutjes:

“Duke u lutur në çdo kohë dhe me çdo lutje dhe përgjërime në Frymë...”

Në këtë arenë çifti bashkëshortor është i pamposhtur vetëm nëse përmbush një kusht vendimtar.

## Unitet në Lutje

Te Mateu 18:18-20 Jezusi u sqaron kristianëve një mënyrë jetese në lutje, së cilës nuk mund t’i rezistojë asgjë e askush:

“Në të vërtetë po ju them se ç’të keni lidhur mbi tokë do të jetë lidhur edhe në qiell; dhe ç’të keni zgjidhur mbi tokë do të jenë zgjidhur edhe në qiell. Përsëri po ju them se, në qoftë se dy prej jush bien në ujdi mbi tokë të kërkojnë çfarëdo gjëje, kjo do t’u jepet atyre nga Ati im në qiej. Sepse, kudo që dy a tre janë bashkuar në emrin tim, unë jam në mes të tyre”.

Për të rënë në këtë lloj ujdje në lutje, mjaftojnë të paktën dy apo tre veta. Nëse arrijmë këtë minimum, çdo gjë që lidhim ose zgjidhim mbi tokë, do të lidhet ose zgjidhet në qiell. Folja në greqisht ka kuptimin “do të kenë qenë lidhur” ose “do të kenë qenë zgjidhur”. Pra, mund të themi: Gjithçka që lidhim ose zgjidhim mbi tokë, do të ketë qenë lidhur ose zgjidhur në qiell”.

Kjo mua më entuziazmon, sepse do të thotë se ajo që flasim mbi tokë, përcakton atë që ndodh në qiell! Ndoshta ne jemi të bindur se duhet të presim derisa Perëndia të bëjë diçka (në shumë raste ashtu është), por ka edhe kohë kur Perëndia pret që ne të bëjmë diçka. Në njëfarë kuptimi, iniciativa na është lënë neve mbi tokë. Nëse përmbushim kushtet e duhura, gjithçka që shpallim mbi tokë është po aq e efektshme sa dhe ajo që shpallet në qiell. Kur ne mbi tokë themi për diçka: “Është lidhur,” në këtë çast kjo diçka është lidhur edhe në qiell. Ose, kur ne mbi tokë themi: “Është zgjidhur”, po në atë çast është zgjidhur në qiell.

Le të supozojme se një çift kristian beson se është thirrur për t’i shërbyer Perëndisë në një vend, i cili nuk lejon shpalljen e ungjillit dhe ndalon shërbesat frymërore të çdo lloji. Kërkesa e tyre për vizë refuzohet herë pas here dhe nuk mbetet edhe për më vonë asnjë shpresë për të pasur sukses.

Pastaj Fryma e Shenjtë u nxjerr atyre para syve Jezusin “...që ka çelësin e Davidit, ai që hap dhe askush nuk mbyll; dhe mbyll e askush nuk hap” (Zbu. 3:7). Ata vendosin të bien në ujdje në lutje për të “lidhur” gjithë pushtetet që pengojnë hapjen e këtij vendi ndaj krishtërit dhe për të “zgjidhur” vizën.

Në muajt që pasojnë të dy ata kalojnë një proces, gjatë të cilit përfytyrimet e tyre personale vdesin njëri pas tjetrit. Burri refuzon një ngritje të madhe në përgjegjësi, sepse kjo ngritje në përgjegjësi bëhet vetëm me kushtin që ai të mos bëjë më udhëtime jashtë shtetit. Gruaja është dakort që të ndërrojë banesën e rehatshme ekzistuese me një banesë më të vogël për të kursyer paratë e duhura, me qëllim që ata të shkojnë në atë vend ku mendojnë se janë thirrur. Pas shumë muajsh është duke u shuar çdo shpresë se kjo thirrje e Perëndisë mund të bëhet realitet, por ashtu si Abrahami i cili “...kundër çdo shprese, besoi” (Rom. 4:18), ata vazhdojnë të luten.

Pastaj burrit, pa pritur e pa kujtuar, i bëhet një ofertë për të marrë përsipër drejtimin e një firme pikërisht në atë vend ku i ka thirrur Perëndia! Dera që ishte e mbyllur për sa i përket shërbimit frymëror, tani qëndron e hapur për përfaqësimin e një firme e cila mund t' i japë hov ekonomisë së vendit të thirrjes.

Megjithëse kjo histori përmban përvoja të kombinuara të shumë çifteve bashkëshortore kristiane, ajo ilustron ndikimin e fortë të unitetit të lutjes midis burrit dhe gruas.

Por, natyrisht, së pari duhet të përmbushim kushtet. Këto janë dy kushtet thelbësore:

Para së gjithash duhet të hedhim vështrimin te vetë Jezusi. Mateu 18:20 thotë fjalë për fjalë në greqisht: “Sepse aty ku dy ose tre janë mbledhur brenda emrit tim...”. Qendra duhet të jetë Jezusi vetë. Ne nuk mund ta themelojmë unitetin vetëm mbi një drejtim të caktuar kristian apo kishë, cilado qoftë ajo; qendra jonë duhet të jetë personi dhe veprimi i vetë Jezusit.

Pas konceptit “të bëhesh një i vetëm” te Mateu 18:19, fshihet fjala greke “sumphoneo”, nga e cila rrjedh fjala jonë “simfoni”. Jezusi këtu nuk bën fjalë për unitet në sferën intelektuale apo në lidhje me doktrina të ndryshme. Ai këtu e ka fjalën për diçka shumë më të thellë e më të madhe: harmoni frymërore. Kjo do të thotë se dy a tre veta janë kaq të lidhur e të rënë në ujdin në Frymë, sa që ata mendojnë, flasin dhe luten si një njeri i vetëm. Pak më parë pamë se Jezusi u premtonte diçka të mahnitshme atyre dy apo tre vetave që arrijnë të sigurojnë këtë lloj harmonie: “Ç’ të keni lidhur mbi tokë do të jetë lidhur edhe në qiell” dhe “Në qoftë se dy prej jush bien në ujdin mbi tokë, do të kërkojnë çfarëdo gjëje, kjo do t’u jepet atyre nga Ati im në qiell.” Këto janë premtime vërtet të fuqishme, të cilat, siç e thamë, bëjnë të qartë se fjalët tona mbi tokë përcaktojnë se ç’ndodh në qiell.

Ju ndoshta pyesni, si ka mundësi kjo? Po ju parashtroj mendimin tim: I vetmi person, i cili vendos harmoni të përkryer midis dy vetave, është Fryma e Shenjtë dhe kjo Frymë mund ta vendosë këtë harmoni vetëm midis personave plotësisht dhe tërësisht të përkushtuar. Fakti që dy njerëz arrijnë këtë harmoni vërteton se ata i janë përkushtuar plotësisht e tërësisht Frymës së Shenjtë. Kjo do të thotë se ata luten në harmoni jo vetëm me njëri-tjetrin, por edhe me Perëndinë. Dhe

## Autoriteti frymëror i një martese të harmonishme

mbi këtë bazë Perëndia përmbush detyrimin e vet për t'i dëgjuar dhe realizuar lutjet e tyre.

Harmonia e vërtetë nuk vjen vetvetiu. Keni dëgjuar ndonjëherë se çfarë tingujsh të tmerrshëm nxjerrin dy këngëtarë kur nuk bashkohen në të njëjtin ton? Ata gati-gati këndojnë në harmoni me njëri-tjetrin, e megjithatë, ne na dhembin veshët. Po ata çifte që luten me njëri-tjetrin pothuajse në harmoni? Si tingëllon lutja e tyre në veshët e Perëndisë? Perëndia tregohet i durueshem ndaj këtyre lutjeve, por Ai nuk është zotuar t'i realizojë ato. Çelësi i autoritetit frymëror në lutje është harmonia ndërmjet lutësve. Kjo vlen, natyrisht, edhe për më shumë se dy persona apo kristianë të pamartuar. Mirëpo sfida e lutjes së përbashkët në harmoni prek veçanërisht bashkëshortët kristianë.

Njëherë, kur Ruthi dhe unë ndodheshim nën një presion shumë të madh, një vëlla i dashur i besimit, më i vjetër se ne dhe shërbyes i pjekur i Perëndisë, na tha këto fjalë: "Unë jam i bindur se harmonia që keni mes jush është çelësi i suksesit të shërbimit tuaj. Mos lejoni asgjë dhe kurrkënd t'jua prishë!"

Nuk është asnjëherë e lehtë të sigurosh këtë lloj harmonie. Ajo ka çmim të lartë. Harmonia bëhet pjesë e jotja vetëm kur je gati t'ia përkushtosh jetën tënde Zotit dhe të afërmit tënd.

Njeriu i vjetër i mishit nuk ka kurrë mundësi të sigurojë harmoni të vërtetë, madje as me veten e tij. Ka vetëm një rrugëdalje: Ky njeri i vjetër duhet të vdesë. Por, falë Zotit, ai vdiq para 2000 vjetësh me Jezusin në kryq. "Njeriu ynë i vjetër u kryqëzua me të" shkruan Pali te Romakëve 6:6 dhe vazhdon në vargun 11: "Kështu edhe ju, llogariteni veten të vdekur për mëkatën, por të gjallë për Perëndinë, në Krishtin Jezus, Zotin tonë".

## Vendimin e Merrni Ju

Domosdoshmëria e vdekjes së njeriut të vjetër të mishit vë secilin prej nesh përballë një vendimi të cilin duhet ta marrim vetë: Jam i gatshëm t'i vdes vetes sime (mishit tim të vjetër?) Jam i gatshëm të arrij deri në atë pikë, saqë të them me të vërtetë për veten time atë që thotë Pali te Galatasve 2:20?

## Bashkëshortë

“U kryqëzova bashkë me Krishtin; por rroj; jo më unë, po Krishti rron në mua; por ajo që tani jetoj në mish, e jetoj në besimin e Birit të Perëndisë, që më deshi dhe dha veten për mua”.

Nëse e kuptojmë kështu kryqin, ai bëhet një derë që i mundëson burrit dhe gruas hyrjen në një jetë harmonie të mirëfilltë. Në fund të fundit, Krishti që jeton te burri, nuk ka sesi të jetë në kundërshti me Krishtin që jeton te gruaja.

Përveç kësaj, kryqi i hap rrugën autoritetit frymëror në lutje, autoritet i cili përndryshe nuk është i mundur. “Në qoftë se dy prej jush bien në ujdi (harmoni) mbi tokën të kërkojnë çfarëdo gjëje, kjo do t’u jepet atyre nga Ati im në qiej”. Perëndia nuk do ta refuzojë kurrë lutjen e folur në harmoni të vërtetë.

Por ka vetëm një rrugë për tek kjo lloj harmonie, qoftë në martesë apo në marrëdhënie të tjera personale – kryqi!



Pjesa 3

Etër





# 7

## Zbulesa Më e Lartë e Perëndisë

Mbi çdo gjë që mund të thuhet për temën e atësisë qëndron si diell rrëzëllues fakti se Perëndia e krijoi universin si një Atë i përkryer. Në çdo aspekt të krijimit dallohet vepra atërore e duarve të Tij.

Apostull Pali shkroi: “Për këtë arsye unë po i ul gjunjët e mi përpara Atit të Zotit tonë Jezu Krisht, nga i cili merr emër çdo familje në qiej dhe mbi tokë” (Ef. 3:14-15). Fjala që këtu është përkthyer “familje” është fjala “patria”, e cila rrjedh nga fjala greke “pater”, që do të thotë “Atë”. Prandaj, po të bënim një përkthim të drejtpërdrejtë, vargu do të ishte ky: “Unë i ul gjunjët e mi para Atit, nga i cili rrjedh çdo atësi në qiej dhe mbi tokë”.

Çfarë fakti mbresëlënës! Çdo atësi në univers filloi jo në tokë, as nuk është e kufizuar nga koha apo historia. Ajo nisi në qiell dhe e ka zanafillën tek Atësia e Perëndisë.

Perëndia është deri në përjetësi Ati i Zotit tonë Jezu Krisht dhe përshkruhet si i tillë në shumë pasazhe të Biblës. Marrëdhënia e ngushtë personale midis Atit e Birit të Tij ekzistonte qysh para Krijimit.

Te Gjoni 1:1 thuhet: “Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte me Perëndinë”. Kjo zbulon diçka të pakrahasueshme dhe krejt të veçantë mbi qenien e Perëndisë: Te Perëndia nuk ka vetëm atësi por edhe marrëdhënie.

Letra e parë e Gjonit 4:16 nxjerr në pah edhe një tipar tjetër të natyrës së Perëndisë: “Perëndia është dashuri”. Po ta lidhim këtë pohim me faktin e atësisë së Perëndisë, nxjerrim një përfundim të mrekullueshëm: Perëndia si Atë krijoi me dashuri Universin. Universi që Ai krijoi është, në variante të panumërta, shprehja dhe ndikimi i dashurisë së Tij atërore.

## Gjithë Krijimi Reagon Ndaj Atit

Gjithçka që krijoi Perëndia reagon në mënyrën e vet ndaj dashurisë së Tij. Trupat qiellore lëvizin në harmoni me Krijuesin e tyre. “Ai ka bërë hënën për stinët, dielli e di orën e perëndimit të vet” (Psa. 104:19). Yjet përgjigjen kur Perëndia i thërret me emër: “Llogarit numrin e yjeve dhe i thërret të gjithë sipas emrit të tyre” (Psa. 147:4). A nuk është fantastik fakti se Perëndia njih emrin e çdo ylli ndër miliarda?

Edhe pse hera-herës elementet buçasin e zhurmërojnë, ata prapëseprapë i binden paprerë Krijuesit: “Zjarr dhe breshër, borë dhe re, erë e shtrëngatës që zbaton urdhrat e tij” Psa. 148:8.

Po e njëjta gjë vlen edhe për botën e kafshëve: “Luanët e vegjël vrumullojnë duke kërkuar gjahun dhe i kërkojnë Perëndisë ushqimin e tyre” (Psa. 104:21). Dhe psalmisti përshkruan “... deti, i madh dhe i gjerë, ku gëlojnë krijesa të panumërta;...Të gjithë presin që ti t’u japësh ushqimin në kohën e duhur” (Psa. 104:25-27).

Jezusi thotë për zogjtë: “... Ati juaj qiellor i ushqen” (Mt. 6:26). Te Mateu 10:29 ai sqaron: “A nuk shiten vallë dy harabela për një aspër? Dhe, megjithatë asnjë prej tyre nuk bie përtokë pa dashjen e Atit tuaj”. Dhe te Luka 12:6 gjejmë fjalët e Jezusit: “A nuk shiten vallë pesë harabela për dy pare? E megjithatë asnjë prej tyre nuk është i harruar para Perëndisë”.

Dy harabela shiten për një aspër; pesë harabela shiten për dy pare. Me fjalë të tjera: Kush blen katër harabela, të pestin e ka falas. E megjithatë Perëndia vret mendjen edhe për harabelin e pestë.

Perëndia kujdeset në mënyrë intensive për gjithçka që ka krijuar. Dashuria e Tij atërore vlen për çdo krijesë të universit dhe për çdo gjë të krijuar prej Tij.

Një ungjilltar i shek. të 19-të, Dwight Moody, na tregon se me ç'sy e pa botën, pasi kishte pranuar Krishtin si Shpëtimtarin e vet:

“Më kujtohet se si dola nga dhoma ime atë mëngjes, pasi i isha dorëzuar Krishtit për herë të parë. M'u duk se dielli shkëlqente shumë më tepër se më parë – m'u duk sikur buzëqeshte mbi mua: Dhe kur dola në Boston Common e dëgjoja zogjtë tek cicërinin nëpër pemë, m'u duk sikur ata ma kushtonin mua këngën e tyre. E dini, unë u dashurova pas atyre zogjve. S'i kisha vënë re kurrë më parë. Më dukej sikur isha dashuruar me tërë Krijimin”.

Ky Krijues i madh ishte bërë Ati i Moody-it dhe ky Atë bëri që fëmija e Tij i porsarilindur ta shihte për disa çaste botën me sytë e Perëndisë. I tërë Krijimi ashtu siç e pa Moody, ishte i kredhur në dashurinë e pakufishme të Krijuesit.

Ka vetëm dy kategori krijesash të Perëndisë, për të cilët dashuria e Perëndisë është e huaj dhe ata nuk reagojnë ndaj saj: Satani me engjëjt e rebeluar; njeriu i rënë dhe mëkatar. Satani dhe engjëjt e tij rebeluan deri në pikën pa pajtim e kthim mbrapa. Ndërsa Jezusin Perëndia e dërgoi me qëllim që njeriu i mëkatit të bëjë paqe me Të.

### Si e Manifestoi Jezusi Atin

Ati e dërgoi Jezusin për të përmbushur një qëllim të dyfishtë: Në aspektin negativ Jezusi duhej të paguante dënimin për mëkatet tona me qëllim që të kemi falje e të pajtohemi me Perëndinë. Në aspektin pozitiv ai duhet të na zbulonte Atin dhe të na pranonte në familjen e Tij.

Në shumë rrethe kristiane theksohet arsyeja e parë “negative” e ardhjes se Jezusit mbi tokë: për të bërë shlyerjen e mëkateve tona dhe për të na pajtuar me Perëndinë. Ky theksim është i drejtë, sepse ky ishte hapi i parë dhe thelbësori. Megjithatë, kjo pikë kyçe nuk duhet të mbulojë kurrë aspektin e dytë se Jezusi erdhi për të zbuluar Perëndinë si Atë dhe për të na pranuar në familjen e Tij.

Lutja e Jezusit te Gjoni 17 cilësohet si “Lutja e priftërisë më të lartë” të Zotit për dishepujt e tij. Kjo ishte hera e fundit kur ai foli me ta para arrestimit, gjykimit dhe kryqëzimit. Si në fillim, ashtu dhe në fund të lutjes, Jezusi përmend se Ai u i ka bërë të njohur dishepujve emrin e Perëndisë:

“Unë ia kam dëftuar emrin tënd njerëzve që ti m’i ke dhënë nga bota; ishin të tutë dhe ti m’i ke dhënë; dhe ata e kanë ruajtur fjalën tënde” (Gjoni 17:6).

“Dhe i bëra të njohur emrin tënd dhe do të bëj ta njohin, që dashuria, me të cilën ti më deshe mua, të jetë në ta dhe unë në ta”(v. 26).

Cilin emër u dëftoi Jezusi dishepujve? Nuk ishte emri i shenjtë i Perëndisë “Jehova” (ose “Jahwe”).

Këtë emër judejtë e njihnin mirë qysh prej 14 shekujsh. Ky ishte një emër i ri, një emër që megjithëse i përmendur në Dhjatën e Vjetër, kishte mbetur i pazbuluar plotësisht. Ky emër ishte “Atë”. Jezusi në këtë lutje e cilëson Perëndinë gjashtë herë si “Atë” dhe thotë: U kam treguar njerëzve emrin tënd...”

Enciklopedia amerikane Webster e përcakton fjalën “Manifestim” si “bëj publike ose të dukshme nëpërmjet tregimit ose paraqitjes”. Jezusi nuk u ofroi dishepujve të tij vetëm një përcaktim teologjik të Perëndisë; nga mënyra se si Ai e çonte jetën para syve të tyre – një jetë në bashkësi të paprerë dhe në vartësi të plotë ndaj Perëndisë – Ai manifestonte Perëndinë si Atë. Dishepujt kurrë ndonjëherë nuk kishin parë një njeri tjetër që të jetonte si Jezusi.

Te Gjoni 14:6 Jezusi shpjegon se përse erdhi në tokë, kur thotë: “Unë jam udha, e vërteta dhe jeta”. Këtu lind pyetja: Nëse Jezusi është rruga, ku të shpie kjo rrugë? Një rrugë thjesht si rrugë në vetvete është e paplotë; aty ku ka një rrugë, duhet të ketë edhe një qëllim. Po cili është ky qëllim? Fjalët e fundit të këtij vargu japin përgjigjen: “Askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje”. Ne përmendim shumë shpesh se Zoti Jezu Krisht është shpëtimtari ynë, ndërhyrësi, ndërmjetësi etj. Të gjitha këto janë cilësitë e Tij të mrekullueshme, por këtu mbetet pa përmendur qëllimi më i lartë i Jezusit – fakti që Ai na shpie tek Ati.

Lidhur me këtë, ekziston një ndryshim i rëndësishëm midis zbulesës që Perëndia na dha me anë të profetëve në Dhjatën e Vjetër dhe zbulesës që Perëndia na dha me anë të Jezusit te Dhjata e Re. Te Hebrenjve 1:1-2 lexojmë:

“Perëndia, mbasi u foli së lashti shumë herë dhe në shumë mënyra etërve me anë të profetëve, në këto ditët e fundit, na foli me anë të Birit, të cilin e bëri trashëgimtar të të gjitha gjërave, me anë të të cilit e krijoi

## Zbulesa më e lartë e Perëndisë

dhe gjithësinë”. Pjesën e fundit mund ta përkthenim edhe kështu: “[Perëndia] na ka folur në fund të këtyre ditëve në një bir...”

Autori me këtë do të thotë se Perëndia, nëpërmjet shërbimit të Jezusit mbi tokë, nuk bëri thjesht një shtesë të lajmeve që kishin sjellë më parë profetët e Dhjatës së Vjetër. Ai bëri shumë më tepër se kaq: autori na zbulon se Jezusi ishte një lloj krejt i ndryshëm lajmëtari. Ai nuk ishte vetëm profet; Ai ishte Bir. Si i tillë, Ai solli një zbulesë të paekzistuar kurrë më parë, një zbulesë që mund të vijë vetëm nga një bir – zbulesën e Atit.

Te Mateu 11:27 Jezusi thekson se ai është i vetmi që mund ta zbulojë Perëndinë si Atë:

“Çdo gjë m’u dha në dorë nga Ati im, dhe asnjëri nuk e njeh Birin, përveç Atit; dhe asnjëri nuk e njeh Atin, përveç Birit dhe atij të cilit Biri don t’ia zbulojë”.

## Të Mirat (Dobitë) e Njohjes së Atit

Zbulesa e Perëndisë si Atë në të gjitha përmasat, na sjell një dobi të pesëfishtë. Mirëpo bie në sy se te pjesa më e madhe e njerëzve – si edhe te shumë kristianë- i kërkojmë më kot këto pesë ndikime.

### 1. Identitet

Njeriu modern ka probleme serioze me identitetin e vet. Mjafton të përmendim këtu Roots (“Rrënjët”), një nga librat më të suksesshëm në SHBA-në e viteve 70-të, nga i cili lindi një seri televizive me të njëjtin titull. Këtu trajtohet historia e një afro-amerikani (amerikan me origjinë afrikane) i cili bën kërkime për prejardhjen e vet.

Bibla dhe Psikologjia janë të një mendimi se kush nuk njeh babanë e vet, nuk di t’i përgjigjet mjaftueshëm pyetjes: “Cili jam unë?”. Shoqëria jonë e sotme vuan nga kriza e identitetit, pasi marrëdhënia midis prindërve dhe fëmijëve në dy brezat e kaluar është shkatërruar pothuajse plotësisht. Kushedi se sa njerëz enden sa andej këndeje pa rrënjë dhe pa një ndjenjë solide të përkatësisë familjare.

Krishtërimi duhet t’i përgjigjet kësaj krize identiteti duke udhë-

hequr burrat dhe gratë në një marrëdhënie direkte, personale me Perëndinë Atë nëpërmjet Birit të Tij, Jezu Krishtit. Ata njerëz që e njohin me të vërtetë Perëndinë si Atë, nuk kanë më probleme me identitetin e tyre.

Ata e dinë se cilët janë: Fëmijë të Perëndisë. Ati i tyre krijoi Universin, Ati i do dhe kujdeset për ta. Ata janë bërë pjesë e familjes më të mirë të Universit!

## 2. Vetëvlerësim

Gjatë jetës sime kam biseduar me kushedi sa njerëz të cilëve u dukej vetja pa vlerë dhe vuanin shumë nga kjo gjë. Mendonin keq për veten dhe kjo u shkaktonte probleme të mëdha frymërore dhe emocionale. Kur më jepet mundësia t'i këshilloj këta persona, i drejtoj ata te Letra e parë e Gjonit 3:1 ku thuhet: "Shikoni, ç' dashuri të madhe na ka dhënë Ati, që të quhemi bij të Perëndisë! Dhe ne jemi."

Sapo të kemi kuptuar në zemrën tonë se jemi fëmijë të Perëndisë, se vetë Perëndia i Madh na do, se Ai interesohet për ne, se Ai ka gjithmonë kohë për ne dhe se Ai dëshiron të ketë një marrëdhënie direkte, personale me ne, zbulojmë vlerën tonë. Kam qenë vetë dëshmitar i shumë transformimeve në jetët e njerëzve të ndryshëm.

## 3. Vetëdija për atdheun qiellor

Qysh prej shpëtimit tim unë besoj se do të shkoj në qiell pas vdekjes, natyrisht vetëm po u mbajta fort e besnikërisht te Zoti. Por, të tregohem i sigurtë, atdheu im, ku unë e ndieja veten të sigurtë, ishte më shumë toka, sesa qielli. Në vitin 1996, pata një vizitë nga Perëndia, gjatë së cilës unë e njoha Atë direkt dhe personalisht si Atin tim. Qysh nga ajo kohë unë nuk e kam problem ta konsideroj qiellin si atdheun tim. Pak kohë më vonë i thashë Ruthit: "Kur të vdes, më bëj një gur varri dhe shkruaj mbi të vetëm kaq: "Shkoi në shtëpi".

Pastaj më shkoi mendja te lypsari i varfër i cili rrinte shtrirë para derës së pasanikut. Kur vdiq, "...engjëjt e çuan në gji të Abrahamit..."

(Lu. 16:22).

Për të mbajtur atë trup të tharë kockë e lëkurë do të kish mjaftuar

një engjëll i vetëm, por jo, Perëndia dërgoi një eskortë të tërë! Lypsarit iu bë një pritje mbretërore në gji të Abrahamit. Unë them se kështu duhet të ndodhë me çdo fëmijë të Perëndisë. Zoti mban gati një eskortë me engjëj për të na mbartur në atdheun tonë të përjetshëm.

Njëherë Ruthi dhe unë njohëm një motër nga Havai (po e quajmë Meri), e cila i shërbente Zotit me besnikëri prej vitesh. Ajo u thoshte gjithnjë miqve të vet: “Nuk kam parë ndonjëherë engjëj. Kam shumë dëshirë të shoh një të tillë!”

Kur Meri ishte në prag të vdekjes, pasi ishte sëmurë nga kanceri, bashkësia kujdesej që çdo ditë një motër besimi të rrinte pranë shtratit të saj. Një ditë prej ditësh fytyra e Merit rrezatoi lavdinë e Perëndisë. Ajo shtriu krahët dhe tha: “Po i shoh, po i shoh engjëjt!” Dhe ashtu iku. Eskorta e engjëjve e shoqëroi për në shtëpi.

Njëherë Xhon Uesli (ungjilltar i njohur anglez), mori vesh se kishte vdekur një motër besimi, të cilën ai e njihte. Ai bëri pyetjen: “Shkoi me lavdi apo vetëm me paqe?” Unë besoj se Perëndia ka bërë gati një eskortë engjëjsh, e cila i shoqëron me lavdi fëmijët e tij në shtëpinë e Atit.

#### 4. Siguri e plotë

Ku e ka origjinën Universi sipas mendimit tonë? Te shpërthimi fillestar? Nëse po, lind pyetja se çfarë eksplozioni do të vijë më pas për të na shuar me gjithsej?

Ky “Shpërthim” a mos është një forcë e pashpirt, e cila vepron pa marrë parasysh as kuptim, as qëllim e as ndjenja? Apo është një Atë?

Ju do të bëheni një njeri krejt tjetër, nëse arrini të kuptoni së pas çdo formë jete fshihet Atësia e Perëndisë.

Një miku im po ecte njëherë natën vonë nëpër rrugët e shkreta dhe plot erë të një qyteti të madh dhe e ndiente veten shumë të vetmuar. Në rrugë e sipër, vuri re se kish humbur orientimin dhe nuk ishte i sigurtë nëse do ta gjente drejtimin për t’u kthyer te vendi ku banonte. Ndaloi në një qoshe të rrugës dhe përsëriste herë pas here: “Atë”...Atë...Atë...Atë...”.

Aty ndjeu se filloi të fitonte prapë siguri. Megjithëse rreth tij gjithçka ishte e shkretë dhe e ftohtë, ai e dinte se ishte fëmijë i Perëndisë

në një Univers të krijuar nga Ati për fëmijët e Tij. Dhe kështu gjeti i sigurtë rrugën e kthimit për në banesë.

Përfytyroni një fëmijë që struket në krahët e të atit dhe ngjesh fort fytyrën pas supit të tij. Le të bëhet rreth e rrotull rrëmujë e potere. Le të duket sikur po përmbysset bota. Fëmija ka paqe dhe nuk do të dijë se ç'ndodh. Ai gjendet i sigurtë në krahët e të atit.

Edhe ne gjendemi të sigurtë në krahët e Atit tonë. Jezusi na siguroi se Ati është më i madh se çdo gjë që ngjet rreth e rrotull dhe se askush nuk mund të na heqë nga dora e Perëndisë.

Dhe dishepujve të vet Ai u dha këtë garanci: "Mos ki frikë, o tufë e vogël, sepse Ati tuaj i pëlqeu t'ju japë mbretërinë" (Luka 12:32). Ka mundësi që ne të jemi vetëm një tufë e vogël e rrethuar nga gjithfarë bishash të egra. Por, ama, në qoftë se Ati është zotuar të na e japë neve mbretërinë, s'ka forcë në botë që e pengon këtë.

## 5. Të motivuar për shërbesë

Pali na paralajmëron ne shërbëtorët e Zotit te Filipianëve 2:3 "Mos bëni asgjë për rivalitet, as për lavdi të kotë ..." Gjatë viteve kam vënë re se trupi i Krishtit lufton me një problem shumë të fortë e të përhapur nëpër kisha: Udhëheqës frymërorë të dhënë pas ambicies personale. Kjo ambicie i shpie ata në një garë konkurrimi me udhëheqës të tjerë frymërorë. Dua të shtoj se këtë, para se gjithash, unë e kam vënë re në jetën time.

Ne bëjmë shpesh gabimin ta kërkojmë sigurinë te sukcesi. Mua, si të thuash, do të më japë siguri fakti se po ngre ndërtesën më të madhe për bashkësinë, apo se po organizoj takimet më të mëdha, apo se paskam listën më të gjatë të adresave. Ky është një mendim jashtëzakonisht i gabuar. Sepse, në fakt, ndodh krejt e kundërta. Sa më shumë të kapem pas suksesit, aq më pak siguri do të kem, sepse do ta ndiej veten vazhdimisht të kërcënuar nga mendimi se mos dikush tjetër ndërton një bashkësi ende më të madhe, organizon takime edhe më madhështore ose ka edhe më shumë emra në listën e adresave sesa unë.

Sa për veten time, unë kam Jezusin si shembull të përkryer personal dhe ai thotë: "Ati s'më ka lënë vetëm, sepse unë bëj vazhdimisht gjërat që i pëlqejnë" (Gjoni 8:29).



## Zbulesa më e lartë e Perëndisë

Sa më shumë kalon koha, aq më pak e lë veten të udhëhiqem nga motivi i ambicies. Kam gjetur një motiv shumë më të bukur e të pastër. Dua t' i pëlqej vetëm Atit tim. E kam bërë zakon që në çdo situatë dhe para çdo vendimi t' i bëj vetes pyetjen: Si mund t' i pëlqej Atit tim? Kur më mbytet merakuri ose jam në prag të dështimit, mundohem të mos e vras vazhdimisht mendjen për zgjidhjen e problemit, por kujdesem për të pasur në zemër atë qëndrim që i pëlqen Atit.

Ne jemi shërbëtorë të Krishtit dhe s' kemi pse të hyjmë në konkurrencë me njëri-tjetrin, në qoftë se udhëhiqemi të gjithë nga dëshira për t' i pëlqyer Atit tonë të përbashkët. Dhe kështu, në vend të fërkimeve dhe ambicies, hyn harmonia dhe kujdesi për njëri-tjetrin.

Po ta njohim Perëndinë si Atin tonë, e kemi të hapur këtë rrugë dhe shumë të tjera! Kush ka gjetur Jezusin, Udhën, le të gëzohet! Por nuk duhet të ngelemi të kënaqur me kaq dhe ta kalojmë jetën vetëm duke ecur te rruga pa arritur te qëllimi, d.m.th. te njohja e Perëndisë si Atë. Po nuk e arritëm këtë qëllim, atëherë Perëndia e dërgoi Jezusin më kot.

Zbulesa e Perëndisë si Atë qiellor na çon automatikisht te një temë tjetër: Si ta pasqyrojnë etërit tokësorë atësinë e Perëndisë në familjet e tyre?



## 8

# Ati si Prift

Perëndia të vërtetat nuk i shkruan vetëm në letër, por edhe i rrënjos ato te njerëzit. Ne kemi Biblën dhe falenderojmë Perëndinë për fjalën e shkruar. Por Jezusi tha: “Unë jam e vërteta”. Shumica prej jush do të ma miratojnë mendimin se të vërtetat abstrakte nuk e kënaqin kurrë plotësisht njeriun. Ajo që na jep kënaqësi të thellë është e Vërteta si Person. Lidhja me abstrakten nuk mjafton; ne kemi nevojë për lidhje me një person.

Në kohën kur kisha si profesion filozofinë, thellohesha në gjithfarë teorish mahnitëse mbi jetën, kuptimin e jetës dhe “shtetin ideal” të Platonit. Mirëpo problemi ishte se unë nuk mund të jetoja vazhdimisht në këtë sferë ideale. Gjysmën e parë të javës e kaloja në sferën e ngritur të “Teorisë së ideve”, gjysmën tjetër me të dyja këmbët në tokë duke jetuar sipas mishit. Nuk isha kurrë i kënaqur plotësisht, sepse të vërtetat thjesht abstrakte nuk të kënaqin asnjëherë aq sa duhet. Kur takova Jezusin, e dija se kisha takuar të Vërtetën si Person. Kjo më dhuroi atë kënaqësi që nuk e pata kurrë nga të vërtetat abstrakte.

Në njëfarë mënyre, Perëndia i ka ngarkuar çdo ati tokësor përgjegjësinë për të mishëruar në personin e vet zbuluesin më të lartë të Biblës, d.m.th. atësinë. Të jesh atë i vërtetë do të thotë të paraqitesh Perëndinë në mënyrën më të përkryer që është e mundur, pasi atësia, për nga rangu, është zbuluesi më i lartë e Personit të Perëndisë. Kështu pra, çdo baba përfaqëson Perëndinë në familjen e vet. Ky është

fakt; këtu nuk ka vend për diskutime. Shtrohet vetëm kjo pyetje: E përfaqësoni Perëndinë si Atë për të mirë, apo për të keq?

Mallkimi më i madh i kohës sonë janë etërit që e përfaqësojnë keq Perëndinë. Dëgjova njëherë në rrugë një burrë kristian tek jep-te dëshmi për Jezusin para një grupi të rinjsh. Ai i tha një djali që kalonte aty pari: "Perëndia dëshiron të jetë Ati yt." Djali ia ktheu : "Im atë është njeriu më i urryer për mua në këtë botë". Prandaj kjo ofertë e Perëndisë atë nuk e gëzoi, por e tmerroi! Ne të gjithë njohim etër të tillë.

Le të vazhdojmë të trajtojmë pyetjen se ç' do të thotë të jesh atë.

"Por dua që të dini se kreu i çdo burri është Krishti, edhe kreu i gruas është burri; dhe kreu i Krishtit është Perëndia."

(1 Kor.11:3)

Vargun e autoritetit nga lart-poshtë po e paraqesim kështu:

Perëndia Atë  
Krishti  
Bashkëshortit  
Bashkëshortja

Dy persona në mes të këtij vargu kanë lidhje si me lart ashtu edhe me poshtë. Krishti sipër ka lidhje me Atin dhe poshtë me burrin. Burri sipër ka lidhje me Krishtin dhe poshtë me gruan dhe nëpërmjet gruas, me familjen e vet.

Ashtu si Krishti përfaqëson Perëndinë para burrit, edhe burri ka përgjegjësinë të përfaqësojë Krishtin para familjes së vet. Çfarë detyrë i ngarkohet një babai!

Sipas mendimit tim, ka tre shërbime qendrore të Jezusit, të cilat një atë duhet t'i marrë përsipër para familjes së tij. Prift, profet dhe mbret. Në këtë kapitull dhe në kapitullin që vjen, do t'i trajtojmë një nga një këto shërbime.

Suksesi i babait si prift është premisë për suksesin si profet dhe mbret. Po të ketë sukses si prift, ka shumë të ngjarë që të ketë sukses edhe në dy shërbimet e tjera. Por, nëse ai nuk e kupton se ç' do të

thotë të jesh prift në familje, do ta ketë të vështirë të jetë profet dhe mbret.

Koncepti “flijim” ka të bëjë në mënyrë specifike me priftërinë. Sipas modelit biblik, flijimin e bën vetëm prifti. Prandaj babai, si prift, ka për detyrë të shenjtë bërjen e flijimit për familjen e tij.

Më poshtë po numërojmë katër pikat më të rëndësishme të flijimit që bën babai për familjen:

1. Falenderim
2. Lutja e ndërmjetësimit
3. Të përgatisë rrugën e shpëtimit
4. Të ketë besim për fëmijët e tij

## 1. Falenderimi

Shërbimi ynë parësor si priftër të Dhjatës së Re përshkruhet te Hebrejve 13:15

“Me anë të Jezusit, pra, le t’i ofrojmë vazhdimisht Perëndisë një flijim lavdie, domethënë frytin e buzëve që rrëfejnë emrin e tij”.

Pika kulminante e bekimit priftëror të folur nga Aaroni dhe pasardhësit e tij mbi popullin e Izraelit ishte:

“Kështu do ta vënë emrin tim mbi bijtë e Izraelit dhe unë do t’i bekoj”  
(Numrat 6:27).

Dy lutjet më të efektshme që mund të bëjmë për njerëzit e tjerë, janë lutjet e lavdërimit dhe të falenderimit, me të cilat thërrasim emrin e Zotit Jezus mbi ta. Kur vëmë mbi ta emrin e Jezusit, lusim për ta bekimin e Perëndisë.

Vetëm pak prej nesh e kanë të qartë se sa shumë i ndërtojmë ne njerëzit në Frymë, nëse nisim të lavdërojmë Zotin për ta. Ky është një aspekt qëndror i lutjes me ndërhyrje.

Ndoshta keni dëgjuar ndonjëherë për një burrë, të cilin e thërrisnin “Hyde (Haidi) lutës.” Ai ishte një misionar i shkëlqyer dhe jetonte në Panxhab të Indisë, në shekullin e kaluar, kur India ende ndodhej

nën sundimin britanik. Shërbesa e Haidit ishte lutja; gjithçka tjetër ishte për të e dorës së dytë.

Aty nga koha kur sapo kish nisur këtë shërbim, ai takohet me një ungjilltar indian, i cili atij (Haidit) iu duk i paefektshëm dhe me zemër të ftohtë. Kur nisi të lutej për këtë burrë, ai tha: “O Zot, ti e di se sa...”

Në fakt, ai deshi të thotë “... se sa zemër të ftohtë ka vëlla filani...” por Fryma e Shenjtë e ndërpreu me Fjalët e Urta 30:10: “Mos shpif kundër shërbëtorit para të Zotit”.

Prandaj vëlla Haidi mendoi një taktikë tjetër: Ai vrau mendjen për të gjetur anët e mira të këtij burri dhe zuri të falenderonte Perëndinë për të. Brenda disa muajsh kristiani indian u bë një ungjilltar jashtëzakonisht i suksesshëm.

Si erdhi ky ndryshim? Vëlla Haidi nuk bëri shpifje dhe akuza në lutje, por falenderim.

Dua t’u lutem me gjithë zemër bashkëshortëve dhe baballarëve: Gjeni më shumë kohë për të falenderuar Perëndinë për anëtarët e familjes suaj, sepse në këtë mënyrë krijoni rreth tyre një atmosferë e cila e bën të lehtë suksesin.

Në SHBA të has shpesh syri mbi makina letërngjitëse me këto fjalë: “E keni përqaftuar sot fëmijën tuaj?” Kjo është një pyetje e rëndësishme, por jo më pak rëndësi ka pyetja: “E keni falenderuar sot Perëndinë për fëmijën tuaj?”

Mua Perëndia më ka dhënë një mësim: Nëse nuk falenderoj dot për një person, nuk kam as të drejtën të lutem për të; është më mirë të mos lutem fare, pasi lutja ime do të sillte më shumë dëm sesa dobi.

## 2. Lutja e Ndërmjetësimit

Le të merremi tani me figurën e një burri, i cili, në Dhjatën e Vjetër, qe një prift shembullor për familjen e vet: Jobi. Në fillim të librit lexojmë se Jobi ishte një burrë i përkryer e i çiltër para Perëndisë. Të shtatë bijtë dhe të tre bijat e tij takoheshin një herë në javë në shtëpinë e njerit nga vëllezërit për të ndenjtur bashkë dhe për të festuar. Në fund të çdo jave, Jobi ngrihej herët, bënte flijimin për të gjithë fëmijët e vet dhe thoshte: “Ndofta bijtë e mi kanë mëkatuar dhe e kanë blas-

femuar Perëndinë në zemrën e tyre” (Job. 1:5). Duke bërë flijimin, Jobi kërkonte të merrte edhe bekimet që lidheshin me këtë flijim.

Ky është një shembull i lutjes së ndërmjetësimit: të kërkojmë të marrim bekimet e lidhura me flijimin për njerëzit për të cilët lutemi.

Në epokën ku jetojmë, flijimi ynë është sakrifica e Jezusit në kryq. Kështu, lutja ndërmjetësuese për fëmijët tanë është kërkesa për të marrë për ta bekimet që solli vdekja e Jezusit në kryq.

Ndonjë cinik ndoshta do të argumentonte: “Mirë, mirë, po ja që Jobit nuk i bëri punë lutja!” Ashtu është, kur ndodhi katastrofa, vdiqën të gjithë fëmijët.

Por, duhet të lexojmë deri në fund se ç’thotë Bibla në këtë rast.

Pasi Jobi i mësoi leksionet e rënda, ai u rehabilitua në mënyrë të shkëlqyer – por vetëm pasi mësoi të lutet për ata që e kritikuan (krahaso Jobi 42:8-10). Nga kjo nxjerrim këtë mësim: Le të mos stepemi e të zbrapsemi para atyre që na kritikojnë. Përkundrazi, akuzat e tyre le t’i shohim si shkallë me anë të të cilave ngjitemi edhe më lart. Kur të lutemi për ta, Perëndia do të sjellë Hirin e Tij mbi ne.

Le të lexojmë me hollësi se si u rehabilitua Jobi:

“Zoti i bekoji vitet e fundit të Jobit më tepër se vitet e para, sepse ai pati katërmbëdhjetë mijë dele, gjashtë mijë deve, një mijë pendë qe dhe një mijë gomare. Pati gjithashtu shtatë bij dhe tri bija”

(Jobi 42:12-13).

Jobi mori dyfishin e kafshëve të mëparshme, por fëmijë po aq sa ç’kishte pasur më parë. Përse nuk e dyfishoi Perëndia numrin e fëmijëve? Me sa kuptoj unë, lutjet e Jobit ranë në vesh të Perëndisë dhe ja sesi: Megjithëse fëmijët e parë shkuan në përjetësi, ata tani gjendeshin nën kujdesin e Perëndisë në atë vend ku të gjithë të vdekurit e drejtë prisnin shpëtimin e ardhshëm me anë të Jezu Krishtit. Kur Perëndia i dhuroi Jobit edhe njëherë dhjetë fëmijë, në të vërtetë Ai e dyfishoi numrin e tyre, pasi dhjetë të parët vetëm sa shkuan pak më përpara në përjetësi dhe prisnin atje babanë e tyre.

Lutja ndërmjetësuese e Jobit ia vlejti! Po, duket qartë se sa të rëndësishme e konsideronte ai lutjen për familjen e vet. Këtij burri të Perëndishëm as që i shkante mendja se mund të ndodhte ajo mynxyrë

që do t'ia rrëmbente fëmijët brenda një çasti. Pas katastrofës lutja nuk do të kish bërë më dobi — Jobi u lut përpara.

Çdo baba, duke pasur funksionin e priftit për familjen e vet, duhet të mësojë nga Jobi. Të gjithëve mund të na ndodhë një tragjedi e papritur apo katastrofë, e cila na rrëmben brenda një çasti anëtarë të familjes — këtu nuk kemi asnjë lloj garancie. Prandaj, çdo baba është përgjegjës para Perëndisë — që të bëjë lutje ndërmjetësuese ditë për ditë dhe me besnikëri për gjithë familjen e vet.

Gjithashtu, nuk duhet të bëjmë gabim dhe të presim që të na dëgjohen lutjet vetëm këtu mbi tokë dhe vetëm në kohën e tanishme. Efektin e vërtetë të lutjeve tona do ta dallojmë, vetëm kur të shkojmë në përjetësi.

### 3. Të Përgatisë Rrugën e Shpëtimit

Te rregullat për festimin e Pashkës ndeshemi me një shembull të jashtëzakonshëm të shërbimit priftëror të një babai. Me anë të flijimit të qengjit të pashkës, Izraeli u nxorr nga skllavëria egjiptiane për t'u bërë një komb i ri. Egjiptianët, të cilët nuk kishin flijim, i zuri gjyqi i Perëndisë dhe u mori gjithë të parëlindurit.

Te rregullat e pashkës, babai luante rolin kryesor. Askush tjetër nuk mund të bënte atë që duhet të bënte ai. Çdo baba kishte përgjegjësinë të kujdesej për një flijim për shtëpinë e vet, ashtu siç ia kishte ngarkuar Perëndia Moisiut:

*"I thoni gjithë asamblesë së Izraelit: 'Ditën e dhjetë të këtij muaji çdo burrë të marrë për vete një qengj, sipas madhësisë së familjes së atit, një qengj për shtëpi'."*

(Eks. 12:3)

Babai duhet të bënte edhe diçka tjetër për të garantuar efektin e flijimit. Moisiu i tha popullit:

*"Pastaj do të merrni një tufëz hisopi, do ta ngjyeni në gjakun që është në legen dhe me gjakun që është në legen do të spërkatni arkitraun dhe të dyja shtalkat e dyerve; dhe asnjë prej jush nuk do të dalë nga dera e shtëpisë së tij deri në mëngjes. Sepse Zoti do të kalojë për të*



goditur egjiptasit; por kur do të shohë gjakun mbi arkitraun dhe mbi dy shtalkat, Zoti do të kalojë më tej derës dhe nuk do ta lejojë shkatërruesin të hyjë në shtëpitë tuaja për t'ju goditur”

(Eks. 12:22-23).

Kush e kishte përgjegjësinë për të zgjedhur qengjin? Babai i çdo familjeje. Kush e mbante përgjegjësinë për të therur qengjin? Babai. Kush e kishte përgjegjësinë për të lyer trarët e portës së shtëpisë me gjakun e qengjit? Babai.

Me fjalë të tjera: Perëndia i kishte ngarkuar babait shërbimin e priftërisë për familjen e tij. Ai kishte përgjegjësinë të kujdesej që në familjen e tij të zbatohej plani shpëtues i Perëndisë.

Në kohët e sotme ka ndryshuar vetëm flijimi, ndërsa përgjegjësia e babait është po e njëjta.

#### **4. Të Ketë Besim Për Fëmijët e Tij**

Tregimi dramatik mbi djalin epileptik te Marku 9, na jep shumë leksione besimi. Pasi dishepujt nuk mundën ta shëronin djalin, babai i këtij e shpie atë te vetë Jezusi. Pasi babai përshkruan vuajtjet e të birit, Jezusi ia kthen:

“Nëse ti mund të besosh, çdo gjë është e mundshme për atë që beson. Menjëherë babai i fëmijës, duke bërëtitur me lot, tha: “Unë besoj, o Zot, ndihmo mosbesimin tim!”

(Marku 9:23-24)

Te kjo histori mua më bën përshtypje se djali nuk mund të kishte besim për veten e tij; Zoti ia ngarkoi babait përgjegjësinë për të besuar për djalin e vet. Këtu unë dalloj një parim të përgjithshëm: Perëndia ua ngarkon etërve përgjegjësinë që të kenë besim për fëmijët e tyre.

Kur Perëndia më thirri në shërbimin e çlirimit nga frymërat, mu bë i qartë një parim, i cili përshkon si fill i kuq shërbimin e Jezusit. Shpesh nëpër takime vinin te podiumi njerëz me fëmijë për dore ose në krah dhe thoshin: “Të lutem, lutu për këtë djalë ose për këtë vajzë.” Unë e kisha zakon të bëja këtë pyetje: “Fëmija juaj është?” Shpesh

përgjigja ishte: “Jo, nuk është i yni. Prindërit nuk janë besimtare, por ne duam që fëmija të marrë lutje.”

Ju bëj thirrje ta vlerësoni këtë situatë sipas shembullit të shërbimit të Jezusit: Ai lutej për një fëmijë gjithmonë vetëm mbi bazën e besimit të njërit apo dy prindërve të fëmijës. Prandaj ne nuk gjejmë në shërbesën e tij asnjë rast të veçantë, ku Ai të lutet për një fëmijë pa qenë i pranishëm së paku njëri nga prindërit. Prindërit mbajnë një përgjegjësi shumë më të madhe nga ç’ mendojmë.

Mirëpo, si të sillemi me një fëmijë, prindërit e të cilit nuk janë besimtarë? Perëndia në sovranitetin e tij, mund t’i dhurojë besim të veçantë dikujt që nuk ka lidhje gjaku me fëmijën. Po, më kujtohet se këtë Ai e ka bërë edhe në shërbesën time.

Por unë dua të nxjerr në pah anën pozitive, jo atë negative dhe theksoj prapë: Prindërit kanë marrë nga Perëndia përgjegjësinë që të praktikojnë besim për fëmijët e tyre.

Le të përmbledhim edhe njëherë katër sferat më të rëndësishme të përgjegjesisë së një babai si prift në familie.

1. Falenderim.
2. Lutja e ndërmjetësimit
3. Të përgatisë rrugën e shpëtimit
4. Të ketë besim për fëmijët e tij

Në kapitullin e ardhshëm do të trajtojmë nga afër funksionin e dytë të babait: shërbimi si profet në familje.

## Ati si Profet

Le të shohim tani përgjegjësinë e babait si profet i familjes.

Ndryshimi midis funksionit si prift dhe funksionit si profet është pak a shumë ky: Si prift, ai përfaqëson familjen para Perëndisë; si profet ai përfaqëson Perëndinë para familjes. Dhe këtu mos harroni se profetin nuk e bëjnë profet vetëm fjalët që thotë, por dhe gjithë sjellja e tij.

Le të marrim katër shembuj për ta konkretizuar këtë:

### 1. Përfaqësimi i Perëndisë Nëpërmjet Shembullit Personal

Babai përfaqëson Perëndinë para familjes së tij duke qenë vetë shembull; kjo është mënyra më e mirë për t'u bërë i ngjashëm me Perëndinë. Por kjo medalje ka dy anë: Babai mund ta përfaqësojë Perëndinë para familjes për mirë ose për keq.

Është babai i dashur, i afrueshëm, i dhembshur dhe i fortë? Nëse babai është i tillë, fëmija nuk e ka të vështirë ta përfytyrojë kështu edhe Perëndinë. Por kur babai vetëm nxin, zemërohet, kritikon ose rri vazhdimisht larg familjes dhe nuk çan kokën, fëmija e fillon jetën me një përfytyrim negativ për Perëndinë. Dhe, për të korrigjuar këtë përfytyrim të shtrembëruar, nevojitet një kohë e gjatë.

Përmenda më parë atë djalin që tha: "Im atë është për mua njeriu më i urreyer në këtë botë!" Duket sheshit se ky baba e kishte përfaqësuar keq Perëndinë para të birit.

Si mund të veprojë babai si profet në familje për të mirë dhe jo

për të keq? Para së gjithash me anë të dashurisë. Çdo fëmijë, që sa hap sytë, ka nevojë për dashuri. Dashuria e nënës është e bukur dhe e pazëvendësueshme, por ajo nuk mjafton. Dashuria e babait është e një lloji tjetër. Ajo është e aftë t'i transmetojë fëmijës qysh në vogëli ndjenjën e forcës, të sigurisë dhe vetëdijën se është i rëndësishëm dhe i vlefshëm për veten e për të tjerët.

Mungesa e kësaj dashurie shkakton te fëmija një plagë të thellë; Atij i duket vetja i braktisur, i parëndësishëm e i padëshirueshëm. Në fund të fundit, kjo plagë e vrau Jezusin në kryq: Braktisja e Atit. Ai klithi: "Perëndia im, Perëndia im, përse më ke braktisur?" (Mr. 15:34) por nuk mori përgjigje. Pastaj vari kokën dhe dha frymë.

Këto janë pasojat e fundit të llahtarshme që duroi Jezusi, ngaqë e bëri veten një me mëkatin e mbarë njerëzimit. Ligësia e mëkatis është kaq e tmerrshme, saqë edhe vetë Ati Perëndi u detyrua të mbylle veshët ndaj klithjes së Birit të Tij të dashur. Por mos harroni: Jezusi duroi braktisjen tonë me qëllim që ne të pranohemi nga Perëndia.

Miliona njerëz në shoqërinë e sotme vuajnë nga plagët e braktisjes. Shumë prej tyre nuk kanë njohur as dashuri nëne e as dashuri babai. Të tjerë shijuan dashurinë e nënës, por jo atë të babait. Në shumicën e rasteve, plaga e braktisjes nuk mund të diagnostikohet saktë. Ai që e ka këtë lloj plage, e kalon gjithë jetën me ndjesinë se i mungon diçka, por nuk di të thotë se çfarë i mungon.

Kjo plagë shfaqet me anë të simptomave pasive ose aktive. Nga ana pasive këto simptoma mund të shfaqen në njërën ose në të gjitha këto forma: Depresion, cinizëm, mungesë motivacioni, mungesë shprese dhe së fundi, tendencë vetëvrasjeje. Nga ana aktive shfaqen në formën e zhgënjimit, zemërimit, rebelimit kundrejt autoriteteve, dhunës, kriminalitetit dhe së fundi, vrasjes. Sipas mendimit tim, shumë krime dhe akte dhune në botën perëndimore, të kryera nga motive të pashpjegueshme, e kanë burimin te një fakt i thjeshtë dhe i padiskutueshem: Mungesa e dashurisë së baballarëve për fëmijët.

Shpeshherë problemi nuk qëndron te mungesa e dashurisë së baballarëve ndaj fëmijëve, por te mënyra e shfaqjes së dashurisë. Dashuria e pashfaqur nuk i kënaq nevojat e fëmijës.

Në shumë aspekte unë kam përjetuar një fëmijëri të këndshme. Por anëtarët e familjes sime i përkisnin asaj shtrese të shoqërisë angleze, e

cila tregohej në çfarëdolloj rrethane superiore (shprehja angleze quhet: “buzëngrirë”). Atje nuk duhet të tregosh pothuaj kurrë ndjenja apo ngrohtësi njerëzore. Kjo nuk do të thotë sa ata nuk kishin në zemër ndjenja apo ngrohtësi, por disa rregulla të pashkruara shoqërore i pengonin për t’i shfaqur ato. P.sh. mua nuk më kujtohet të jem ulur ndonjëherë në prehër të tim eti. Kështu që në personalitetin tim mbeti një boshllëk, i cili mbushet dalëngadalë sa më shumë thellohet marrëdhënia ime me Atin Perëndi.

Kam konstatuar gjithashtu se dashuria atërore e Perëndisë kurrë nuk është sentimentale apo e dobët. Ai nuk i bën rrugë tekave apo nazeve të fëmijëve të tij. Përkundrazi: Dashuria e Tij shprehet nëpërmjet një disipline të rreptë. “Sepse Zoti ndreq atë që do; dhe fshikullin çdo bir që ai pranon” (Heb. 12:6).

Te libri i Fjalëve të Urta, Salomoni thekson herë pas here se sa e rëndësishme dhe e pazvëndësueshme është disiplina atërore. Ja disa shembuj: “Kush e kursen thuprën, urren birin e vet, por ai që e do e mëson me kohë (Fja. 13:24). ose: “Ndreqe birin tënd, ai do të të japë rehatinë dhe do t’i sigurojë kënaqësi shpirtit tënd” (Fja. 29:17)

Përvoja na tregon se sa të shëndetshme janë propozimet e Salomonit. Nëse fëmijët nuk marrin edukatë, si zor të ketë paqe në familje. Meqë babai është kreu i familjes, parimisht ai është edhe përgjegjës për çfarëdolloj disipline dhe edukimi. Mirëpo nganjëherë këto mund të zbatohen nga nëna. Rëndësi ka që disiplina prindërore të jetë konsekuente. Të dy prindërit duhet të jenë në një mendje për sa i përket zbatimit të disiplinës. Nëse nuk ndodh kështu, ka të ngjarë që fëmijët të përpiqen të fusin prindërit në sherr me njëri-tjetrin.

Gjatë procesit të disiplinimit duhen luftuar dy faktorë. Faktori i parë është kryeneçësia e fëmijës. Për të luftuar këtë kryeneçësi apo rebelim duhet zbatuar një disiplinë e vendosur dhe konsekuente.

Mos u lejoni fëmijëve të bëjnë me kokë të tyre dhe të veprojnë pa pikë përgjegjësie apo t’ju kthejnë përgjigje të paturpshme. Kërkoni që ata ta zbatojnë fjalën tuaj menjëherë dhe pa kundërshtim.

Por ruhuni nga ekstremi tjetër – dekurajimi. Nëse babai tregohet i ashpër, kritik dhe kërkues pa të drejtë, fëmija dekurajohet dhe mendon: “Ç’ të lodhem kot, babi nuk ngelet kurrë i kënaqur prej meje. As nuk ia vlen mundimi.”

Pali thotë dy gjëra mbi këtë temë: “Ju etër, mos provokoni për zemërim bijtë tuaj, që të mos i lëshojë zemra” (Kol. 3:21) dhe “Dhe ju, etër, mos provokoni për zemërim fëmijët tuaj” (Ef. 6:4)

Unë u kam shërbyer shumë njerëzve me probleme të rënda emocionale. Dhe kushedi sesa herë kam arritur në përfundimin se mungesa e dinjitetit dhe ndjenja e dështimit rridhnin nga një ngjarje e fëmijërisë, ku personi kishte pësuar një trajtim negativ nga ana e prindërve: Ndoshta ishte kritikuar dhe tallur pa të drejtë apo qortuar pa arsye në prani të të tjerëve – ose dhe më keq. Kjo sjellje negative kishte hapur në shpirtin e fëmijës një plagë, e cila vazhdonte të rrinte hapur edhe pas 20 apo 30 vjetësh.

Ju si baba, nga njëra anë duhet të zbatoni disiplinë dhe nga ana tjetër të keni kujdes që të mos e dekurajoni fëmijën me kërkesa të padrejta ose të tepruara.

## **2. Përfaqësimi i Perëndisë Me Anë të Mësimit**

Ruajtja e disiplinës brenda vatrës familjare ju përgatit rrugën për aspektin e dytë të shërbimit si profet në familje, d.m.th. instruktimin në rrugët dhe fjalën e Perëndisë.

Kur isha rektor i një kolegji që përgatiste arsimtarë në Kenia, m’u bë e qartë se kush nuk i disiplinon nxënësit nuk mund tu japë dot as mësim. Prandaj kemi sot kaq shumë fëmijë të cilëve u mungon arsimimi. Por kur përdorim disiplinë, kemi mundësi të japim mësim.

Pali thotë: “Dhe ju, etër, mos provokoni për zemërim fëmijët tuaj, por i rrisni në disiplinë dhe në këshillë të Zotit” (Ef. 6:4).

Sipas këtij vargu, mbi kë bie përgjegjësia parësore për t’u mësuar fëmijëve të vërtetën e fjalës së Perëndisë? Babait. Por kush e zbaton më shpesh? Nëna. A është ky rregulli i Perëndisë? Jo. Nëse fjala e Perëndisë instruktohet në këtë mënyrë, ka tepër të ngjarë që Gjoni i vogël, kur të mbushë 12 vjeç të thotë: “Dua të bëhem si babi kur të rritem. Ai nuk shkon në kishë dhe nuk e lexon Biblën. Ashtu do të bëj edhe unë.” Kjo është një nga arsyet pse në disa bashkësi anëtarët gra përbëjnë dyfishin e anëtarëve burra!

Perëndia i bekoftë ato gra që detyrohen të instruktojnë familjet e tyre ngaqë babai ka dështuar në këtë pikë! Problemi është se djemve u krijohet përshtypja se krishtërimi është punë grash. Prandaj, ato

gra që kanë për detyrë të instruktojnë bijtë e tyre, duhet të kujdesen që bijtë të mbajnë kontakt me një burrë si udhëheqës frymëror.

Moisiu u jep baballarëve një këshillë të urtë të habitshme në lidhje me instruktimin frymëror në familje: “Do t’i shtini [Ju, etër] këto fjalë në zemrën dhe në mendjen tuaj, do t’i lidhni si një shenjë në dorë dhe do të jenë si ballore midis syve” (Lip. 11:18). Me fjalë të tjera: Fjala e Perëndisë duhet të jetë një tipar dallues në jetën e tyre!

Në këtë varg nga Ligji i Ripërtërirë 11, kam shtuar në kllapa fjalën “etër”. Këtu dua të qartësoj një tipar të tekstit origjinal hebraik, i cili nuk del në pah në përkthimin shqip. Foljet dhe përemrat hebraikë marrin sipas rastit një formë tjetër gramatikore kur folësi apo dëgjuesi (marrësi i ligjëratës) është i gjinisë mashkullore ose femërore. Në fragmentin e cituar më lart, të gjitha fjalët janë të formës mashkullore. D.m.th. Moisiu, në radhë të parë ua drejton udhëzimet etërve (pa përjashtuar nënat). Kjo nuk do të thotë se nënat nuk duhet të përzihen në instruktimin e fëmijëve të tyre. Kjo do të thotë se në çdo familje duhet të vlejë babai si autoritet i instruktimit.

Te Lip. 11:19 Moisiu vazhdon: “Do t’ua mësosh bijve tuaj, duke u folur për to kur rri ulur në shtëpinë tënde, kur ecën rrugës, kur rri shtrirë dhe kur çohesh.”

Çdo situatë e jetës familjare mund të japë rast për t’u mësuar fëmijëve fjalën e Perëndisë. Mos u kufizoni në një “kornizë frymërore” vetëm në një ditë të javës.

Për vite me radhë kam bërë shërbesa midis fëmijëve të shumë udhëheqësve frymërore. Për këta fëmijë besimi ishte shpeshherë si një kostum, të cilin ata e vishnin të dielën kur shkonin në bashkësi. Kur ktheheshin në shtëpi ata e zhvishnin këtë kostum, e futnin në dollap dhe e vishnin përsëri të dielën e ardhshme. Ky ishte gabimi i prindërve, sepse që besimi të ketë vlerë, ai duhet bërë pjesë e jetës së përditshme familjare.

Kam përmendur te kapitulli i parë se Lydia, para martesës sonë, ishte nënë adoptive e tetë vajzave të cilat i rriste vetëm. Familja ishte shumë ngushtë nga paratë dhe shpeshherë nuk dinin se ç’do të hanin të nesërmen. Lydia i mblidhte vajzat për t’u lutur së bashku. “Vajza”, – thoshte ajo, “nuk kemi asgjë për mëngjes. Duhet të lutemi.” Ato luteshin dhe ushqimi u vinte. Duke përjetuar vetë-dëgjimin e

lutjeve prej Perëndisë vajzat mësuan më shumë sesa nga leksionet fetare të mbajtura në shkollën e së dielës!

Mos i mbani kurrë larg fëmijët nga jeta juaj frymërore. Përfshijini në të. Kur të shkoni me pushime, lutuni së bashku se ku do të shkoni dhe se çfarë do të ndërmerrni. Nëse fëmija ka probleme me shkollën, përkraheni jo vetëm duke e ndihmuar të zgjidhë problemin, por edhe duke thënë: “Eja të lutemi bashkë për këtë.”

Kur fëmijët mësojnë të luten, ata rriten duke u bërë besimtarë. Këtë e them nga përvoja. Të gjitha vajzat tona janë përballuar me tundime të ndryshme; që të gjitha janë gjendur herë pas here para provash dhe problemesh të vështira. Por të gjithave iu kujtohen ato kohë kur Perëndia dëgjonte lutjet e tyre.

Kur Lydia dhe unë shërbenim si misionarë në sistemin arsimor të Kenias, shkuam njëherë në një konferencë kristiane në Mombasa. Kishim marrë me vetë edhe vajzën tonë 18 vjeçare, Elizabetën. Elizabeta ishte shumë miopë dhe aftësia e të parit i keqësohej vazhdimisht. Vit për vit kishte nevojë për syze me xham gjithnjë e më të trashë. Prandaj i thamë predikuesit në Mombasa: “A mund të luteni për sytë e Elizabetës?” Ai u lut dhe Elizabeta i hoqi syzet pa ia kërkuar njeri këtë! Disa ditë më vonë ne e pyetëm se si ndiehej.

“Si i ke sytë?” – deshëm të dinim.

“E si t’i kem” – na e ktheu ajo, “ai u lut, apo jo?”

Më vonë konstatoam se Elizabeta shihte shkëlqyeshëm dhe ajo i dha provimet në shkollën e infermierisë pa përdorur syze!

Vajza jonë, Elizabeta, kaloi të njëjtat prova si të gjithë kristianët. Por një gjë ajo nuk e vinte kurrë në dyshim – se Perëndia është real! Çfarë vërtetimi kishte ajo për këtë? Sytë e shëruar!

Përjetimi i dëgjimit të lutjeve është një spirancë për ata që janë në rrezik të përfshihen nga valët e furishme të kësaj bote. Prandaj kujtojeni fëmijët se çfarë ndodhte kur luteshit bashkë me ta.

Një shoku im, edhe ai në shërbimin frymëror, ka katër vajza. Në kohën e fëmijërisë ato ishin si vajzat e Filipit (krahaso Vep. 21:8-9). Megjithëse të vogla, kishin shërbim profetik dhe fusha të veçanta përgjegjësie në lutje. Njëra lutej për financat, tjetra për shërim, e treta për problemet në shkollë dhe e katërta për çështje të tjera. Duke qenë të përfshira në jetën frymërore familjare, ato i kishin rrënjët te Krishti.



Si rrjedhim, marrëdhëniet e afërta midis anëtarëve të familjes mbetën të tilla edhe kur ato u martuan.

Ju nuk i beconi fëmijët, kur i mbani larg çdo përgjegjësie. Përkundrazi, sa më shumë përgjegjësi t' u ngarkoni, aq më të fortë bëhen ata. Por kujdes, këtë bëjeni hap pas hapi dhe me shumë mençuri.

### **3. Komunikim Në të Dyja Drejtimet.**

Kush do t' i mësojë familjes së tij rrugët e Perëndisë, ka nevojë për kanale të hapura komunikimi. Megjithëse ka shumë libra dhe mësues biblikë mbi temën “komunikimi në familje”, unë dua t' ju përcjell disa vrojtme të miat.

Së pari, duhet thënë se komunikimi midis babait dhe fëmijës, që të jetë i efektshëm, duhet të zhvillohet në një kornizë jo-fetare. Kur fëmijët marrin nga babai udhëzime të ngrira, formale dhe fetare, në fund ata do t' u kthejnë kurrizin si udhëzimeve, ashtu edhe besimit.

Një tjetër parim shumë i rëndësishëm i komunikimit është ky: prindi më shumë duhet të dijë të dëgjojë sesa të flasë. Njerëz që kanë të bëjnë me fëmijë rrugaçë e kriminelë, tregojnë se këta fëmijë, të gjithë pa përjashtim, ankohen për prindërit, pasi këta asnjëherë nuk ua vënë veshin për të dëgjuar hallet dhe problemet e tyre. Inkurajojini fëmijët të shprehin atë që kanë në zemër, të sqarojnë problemet e tyre. Mos krijoni atmosferë të tepruar fetare dhe mos i ngrini vetullat të habitur kur ata t' ju tregojnë ndonjë gjë të pakëndshme!

Dhe së fundi: Gjërat me të vërtetë të rëndësishme shpeshherë ua themi fëmijëve në një mënyrë të shpenguar dhe të çlirët në atë moment që nuk e pandehim: duke punuar në kopsht ose duke kositur barin ,duke parë televizor, duke zënë peshk apo duke pastruar garazhin dhe duke parë përse nuk ndizet makina. Pikërisht në situata të tilla mund t' i shpjegoni djalit apo vajzës parime themelore të fjalës së Perëndisë. Kjo nuk mund të kryhet vetëm para “altarit familjar”. Shumë gjëra varen nga mënyra se si e kaloni pjesën më të madhe të kohës. Situatat e jetës së përditshme janë raste të shkëlqyera për komunikim të mirëfilltë.

### **4. Të ruajmë Familjen Në Kohën e Fundit të Botës**

Kam predikuar shumë shpesh mbi vargun biblik: “Dhe, ashtu

siç në ditët e Noeut, ashtu do të jetë edhe në ditët e Birit të Njeriut” (Lu. 17:26). Këtu tërheq vëmendjen se ligësia e kohës së Noeut po përsëritet para syve tanë. Por një ditë prej ditësh kuptova mesazhin pozitiv të historisë së Nouet: “Me anë të besimit Noeu, i lajmëruar hyjnisht për ato që ende nuk shiheshin, druante Perëndinë dhe ndërtoi arkën për shpëtimin e shtëpisë së tij, me anë të të cilit e dënoi botën dhe u bë trashëgimtar i drejtësisë sipas besimit” (Heb. 11:7). Noeu, i drejti, dëgjoi nga Perëndia se po afrohej një katastrofë dhe mori masa për të shpëtuar familjen e tij.

Kohët në të cilat jetojmë, të kujtojnë gjithnjë e më tepër kohët e Noeut. Tipike për kohët e Noeut ishte se “...toka për shkak të njerëzve është plot me dhunë” (Zan. 6:13). Padyshim që kjo vlen edhe për tokën tonë! Krimet e dhunshme shtohen nga dita në ditë. Unë jam rritur në Britaninë e Madhe në kohën midis dy Luftërave Botërore dhe më kujtohet se atëherë një hajdut xhepush apo grabitës makinash dilte menjëherë në gazetë. Sot, krimet e dhunës janë kaq të shpeshta, saqë shtypi nuk ka kohë të merret me to. Ndoshta ju kujtohet se jo para shumë kohësh s’ishte nevoja e kontrollit nëpër aeroporte. Sot kontrolli është në rend të ditës!

Dua t’ju tregoj dy ndodhi, në të cilat sensibiliteti i babait i ruajti anëtarët e familjes nga vdekja e sigurtë.

Njëri nga nipërit i mi udhëtonte me gruan dhe tre fëmijët me makinën e familjes. Normalisht gruaja ulej përpara, pranë të shoqit, por atë ditë, për ndonjë arsye të veçantë, ajo u ul mbrapa te fëmijët. Kur mikrobusi kaloi poshtë një ure, dikush hodhi nga lart një copë betoni. Xhami i përparmë u bë copë e çikë dhe të gjitha ata që ishin në makinë u mbuluan nga gatarët. Por askush nuk pati as plagosjen më të vogël. Vetëm në këtë çast prindërit e kuptuan përse nëna nuk ishte ulur përpara: Nëse ajo do të ishte ulur aty, puna do të kishte përfunduar ndryshe.

Shembulli i dytë ka të bëjë me një shokun tim, të cilin këtu po e quajmë Malkolm. Ai, një natë, u paralajmërua se njërit prej anëtarëve të familjes i kanosej një rrezik. Të nesërmen, kur vajza e tij donte të merrte makinën e së ëmës për të shkuar në punë, ai i tha asaj: “Sot merr më mirë makinën time dhe jo atë të mamit.”

Rrugës vajza rrëshqiti mbi një gjurmë vaji. Ajo humbi kontrollin

## Ati si Profet

mbi makinën dhe bëri aksident, por nuk u plagos rëndë, pasi e ruajti Airbag-u (jastëk ajri). Po të kishte ngarë makinën e së ëmës, që ishte pa Airbag do të ishte aksidentuar ndoshta për vdekje.

Koha në të cilën jetojmë ka nevojë për etër me frymë profetike si Noeu – etër të cilët reagojnë me sensibilitet dhe mbrojnë familjet kur u kanoset një rrezik.



# 10

## Ati si Mbret

Le të rishikojmë tre funksionet e një babai. Si prift, ai përfaqëson familjen e vet para Perëndisë. Si profet, ai përfaqëson Perëndinë në familje. Më në fund, si mbret, ai qeveris familjen e vet në emër të Perëndisë.

Por ç' do të thotë për një baba të jetë mbret?

Te 1 Tim. 3:4-5 Pali trajton cilësitë e një burri që dëshiron të bëhet udhëheqës në kishë. Pali thotë se pyetja më e rëndësishme është: Në ç' gjendje ndodhet familja e këtij burri? Ky burrë duhet të jetë: "...njeri që e qeveris mirë shtëpinë e vet dhe i ka fëmijët të bindur me çdo lloj mirësjelljeje." Nga ai pritet që të ushtrojë autoritet, që fëmijët ta respektojnë dhe t'i binden e të jenë nën kontrollin e tij.

Fjala greke e përkthyer më sipër "qeveris", do të thotë saktësisht "qëndroj para" ose qëndroj në majë". Kjo fjalë ka disa përjasime (asociacione), ndër të tjera "mbretëroj", "mbroj" dhe "kontrolloj". Thelbi i kësaj fjale do të thotë se babai qëndron në krye të familjes. Ai qëndron midis familjes dhe gjithë presioneve dhe rreziqeve të jetës. Ai ecën në krye dhe jep shembull personal për një jetë të pëlqyeshme para Perëndisë.

Pali vazhdon të thotë se një udhëheqje e suksesshme në shtëpi është thelbësore për një udhëheqje të suksesshme në kishë. Ai pyet: "Por në qoftë se dikush nuk di ta qeverisë familjen e vet, si do të kujdeset për kishën e Perëndisë?" (vargu 5). Pra, nëse një burrë nuk arrin sukses

në udhëheqjen e shtëpisë së vet, ai nuk mund të pretendojë të ketë sukses si udhëheqës në shtëpinë e Perëndisë.

Një herë unë njoha Lewi Petrus nga Suedia. Gjatë Luftës së Dytë Botërore ai ishte pastor i kishës më të madhe pentakostale në Europë. Ky burrë i merrte shumë seriozisht kërkesat biblike ndaj një pastori. Një ditë ai doli para bashkësisë dhe shpalli dorëheqjen si pastor. “Bibla thotë se unë duhet të kem nën kontroll fëmijët e mi,” sqaroi ai, “por djemtë e mi nuk ecin me Zotin. Prandaj unë tërhiqem”. “Mos e bëj këtë!” – ia ktheu bashkësia. “Ne do të lutemi që djemtë e tu të shpëtohen.” Bashkësia u lut, djemtë u shpëtuan dhe pastor Petrusi nuk dha dorëheqje.

Mjerisht, shumë burra me funksion udhëheqës në bashkësi nuk i marrin seriozisht kërkesat e Biblës. Është krejt logjike që sukcesi si baba i familjes të jetë premisë për funksionin pastoral, sepse në fund të fundit, familja është bashkësi në miniaturë.

Bashkësia e Dhjatë së Re përbëhet nga këta elementë themelorë:

1. Pastori ose bariu (ose disa drejtues të quajtur “Pleq”)
2. Dhjakët ose ndihmësit
3. Bashkësia ose “tufa”

Këtyre u korrespondojnë elementet themelore të familjes:

1. Babai, i cili ka përgjegjësinë e një pastori apo bariu.
2. Bashkëshortja, e krijuar për të ndihmuar të shoqin, ashtu si dhjaku ndihmon pastorin.
3. Fëmijët, të cilët janë bashkësia ose “tufa”.

Pra, Perëndia ka shtrirë brenda familjes të gjitha strukturat themelore të një bashkësie të Dhjatës së Re. Në fakt, Perëndia i thotë babait të familjes: “Ki kujdes që bashkësia jote e vogël të ketë sukses – bashkësia që të kam besuar në shtëpinë tënde. Kështu kualifikohesh dhe ngrihesh në përgjegjësi edhe në shtëpinë e Perëndisë.”

## Duke Ecur Në Gjurmët e Abrahamit

Le të trajtojmë tani figurën e Abrahamit si shembull për një atë i cili mori përgjegjësi për të qeverisur familjen si mbret dhe e përmbushi këtë përgjegjësi.

A keni bërë ndonjëherë pyetjen se përse Perëndia zgjodhi pikërisht Abrahamin midis qindra mijëra burrave të tjerë të asaj kohe? Përse iu dha Abrahamit privilegji për tu bërë kreu i një populli, i cili do t'i sillte shpëtim gjithë njerëzimit?

Le të studiojmë pak domethënien e emrit "Abraham". Në fillim ai quhej "Abram", që do të thotë "Atë i lartë." Pastaj Perëndia bëri besëlidhjen e dytë dhe të përjetshme me këtë burrë dhe ia ndryshoi emrin në "Abraham", që do të thotë "Atë i një shumice". Të dyja format shprehin qartë se ai, para së gjithash, ishte atë. Kjo është diçka jashtëzakonisht domethënëse. Perëndia e zgjodhi Abrahamin si atë.

Tani të shohim diçka të rëndësishme që Perëndia tha në lidhje me Abrahamin:

"Dhe Zoti tha: 'A do t'ia fsheh unë Abrahamit atë që kam për të bërë, mbasi Abrahami duhet të bëhet një komb i madh e i fuqishëm dhe tek ai do të bekohen tërë kombet e tokës? Unë, në fakt, e kam zgjedhur, me qëllim që të urdhërojë bijtë e tij dhe shtëpinë e tij që të ndjekin pas tij rrugën e Zotit, duke zbatuar drejtësinë dhe barazinë, në mënyrë që Zoti të mund të plotësojë premtimet që i ka dhënë Abrahamit'."

(Zan. 18:17-19).

Fjala "urdhërojë", në vargun 19, është fjala hebraike standarde për "urdhëroj" ose "komandoj", e cila në këtë kuptim përdoret rregullisht edhe tek urdhërimet e Moisiut. Pa marrë parasysh përkthimet e ndryshme, një gjë del e qartë: Perëndia e zgjodhi Abrahamin sepse Ai kishte besim se ky (Abrahami) do t'i komandonte dhe urdhëronte mirë fëmijët dhe shtëpinë e vet.

Fjala "urdhëroj" ose "komandoj" është një fjalë e rreptë që të kujton ushtrinë. Disa bashkëshortë dhe nëna mund të thonë: "Ti thua që burri duhet të jetë diktator?" Jo. Mirëpo ka disa situata në të cilat burri ka përgjegjësinë të thotë: "Për t'i pëlqyer Perëndisë dhe për të

marrë bekimin e tij, do t'i bëjmë kështu e kështu gjërat në shtëpinë tonë. Ne nuk do të bëjmë kështu por ashtu."

Sipas mendimit tim, babai ka të drejtë të përcaktojë disa rregulla themelore familjare: kohën e ngrënies, kur duhet të vijnë në shtëpi fëmijët e parritur, cili lloj dëfrimi u lejohet fëmijëve, si është puna me televizorin, etj. Ky nuk është thjesht një privilegj i babait, por edhe një detyrë.

Natyrisht që të tilla vendime babai nuk duhet t'i marrë pa u konsultuar më parë me gruan e tij dhe pa qenë në një mendje me të. Por babai mban përgjegjësinë përfundimtare për rregullat në familje. Ai duhet të japë llogari para Perëndisë për familjen e vet.

Te Romakët 4:11-12 thuhet se Abrahami është atë për të gjithë ata që duan të ndjekin gjurmët e tij. Kjo do të thotë se unë nuk mund të pretendoj: "Unë jam i rilindur dhe prandaj Abrahami është ati im." Unë duhet të jetoj ashtu si Abrahami. Ky fakt nuk ka asgjëkundi tjetër aq rëndësi sa në familje.

## Rregulli Në Familjen Qiellore

Familja hyjnore në qiell është një shembull i përkryer për ushtrimin e autoritetit në familje. Si funksionon autoriteti në marrëdhëniet midis Perëndisë Atë dhe Perëndisë Bir?

Mënyra se si Jezusi shprehet mbi marrëdhëniet e Tij me Atin, lëkund nga themelet disa teori bashkëkohore mbi edukimin e fëmijëve.

"Prandaj Ati më do, sepse unë e jap jetën time që ta marr përsëri. Askush nuk e merr nga unë, por e jap nga vetja ime; unë kam pushtet ta lë dhe kam pushtet ta marr përsëri; këtë urdhërim e kam marrë nga Ati im."

(Gjoni 10:17-18)

Kjo bën të qartë se Perëndia Atë jepte urdhëra dhe Jezusi, Biri, i zbatonte ato. Edhe te Gjoni 12:49-50 Jezusi thotë:

"Sepse unë nuk fola prej vetes sime, por Ati që më dërgoi, ai më



## Ati si mbret

ka urdhëruar ç' duhet të them e të shpall. Dhe e di se urdhërimi i tij është jetë e përjetshme; gjërat, pra, që them unë, i them ashtu siç mi ka thënë Ati."

Pra, gjatë gjithë kohës që mësonte mbi tokë, Jezusi i bindej urdhrave që merrte nga Ati i Tij, Perëndia.

Dhe kur Jezusi bo bëhej gati të largohej nga Dhoma e Sipërme, për t' u përballuar me ngjarjet që çuan në arrestimin dhe ekzekutimin e tij, Ai tha:

"...por kjo ndodh që bota të njohë se unë e dua Atin dhe se bëj ashtu siç Ati më ka urdhëruar. Ngrihuni, ikim prej këndeje!"

(Gjoni 14:31)

Kështu, Jezusi shkoi në kryq duke iu bindur urdhrat të Atit të Tij. Kjo ishte prova përfundimtare e bindjes!

Hartuesi i Letrës drejtuar Hebrenjve e përmbledh këtë në një fjali të vetme: "Edhe pse ishte Bir, mësoi në ato që vuajti, bindjen." (Hebr. 5:8)

Ja ku e kemi shembullin e dy personave hyjnore – Atin dhe Birin. Ati jepte urdhrat dhe Biri mësonte të bindej gjatë zbatimit të urdhrave. Kjo bindje Atij i kushtoi jetën. Nuk kemi për të gjetur kurrë në Bibël shembuj parregullsie, mosbindjeje apo pakujdesie. Perëndia është tepër i saktë. Ai na thotë hollësisht se ç' duhet të bëjmë dhe pret që ne të veprojmë.

Ky model duhet të riprodhohet edhe në familjen njerëzore. Ne këtu mbi tokë nuk kemi të drejtën të ndryshojmë, "të përmirësojmë", modelin e dhënë nga Qielli.

## Disiplina Në Shtëpi

Lexuam te Hebrenjve 5:8 se Jezusi mësoi të bindej. Kjo tregon se bindja është diçka që duhet mësuar. Mësimin e bindjes ne zakonisht e quajmë "disiplinë" ose "edukim". Dhe, nëse Jezusi kishte nevojë ti nënshtrohej disiplinës, aq më tepër duhet t' i nënshtrohemi asaj ne dhe fëmijët tanë të dashur, por me aq shumë të meta!

Nëse doni të keni sukses në rritjen e fëmijëve, duhet të kombinoni dashurinë me disiplinën. Por duke i përkëdhelur – duke u plotësuar çdo dëshirë, çdo tekë dhe duke iu nënshtruar kërkesave të tyre, ju prodhoni fëmijë tekanjozë dhe të pakënaqur. Fëmijët e përkëdhelur në këtë mënyrë, kur të rriten do të kenë pretendimin që jeta t’i trajtojë ashtu siç i trajtonin prindërit e tyre. Mirëpo jeta nuk ta bën të gjatë; ajo është e ashpër dhe bëhet gjithnjë e më e ashpër. Kam hasur herë pas here njerëz, të cilët prindërit i kishin rritur me një zemërgjerësi jobiblike dhe më duhet të pohoj se ata, kush më pak e kush më shumë, bënë jetë të vështirë.

Përkëdhelja e fëmijës nuk është shprehje dashurie. Përkundrazi, shumë shpesh ajo është shprehje dembelizmi. Është më e vështirë të edukosh një fëmijë, sesa ta përkëdhelësh atë.

Fëmijët më fatkeqë janë ata që nuk janë edukuar me disiplinë. Ata janë edhe më të pasigurtët – sepse femija ka nevojë për kufij që ta ndiejë veten të sigurtë.

Më kujtohet se kur vajza ime afrikane, Xhesika, ishte 16 vjeç, ajo kalonte ato probleme që i kalojnë të gjithë adoleshentët. Megjithëse ishte kristiane e singertë, në një moment të caktuar deshi të bënte diçka që nuk ishte as e drejtë e as e mençur.

“A mund ta bëj këtë?” më pyeti. “A më lejon?”

“Jo, nuk të lejoj,” iu përgjigja, “sepse nuk është mirë për ty.”

Kujtova se Xhesika do të zemërohej. Por unë pashë në sytë e saj se ky kufi i solli lehtësim. Ajo nuk kishte forcë të brendshme për t’i vënë vetes një cak të tillë, por ma diti për nder që atë ia vura unë.

Nuk është gjë e mirë t’i nxjerrësh fëmijët në botën e madhe pa iu vënë kufij – sidomos në kohët tona. Këta kufij duhet të jenë të thjeshtë e të kuptueshem dhe zakonisht u duhen shpjeguar fëmijve:

“Përse nuk mund të shohim këtë apo atë program në televizor?”

“Sepse ju mëson gjëra jo të mira dhe ju inkurajon të bëni gjëra që ju dëmtojnë.”

Nga ana tjetër, ka disa situata, në të cilat përgjigjja ndaj “Pse-së” është thjeshtë: “Sepse ashtu thotë babi [ose mami].” Arsyetimi i disa rregullave është shumë i komplikuar për mendjet e fëmijve të vegjël. Në fund të fundit, edhe Ati Perëndi nuk bën sqarime për disa rregulla që na jep. P. sh. unë nuk besoj se izraelitët i kuptonin të gjitha rregullat

## Ati si mbret

e dhëna te Numrat, kap. 11, mbi kafshët e pastra apo të papastra. Por Ai kërkonte prej tyre që ata t'i respektonin!

Kur fëmijët tanë ishin duke u rritur, Lydia dhe unë u dhamë për të mësuar përmendësh një varg nga 1 Samuelit 15:22, i cili thotë: “Ja, bindja është më e mirë se flijimi dhe të dëgjosh me kujdes është më mirë se dhjami i deshve.” Disa vite më vonë, për gëzimin tonë, konstatuam se ata ua mësonin këtë varg fëmijëve të tyre!

Në kapitullin e ardhshëm do të vazhdojmë studimin mbi atësinë duke krahasuar dy etër të përshtuar te libri i Zanafillës.



# 11

## Portreti i Dy Etërve

Në jetën e Abrahamit, nipi i tij, Loti, luante një rol shumë të rëndësishëm. Këta dy burra kishin kaluar shumë peripeci së bashku. Pa dyshim që Loti kish vërejtur ndikimin e Perëndisë në jetën e Abrahamit dhe kishte ndërtuar marrëdhënie personale me Zotin. E megjithatë erdhi koha kur dy burrat duhet të ndaheshin sepse “Dhe vendi nuk ishte në gjendje t’i mbante po të banonin bashkë, sepse pasuritë e tyre ishin aq të mëdha, sa nuk mund të qëndronin bashkë” (Zan. 13:6).

Abrahami e la Lotin të zgjedhë se nga donte të shkonte. Kjo ndarje zbuloi një ndryshim thelbësor midis dy burrave – vizionet e tyre të ndryshme.

Vizioni i Abrahamit kapërcente gjërat e kufizuara në kohë, duke dalë nga kjo botë dhe duke hyrë në të ardhmen e përjetësisë: “...sepse priste qytetin, që ka themelet, mjeshtër dhe ndërtues i të cilit është Perëndia” (Heb. 11:10).

Abrahami i merrte vendimet mbi tokë me një vështrim të ngulitur te qëllimi i përjetshëm. Ndërsa vështrimi i Lotit nuk dilte përtej ambientit rrethues:

“Atëherë Loti ngriti sytë dhe pa tërë fushën e Jordanit. Para se Zoti të kishte shkatërruar Sodomën dhe Gomorrën, ajo ishte e tëra e ujitur deri në Tsoar, si kopshti i Zotit, si vendi i Egjiptit. Kështu Loti zgjodhi

për vete tërë fushën e Jordanit dhe filloi t'i zhvendosë drejt lindjes çadrat e veta: Kështu u ndanë njëri nga tjetri. Abrahami banoi në vendin e Kanaanit dhe Loti në qytetet e fushës, duke arritur të ngrejë çadrat e tij deri në Sodomë.”

(Zan. 13:10-12)

Në vargun tjetër autori i këtij teksti shton në thonjëza: “Por njerëzit e Sodomës ishin shumë të poshtër dhe mëkatarë ndaj Zotit.”

Vizioni i Lotit përcaktoi rrugën që edhe ndoqi. Ai ndiente një tërheqje të papërbalueshme për te mirëqenia dhe pjelloria e Sodomës dhe ishte verbuar përsa i përket sjelljes ekstreme mëkatarë dhe perversionit të banorëve të këtij qyteti.

Disa vite më vonë Perëndia dërgoi dy engjëj në Sodomë për të shpallur gjyqin e afërm. Ndërkohë Loti jo vetëm që i kish vënë syrin këtij qyteti, por ai ishte shtruar aty këmbëkryq, po, madje rrinte ulur te porta e qytetit (krahaso Zan. 19:1).

Nga kjo del se Loti ushtronte autoritet brenda shoqërisë së qytetit. Megjithëse ai nuk i zbatonte praktikat mëkatarë të banorëve, prapëseprapë ai ishte bërë një me ta.

Engjëjt e paralajmëruan Lotin që të mblidhte urgjentisht anëtarët e familjes së vet.” ...dhëndurët e tu, bijtë dhe bijat e tua, dhe cilindo që ke në qytet” (Zan. 19:12) – për të ikur që andej para se të shkatërrohej qyteti.

“Atëherë Loti doli dhe u foli dhëndurëve të tij që ishin martuar me bijat e tij, dhe tha: ‘Çohuni, largohuni nga ky vend, sepse Zoti do ta shkatërrojë qytetin’. Por dhëndurët e tij patën përshtypjen se ai po bënte shaka.” (v. 14)

Ideja se Perëndia do të bënte gjyq iu duk dhëndurëve shumë qesharake, kështu që Loti mundi të marrë me vete vetëm të shoqen dhe dy vajzat e pamartuara. Por, në të dalë të qytetit, gruaja u kthye edhe një herë për të parë e mallëngjyer atë që po braktiste dhe në atë çast u shndërrua në një shtyllë kripe.

Përfytyroj Lotin, i cili më vonë, duke u gjendur në siguri te malet ku ish strehuar, hidhte vështrimin mbi gërmadhat e tymosura të qytetit të dikurshëm dhe mbi shtyllën e kripës që kish qenë gruaja e tij: “Hyra në këtë qytet me gjithë familjen time”, i thoshte ndoshta

vetes, “por dola vetëm me dy vajza.” (Këtu duhet thënë se edhe ato të dyja u implikuan në një marrëdhënie incesti me babanë e tyre.)

A e pushtoi Lotin ndjenja e fajit, kur dalloj se kish dështuar në mbajtjen e pëgjegjesisë ndaj familjes së vet? Bibla nuk na e jep përgjigjen e kësaj pyetjeje. Por, nëse jeni baba, ju lutem ta vini veten për pak kohë në vendin e Lotit. A ka mundësi t’ju vijë ky mendim: “Ah, sikur të kisha marrë një tjetër vendim! Sikur të kisha ndenjtur pranë Abrahamit!”

Tani bëjini vetes disa pyetje të rëndësishme:

Çfarë shembulli jam unë për familjen time? A demonstroj para saj një qëllim dhe një standard të përjetshëm të cilin ajo të orientohet? Apo e reduktoj standardin dhe angazhimin tim vetëm deri te mirëqenia materiale dhe te sukcesi në këtë botë?

Si Abrahami, ashtu dhe Loti kishin një vizion. Vizioni i Abrahamit përqendrohej te qyteti i mrekullueshëm e i përjetshëm, të cilin Perëndia e ka përgatitur për shërbëtorët e vet që e ndjekin me gjithë zemër. Vizioni i Lotit ishte fiksuar te mirëqenia materiale e një qyteti tokësor dhe e verboi për sjelljen mëkatore të banoreve. Te të dy burrat, vizioni përcaktoi jo vetëm rrugën e jetës së tyre, por edhe fatin e dy familjeve.

Edhe pse kanë kaluar shumë shekuj, ky parim qëndron ende në fuqi: Ati i përcjell familjes vizionin që dominon në jetën e tij. Prandaj çdo atë duhet të bëjë këtë pyetje:

Çfarë vizioni i përcjell unë anëtarëve të familjes? A i brumos me vlerat e përjetshme, të cilat u japin nxitje për ta vënë jetën e tyre në shërbim të Krishtit? Apo i kushtoj më tepër rëndësi suksesit para botës — karrierë, rehati materiale, pavarësi financiare dhe status shoqëror?

Njëherë isha i pranishëm në mbajtjen e fjalimit të presidentit të një kolegji të njohur ungjillor. Shumica e prindërve të nxënësve të këtij kolegji janë kristianë. Por presidenti tha këto fjalë:

“Herët a vonë unë i bëj këtë pyetje thelbësore studentëve: ‘Kur prindërit të dërguan në këtë kolegji, a të thanë se cila është gjëja më e rëndësishme në të ardhmen tënde? Që të bëhesh shërbëtor besnik i Jezu Krishtit?’”

Presidenti vazhdoi: “Deri më sot asnjë prej studentëve nuk ka thënë “Po”. Nëse djali apo vajza juaj do të shkonin në këtë kolegji, si do të përgjigjeshin ata?”





## 12

# Kur Etërit Dështojnë

Në kapitujt e mëparshëm përshkrova tre sfera përgjegjësie të dhëna nga Perëndia, të cilat duhet t'i përmbushë një baba kundrejt familjes së tij: Si prift, të lutet për të, si profet të përfaqësojë Perëndinë para familjes dhe si mbret, të qeverisë familjen sipas masës së Perëndishme të drejtësisë.

Në kapitullin e mëparshëm pamë se Loti nuk i përmbushi detyrimet si baba dhe si pasojë solli fatkeqësi mbi gjithë familjen e vet. Në kontrast me këtë, vërtetuam se Perëndia e zgjodhi Abrahamin, sepse Ai ishte i sigurt se ky i fundit do t'i përmbushte detyrimet e veta si atë; mbi këtë bazë Perëndia premtoi se Abrahami do të bëhej kreu i një populli të fuqishëm.

Këtu lind një pyetje e rëndësishme: Nëse atësia besnike është kusht për një komb me mirëqenie e të bekuar, ç'ndodh atëherë me një komb, etërit e të cilit dështojnë në sferën më të rëndësishme? Te LiP. 28, Moisiu nuk ngurron aspak të thotë se ç'na pret në një rast të tillë.

Ky kapitull te Ligji i Përtërirë është i ndarë në dy pjesë. Në 14 vargjet e para, Moisiu radhit të gjitha bekimet që do të marrë populli, nëse bindet. Në 54 vargjet që pasojnë, Moisiu numëron mallkimet në rastin e mosbindjes.

Një varg te pjesa e dytë përshkruan njërin nga mallkimet që vijnë mbi një komb, etërit e të cilit përçmojnë detyrimet ndaj familjeve:

“Do të të lindin [do të ngjizësh] bij dhe bija, por nuk do të jenë të tutë, sepse do të shkojnë në skllavëri.”

(LiP. 28:41)

Fjalët e përdorura në hebraisht nxjerrin në pah se Moisiu u flet burrave, pasi fjala “ngjiz” ka të bëjë para së gjithash me funksionin e atit. Pra, ky varg u drejtohet pikë së pari etërve (por jo vetëm atyre).

Një ditë prej ditësh konstatova i tronditur se është mallkim kur nuk të kënaqet zemra me fëmijët e tu. Pyeta veten: “Sa prindër janë të kënaqur me fëmijët e tyre?” Përgjigja ishte: “Jo shumë! E për ç’arsye? Sipas mendimit tim, ky mallkim ka të bëjë me mosbindjen. Perëndia i krijoi fëmijët si bekimin më të madh që mund t’u jepte burrave dhe grave. Nëse baballarët dhe nënat, por kryesisht baballarët, nuk ecin në rrugën e Zotit, bijtë dhe bijat nuk bëhen bekim, por mallkim.

Një variant përkthimi i Biblës (Elberfelder) e jep këtë varg fjalë për fjalë: “Bij dhe bija do të ngjizësh; por nuk do të të përkasin ty...”

Edhe kjo fjalë po përmbushet në kohët tona. Në një numër të pafund familjesh të shkatërruara, fëmijët nuk u përkasin më prindërve. Fëmijët dhe prindërit janë bërë të huaj për njëri-tjetrin. Edhe kjo është pasojë e mallkimit.

Moisiu thotë në këtë varg se fëmijët do të shkojnë “në robëri”. Qysh nga 1960 ne përjetojmë në botën perëndimore se si miliona fëmijë përfundojnë në lloje të ndryshme të robërisë sataniste: drogë, seks i ndaluar, okultizëm dhe sekte. Kush bie viktimë e këtyre gjërave, shkon në robëri njësoj sikur të ishte kapur nga një ushtri armike.

Pse kanë shkuar këta miliona fëmijë në robëri? Ligji i Përtërirë na jep përgjigjen: refuzim i vazhdueshëm i kërkesave të drejta të Perëndisë, para së gjithash në lidhje me familjen dhe edukimin.

Kam përmendur te kapitulli i nëntë se foljet dhe përemrat hebraike mund të marrin forma mashkullore ose femërore. Te Ligji i Përtërirë të gjitha foljet janë të formës mashkullore. Me fjalë të tjera: Perëndia bën përgjegjës burrat në radhë të parë. Kjo nuk do të thotë se gratë nuk kanë asnjë përgjegjësi; padyshim që po. Por dështimi i udhëheqjes mashkullore i hap së keqes dyer e dritare.

Modeli negativ i kopshtit të Edenit përsëritet kushedi se sa herë në epokat e mëvonshme të historisë njerëzore. Adami la pas dore sferën

## Kur etërit dështojnë

e tij të përgjegjësishë, mbikëqyrjen e kopshtit dhe Satani gjeti rast për të tunduar e joshur Evën. Për analogji, indiferenca e burrave i hap rrugën marshimit të së keqes që ka pllakosur sot qytetërimin perëndimor.

Te Malakia 2:7, profeti udhëzon se ati si prift në familje duhet të marrë përsipër një përgjegjësi tepër të rëndësishme:

“Sepse buzët e priftit duhet të ruajnë diturinë dhe nga goja e tij secili duhet të kërkojë ligjin, sepse ai është lajmëtari i Zotit të ushtrive.”

Prifti ka përgjegjësinë të njohë ligjin e Zotit dhe t’ia interpretojë atë popullit të Perëndisë. Kjo vlen edhe për babain si prift. Fëmijët dhe familja duhet të kërkojnë fjalën e Zotit nga goja e tij.

Çfarë ndodh nëse priftërinjtë dështojnë në këtë funksion? Perëndia sqaron:

“Populli im vdes për mungesë njohurish. Duke qenë se ti ke refuzuar njohjen, edhe unë do të të refuzoj si priftin tim; duke qenë se ti ke harruar ligjin e Perëndisë tënd, edhe unë do të harroj bijtë e tu.”

(Os. 4:6)

Çfarë fjale e fortë! Perëndia u thotë izraelitëve: “Unë prita që ju të bëheni priftërinj, por ju e hodhët poshtë dijen që ju nevojitej.” Ata nuk hodhën poshtë dijet e kësaj bote, por dijet mbi rrugët dhe fjalët e Zotit. Për pasojë, Perëndia nuk i njeh më si priftërinj, por madje bën be se do t’i harrojë edhe fëmijët e tyre.

Si prift i familjes, çdo baba ka privilegjin të bëjë atë që bëri Jobi – t’i sjellë vazhdimisht fëmijët në lutje para Perëndisë. Kështu ata mbeten përherë nën kujdesin dhe mbrojtjen e të Plotfuqishmit. Por kur një baba e lë pas dore lutjen e ndërmjetësimin, Perëndia thotë: “Unë do të harroj fëmijët e tu.” Përkthimi anglisht, New International Version (Versioni i Ri Ndërkombëtar) e jep kështu këtë fragment: “Edhe fëmijët e tu unë do t’i injoroj (nuk do t’i përfill).” Kjo do të thotë: “Fëmijët e tu nuk do të qëndrojnë më nën tutelën time të veçantë dhe kujdesin tim.”

Ky paralajmërim solemn i Perëndisë më rri para syve, sidomos në këto kohë. Nganjëherë, kur shikoj masën e të rinjve nëpër rrugët e

qytetit, pyes veten: “Sa prej tyre ka harruar dhe shpërfillur Perëndia, ngaqë baballarët nuk kanë bërë lutje ndërmjetësimi?”

Kjo situatë e tmerrshme kërkon një ushtri të tërë lutësish të angazhuar që të luten për familje të tilla. Megjithatë, lutja ndërmjetësuese e një babai për familjen e tij është diçka e papërsëritshme. Askush tjetër nuk mund ta zërë këtë vend. Ky privilegj i veçantë lidhet me një përgjegjësi të veçantë.

## Diagnoza e Malakias

Nga ana kronologjike, Malakia është libri i fundit i Dhjatës së Vjetër. Në disa versione biblike, fjala e fundit e këtij libri të fundit është “mallkim”. Nëse Perëndia nuk do t’i kishte folur më njerëzimit pas Dhjatës së Vjetër, fjala e Tij e fundit do të kishte qenë “mallkim”. Faleminderit Zotit për Dhjatën e Re, e cila na çliron nga ky mallkim!

Le të lexojmë se ç’thotë Perëndia në këto dy vargje të fundit të Dhjatës së Vjetër:

“Ja, unë do t’ju dërgoj Elian, profetin, para se të vijë dita e madhe dhe e llahtarshme e Zotit. Ai do të bëjë që zemra e etërve t’u kthehet bijve dhe zemra e bijve etërve, me qëllim që vendi të mos goditet nga një shfarosje [mallkim] e plotë.”

(Mal. 4:5-6)

Para më shumë se dy mijë vjetësh, Perëndia i zbuloi Malakias në një vizion profetik problemin më të rëndë dhe me urgjent të kohës sonë: Etër indiferentë dhe fëmijë pa prindër.

Shkencat ekonomike dhe shoqërore na parashetrojnë gjithfarë diagnozash dhe zgjidhjesh të kësaj dileme. Mirëpo rrënja e problemit duhet kërkuar te familja. Prindërit i bëjnë bisht përgjegjësisë që kanë për fëmijët e tyre. Shpeshherë fajtorë janë që të dy prindërit, por përgjegjësia primare bie mbi babanë.

Nuk duhet injoruar fakti se lëvizja feministe në një farë mënyre u bë një bumerang i vërtetë. Jo vetëm që i është afuar mjaft qëllimit të saj – rrogë të njëjtë për punë të njëjtë midis burrit dhe gruas – por edhe i ka çliruar gratë nga detyrimi për të respektuar burrat. Nga ana e vet

edhe burri u çlirua nga detyrimi për të pasur vetëm një grua. Nëse bashkëshortja i vjen në majë të hundës, ai e braktis pa e bërë shumë të gjatë. Pastaj ai nuk ka më asnjë lloj detyrimi dhe ia vesh gruas të tërë barrën e edukimit të një apo më shumë fëmijëve. Prandaj gruaja, në shumicën e rasteve bie thjesht nga shiu në breshër.

Unë kam një barrë të madhe në zemër për nënat pa burra. Mua më duket se në shumë raste Trupi i Krishtit në kohët tona nuk bën atë që duhet për të ndihmuar këto gra pa burra dhe fëmijët e tyre.

Te Jakobi 1:27, Bibla përcakton se ç'është shërbesa e vërtetë para syve të Perëndisë:

“Feja e pastër dhe e patëmetë përpara Perëndisë, Atit është kjo: të vizitosh jetimët dhe të vejat në shtrëngimet e tyre dhe ta ruash veten të panjollë nga bota.”

Nganjëherë pyes veten se ç' do të ndodhte, nëse çdo familie kristiane që e merr Biblën seriozisht, do të merrte përsipër një nga këta fëmijë, të cilët në të vërtetë janë jetimë, pavarësisht se nuk cilësohen si të tillë. Këtu përfshihen edhe gjithë ata fëmijë që rriten pa kujdes e përkushtim prindëror. Natyrisht, për këtë duhet të sakrifikojmë deri në njëfarë mase rehatinë dhe qetësinë personale. Ndoshta duhet bërë edhe sakrificë financiare. Por nëse kjo do të bëhej në frymën e dashurisë kristiane, do të zbuste një copëz të asaj vuajtjeje që është kaq e pamatë, saqë shumica prej nesh mbyllin sytë për të mos e parë .

Mjerisht, kjo vuajtje nuk pakësohet dhe nuk zhduket nëse ne mundohemi të shmangim ballafaqimin me të. Pothajse kundra vullnetit tim, më vijnë ndër mend fjalët e Jezusit te Mateu 25:45, ku Ai u drejtohet kombeve, të cilët këtu përcaktohen si “cjepë”. “Në të vërtetë ju them: për aq sa nuk ia keni bërë këtë ndonjërit prej këtyre më të vegjëlve, nuk ma keni bërë as mua...”. Ne kristianët në botën perëndimore nuk do të gjykohejmë dhe aq për atë që kemi bërë por më shumë për atë që s' kemi bërë.

Mesazhi i Malakias u drejtohej njerëzve, të cilët zbatonin me shumë zell praktikatat fetare, por që ankoheshin se Zoti nuk i dëgjonte lutjet e tyre ashtu siç donin ata. Si përgjigje, Zoti u tregoi se ata kishin dështuar si bashkëshortë dhe etër:

“Ju po bëni edhe këtë tjetrën: e mbuloni altarin e Zotit me lot, me të qara dhe vajtime, sepse nuk e shikon më me favor ofertën tuaj dhe nuk e pranon më me kënaqësi nga duart tuaja. Megjithatë ju thoni :‘Përse?’ Sepse Zoti është dëshmitar midis teje dhe bashkëshortes së rinisë sate, ndaj së cilës je sjellë me pabesi, ndonëse ajo është shoqja jote dhe bashkëshorte e besëlidhjes sate.”

(Mal. 2:13-14)

Perëndia depërtoi tej fasadës religjioze dhe pa premtime të shkelura martesore dhe bashkëshortë që turpëronin gratë e tyre. Po t’i mbartim fjalët e Malakias në gjuhën e sotme, mund të shpreheshim kështu: “Ajo që ti bën në bashkësi nuk kompenson dot atë që nuk e bën në shtëpi.”

Më pas Perëndia përmend një nga arsyet se përse Ai ka caktuar që martesat të jenë monogame:

“Por a nuk i bëri Perëndia një qenie të vetme dhe megjithatë fryma qëndroi në të ? Po pse vallë një qenie të vetme? Sepse ai kërkonte një pasardhje [të pëlqyeshme] nga Perëndia” (Mal. 2:15).

Nëse bashkëshorti dhe bashkëshortja jetojnë në harmoni sipas parimeve të Shkrimit, ata janë kualifikuar për të rritur dhe edukuar fëmijët me drejtësinë dhe frikën e Perëndisë. Dhe nëse martesat shkatërrohet, janë fëmijët ata që vuajnë më tepër.

Pastaj vjen një paralajmërim i Perëndisë ndaj gjithë bashkëshortëve: “Tregoni, pra, kujdes për frymën tuaj dhe askush të mos silllet me pabesi me bashkëshorten e rinisë së vet” (Mal. 2:15). Dhe së fundi një pohim pa kompromis i Zotit mbi divorcin: “Sepse Zoti, Perëndia i Izraelit, thotë se ai e urren divorcin”(v. 16).

## Si Do Të Reagoni Ju?

Në Britaninë e Madhe, në çdo zyrë të gjendjes civile çdo njeri mund të lexojë këtë formulim të martesës: “Sipas ligjit të këtij vendi martesat është besëlidhje për gjithë jetën e burrit me një grua duke përjashtuar të gjitha të tjerat (gratë)”. Në atë periudhë kohore kur popullsia britanike po largohej gjithnjë e më shumë nga ky standard, vendi përjetoi një degradim të vazhdueshëm në pothuaj çdo fushë

të jetës publike. Sot, pothuajse në të gjitha shkrimet përdoret vetëm fjala “Britani” dhe gati-gati është eliminuar fjala “e Madhe”!

Fjala e Perëndisë konfronton me dy alternativa jo vetëm Britaninë e Madhe por edhe tërë botën perëndimore: Ne, ose ripërtërijmë marrëdhëniet familjare dhe mbijetojmë, ose lejojmë që marrëdhëniet familjare të keqësohen vazhdimisht dhe të arrijnë deri aty ku kanë arritur gjatë dekadave të fundit. Nëse do të ndodhë kjo e dyta, do të shkatërronemi nën mallkimin e Perëndisë.

Varet nga reagimi i etërve se si do të përfundojë kjo krizë. Ata janë të parët që mbajnë përgjegjësi para Perëndisë. Te mesazhi që Malakia u përcollti njerëzve, ai kërkon që së pari zemrat e etërve t’u kthehen fëmijve. Vetëm pas kësaj, zemrat e fëmijve do t’u kthehen etërve.

Ne që i përkasim brezit të vjetër, mund të ankojemi për “Brezin x” apo “Brezin e ardhshëm”, siç e quajmë zakonisht. Mund të tregojmë me gisht gabimet dhe dështimet e tyre. Por kriza nuk filloi në kohën e tyre. Fajin e kanë brezat e mëparshëm. Qenë brezat tanë ata që i tradhtuan, nuk u thanë të vërtetën dhe që dështuan e nuk u mësuan disiplinën e Perëndishme. Tani Perëndia po na gjykon me anë të fëmijëve tanë.

Disa zëra kërkojnë me forcë që Trupi i Krishtit të angazhohet më shumë në problemet sociale. Në sferën shoqërore, trupi i Krishtit ka rastin e madh që të angazhohet në çështjen e familjes. Ky do të ishte një reagim ndaj krizës më urgjente të kohës sonë.

Bashkësia e kohës sonë duhet të përcjellë një mesazh të kthjellët, i cili e paraqet familjen kristiane ashtu siç e deshi Perëndia – një mesazh që përcakton rolin e bashkëshortëve, bashkëshorteve dhe fëmijëve. Por ky mesazh duhet t’u përmbahet besnikërisht parimeve të mëdha dhe të pandryshueshme të cilat janë përcaktuar qysh nga Zanafilla. Nuk duhet bërë asnjë kompromis me forcat humaniste që po infiltrojnë bashkësinë që prej dy ose tre brezash.

Te predikimi në mal, Jezusi u bën të qartë dishepujve se nëse këta zotohen ta ndjekin, ata do të tërheqin vëmendjen e të gjithë njerëzve: “Ju jeni drita e botës; një qytet i ngritur sipër mbi mal nuk mund të fshihet” (Mt. 5:14). Ai vijon: “Ashtu le të shndritë drita juaj para njerëzve, që të shohin veprat tuaja të mira dhe ta lëvdojnë Atin tuaj që është në qiej” (v. 16).

Jezusi u tha dishepujve se priste nga ata që të ishin burim drite në një botë të errët; përveç kësaj, u tha me saktësi se si duhet të rrezatonte kjo dritë: me anë të veprave të tyre të mira, të dukshme për cilindo.

Në kapitujt e mëparshëm pamë se familja kristiane, duke ndjekur vullnetin e Perëndisë duhet të jetë një burim drite në dy drejtime: Së pari, bashkëshortët dhe bashkëshortet duhet të paraqesin lidhjen midis Krishtit dhe bashkësisë nëpërmjet bashkëjetesës së tyre. Së dyti, etërit duhet të ndërtojnë familje që paraqesin dashurinë atërore të Perëndisë ndaj popullit të tij besimtar. Bibla na zbulon se kujdesi për jetimët dhe të vejat është një nga ato vepra të mira, të cilat Perëndia dëshiron t'i shohë në radhë të parë te populli i tij. Këtë kërkesë e gjejmë në shumë pasazhe të Dhjatës së Vjetër dhe të përforcuar edhe në Dhjatën e Re.

## Fjala që përmbledh gjithçka

Kërkesat e Perëndisë përmbledhen në një fjalë të vetme me një domethënie pafundësisht të thellë dhe të gjerë: Dashuri. Kjo dashuri shfaqet në tre dimensione qendrore:

1. Dashuria e thellë midis bashkëshortit dhe gruas së tij.
2. Dashuria mbrojtëse e prindërve për fëmijët.
3. Dashuria plot përkujdes e besimtarëve ndaj atyre që nuk i do njeri – jetimëve dhe të vejave.

Nëse trupi i Krishtit në botën perëndimore është një “qytet i ngritur sipër mbi mal” i cili “nuk mund të fshihet”, duhet shtruar pyetja: Me ç’sy e sheh bota jokristiane bashkësinë e Jezusit? Më konkretisht: A e sheh bota se Trupi i Krishtit i del zot përgjegjësisë së vet dhe tregon dashurinë e Perëndishme midis Krishtit dhe bashkësisë së tij si edhe dashurinë atërore të Perëndisë për familjen e Tij? Duhet të bëjmë edhe pyetjen: A është Bashkësia në sytë e botës një shembull i kujdesit ndaj jetimeve dhe të vejave? Këto pyetje kanë nevojë për përgjigje. Ne nuk mund të rruhim supet dhe t'i shpërfillim. Ka të ngjarë që secili duhet të përgjigjet për veten e tij.



Përgjigja ime mbështetet mbi përvoja të shumta, të mbledhura gjatë viteve, nga udhëtimet në kombe të ndryshme. Unë kam si qytetarinë angleze, ashtu dhe atë amerikane. Kam shërbyer në mbi pesëdhjetë kombe, ndër të tjera në të gjitha vendet europiane, përveç Finlandës dhe Bullgarisë, si edhe në të gjitha kombet e mëdha anglishtfolëse. Mendimi im personal, i pazbukuruar, është se Trupi i sotëm i Krishtit po bën një faj. Faleminderit Perëndisë, kemi edhe disa përjashtime të mrekullueshme, por në përgjithësi bashkësia nuk tregon dashurinë e Jezusit – as në strukturat themelore familjare e as në përkujdesjen për të vejat dhe jetimet.

Organizata të ndryshme kristiane mundohen t'i kundërpërgjigjen dështimit të udhëheqjes mashkullore dhe shkatërrimit të familjes që vjen si pasojë e këtij dështimi – organizata të tilla si “Fokusin te Familja” nën udhëheqjen e Dr. Xhejms Dobson, apo kohët e fundit “Promise Keepers (Mbajtësit e Premtimit)”. Duhet të pyesim veten se përse lindin gjithnjë e më tepër organizata të tilla, të shkëputura nga bashkësitë, në gjysmën e dytë të shek. 20-të? Arsyeja më e pranueshme është se ato mundohen të mbajnë atë barrë që Jezusi faktikisht ia ka ngarkuar bashkësisë.

Ndoshta ne i admirojmë dhe i mbështesim këto grupime jashtë bashkësive; mirëpo unë nuk besoj se kjo zhvendosje e përgjegjësisë është e pranueshme nga Jezusi si Kreu i Bashkësisë. Ai ende vazhdon të kërkojë nga Bashkësia që ajo të dallojë dhe të pranojë përgjegjësinë për këto fusha të jetës dhe pret prej saj që t'i vërë ato në jetë. Duke pasur parasysh gjendjen e tanishme, brenda bashkësisë duhet të ndodhë një revolucion rrënjësor që t'i mundësojë asaj arritjen e qëllimit. Sipas mendimit tim, nëse ajo dështon, Jezusi do ta lërë mënjanë Bashkësinë e tanishme dhe në vend të saj do të rizgjojë një Bashkësi të denjë për të qenë Nusja e Tij.

Sot fliten shumë fjalë dhe bëhen shumë lutje mbi temën “rizgjim”. Rizgjimi i vërtetë dallohet ndër të tjera edhe aty se Bashkësia si tërësi sheh dhe pranon përgjegjësinë për të kryer pikërisht ato detyra të cilat tani për tani u delegohen këtyre organizatave që funksionojnë jashtë bashkësive.

Një gjë është e sigurtë: Jezusi nuk do të kthehet te një “grupim jashtë bashkësisë”. Ai do të vijë te një nuse që “është bërë gati” dhe

që është veshur “me li të hollë, të pastër dhe të shkëlqyeshëm... veprat e drejta të shenjtorëve” (Zbu. 19:7-8). Ata që e quajnë veten kristianë dhe nuk i bëjnë “veprat e drejta” që u janë ngarkuar, nuk do të kenë pëlhurë për të qepur rrobën e dasmës dhe prandaj nuk do të figurojnë si pjesëmarrës në dasmë.

Kur shoh Trupin e Krishtit në botën perëndimore, jehojnë brenda meje fjalët me të cilat Jezusi dërgon në mundimin e përjetshëm kombet e cilësuar si “cjep”: “Për aq sa nuk ia keni bërë këtë ndonjërit prej këtyre më të vegjëlve...”. Nuk duhet harruar se ata nuk u mallkuan për atë që kishin bërë por për atë që nuk e kishin bërë.

## 13

# Ndoshta Keni Dështuar Edhe Ju?

Duke arritur te kjo pikë, gjeni kohë dhe mendohuni thellë. Ndoshta duke lexuar faqet e deritanishme, ju po përballeni për herë të parë me mendimin se si duhet të jetë dhe se si duhet të veprojë një baba sipas Biblës dhe Vullnetit të Perëndisë – dhe jeni i shokuar!

Mos bëni reagime të nxituara! Gjeni kohë, mendohuni për këtë temë dhe lutuni. Lutjuni Perëndisë t’jua qartësojë edhe më tepër këtë pamje. Ndoshta do të jetë ndihmë për ju të lexoni edhe një herë pesë kapitujt e fundit.

Dhe kujtohuni se si e përcakton Pali mëkatin te Romakëve 3:23: “... sepse të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë.” Mëkati nuk ka lidhje vetëm me një veprim të keq; Në thelb, të bësh mëkat do të thotë të jetosh dhe të veprosh në atë lloj mënyrë që ti me jetën tënde nuk i jep Perëndisë nderin që i takon. Dhe kini parasysh se shpeshherë burrat zhyten në faj vetëm për shkak të indiferencës, d.m.th. mëkatojnë duke mos bërë diçka të caktuar.

Ka disa momente në jetë kur njeriu duhet të gjykojë vetveten. Duke bërë këtë, kemi të drejtë të pretendojmë për hirin e premtuar te 1 Kor.11:31: “Sepse, po të shqyrtonim veten tonë, nuk do të gjyko-heshim.”

Bëni një rishikim të tre shërbimeve qendrore të një babai për

familjen e tij: prift, profet dhe mbret. Provoni veten për të parë se ku jeni në këto tre sfera dhe vazhdoni me këto pyetje:

A jam unë si prift besnik në lutjen e rregullt e të përditshme të ndërmjetësimit për familjen time? A e falenderoj shpesh Zotin për ta?

Si e përfaqësoj unë si profet Perëndinë para familjes sime? A jam unë për ta një shëmbëlltyrë e Atit të dashur në qiejt? Apo mos duhet të pranoj se shëmbëlltyra që u transmetoj është më tepër një karikaturë jo shumë tërheqëse?

A mbretëroj unë si mbret mbi fëmijët e mi me atë lloj disipline, e cila përmban edhe dashurinë, edhe rreptësinë e duhur për t'i përgatitur ata (fëmijët) që të zënë në shoqëri vendin që u takon si qytetarë të përgjegjshëm? A u vë unë fëmijëve kufi për t'i mbrojtur nga forcat e liga që veprojnë sot nëpër botë?

Si u përgjigjeni këtyre pyetjeve? A e keni dalluar se me të vërtetë keni mëkatuar dhe se nuk arrini dot "lavdinë e Perëndisë"? S'keni pse dekurajoheni dhe dorëzoheni. Perëndia nuk na bind për mëkatin për të na mallkuar, por për të na drejtuar te rruga që Ai ka përgatitur për ne nëpërmjet sakrificës së Jezu Krishtit në kryq.

## Dy Hapa të Thjeshtë

Kërkesën e thjeshtë të Perëndisë e gjejmë te letra e parë e Gjonit 1:9 "Po t'i rrëfejmë mëkatet tona, ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi." Nëse ne i pranojmë mëkatet tona para Perëndisë me zemër të hapur, Ai jo vetëm që do të na falë por do të na pastrojë nga çdo ndjenjë faji dhe dështimi dhe do të na dhurojë ndërgjegje të pastër.

Por ne duhet të hedhim edhe një hap tjetër. Marrëdhëniet tona personale janë si dy trarët e kryqit: njëri në drejtimin horizontal, tjetri në atë vertikal. Trari vertikal simbolizon marrëdhënien me Perëndinë; trari horizontal simbolizon marrëdhëniet që kemi me njerëzit rreth e rrotull. Kur pastrohemi frymërisht, duhet të kujdesemi së pari për marrëdhënien me Perëndinë, duke rrëfyer mëkatet dhe duke marrë falje. Hapi i dytë është pastrimi i marrëdhënieve tona kundrejt njerëzve që na rrethojnë, ku rrëfejmë para tyre mëkatet.

Kjo kërkesë formulohet te Jakobit 5:16 “Rrëfeni shkeljet njëri-tjetrit dhe lutuni për njëri-tjetrin, që të shëroheni; shumë forcë ka lutja e të drejtit kur bëhet me gjithë zemër.” Në Trupin e Krishtit sot flitet shumë pak për domosdoshmërinë e rrëfimit të mëkateve ndaj njëri-tjetrit. Për pasojë, në shumë grupime kristiane ekziston një atmosferë e helmuar nga mëkatet e parrëfyera dhe nga mllefi e hidhërimi, ndaj të cilave nuk ndërmerret asgjë. Kjo pengon veprimin e Frymës së Shenjtë.

Xhon Uesli shkruan në ditarin e tij se një nga “klasat” më të suksesshme të dikurshme metodiste lindi nga një grup prej rreth dhjetë vetash, të cilët takoheshin çdo javë dhe i rrëfenin mëkatet njëri-tjetrit.

Te 1 Gjonit 1:7, apostulli përmend premisën më të rëndësishme për një pastërti frymërore të vazhdueshme: “Por, po të ecim në dritë, sikurse Ai është në dritë, kemi bashkësi njëri me tjetrin, dhe gjaku i Jezu Krishtit, Birit të tij, na pastron nga çdo mëkat”. “Të ecësh në dritë” do të thotë ndër të tjera se duhet të sillemi hapur dhe sinqerisht me njëri-tjetrin. Të gjitha foljet e këtij vargu janë të formës së vazhdueshme të kohës së tanishme: “Nëse ne vazhdimisht ecim në dritë... kemi vazhdimisht bashkësi me njëri-tjetrin...gjaku i Jezusit na pastron vazhdimisht...”. Me fjalë të tjera, Gjoni na përvijon tablonë e një stili konsekuent jetese.

Kjo kërkesë vlen për të gjithë kristianët që kanë bashkësi me njëri-tjetrin, por në radhë të parë për familjen kristiane dhe i ngarkon babait një përgjegjësi krejt të veçantë.

## Një Atë Që u Rrëfyte

Le ta zëmë se hodhet hapin e parë dhe i rrëfyet mëkatet para Perëndisë. Tani duhet hedhur hapi tjetër: T’ua rrëfeni mëkatet tuaja anëtarëve të familjes, në fillim gruas dhe pastaj fëmijëve. Ka të ngjarë që të jeni i vetëdijshëm për disa mëkate tuajat, të cilat duhet t’i rrëfenit, por që deri tani i keni fshirë poshtë qilimit. Po ju them hapur se nuk ka asnjë qilim në këtë botë që t’i mbulojë ato mëkate!

Kur po punoja për këtë kapitull, më erdhi papandehur një letër nga një çift kristian të cilin e njoh prej vitesh. Po i quajmë David dhe Rozmari.

Disa muaj më parë Davidi kishte vendosur të bënte një agjërimit special; ai në radhë të parë donte të hiqte dorë jo aq nga ushqimi, sesa nga disa faktorë të jetës së përditshme që na pllakosin, na hutojnë dhe nuk na lënë të dëgjojmë zërin e Frymës. Davidi kishte vënë në listë televizorin, kinemanë dhe lloje të ndryshme të “konservës muzikore”.

Rozmaria përshkruante në letër pak nga ato rezultate që kishte sjellë kjo kohë agjërimiti në jetën e të dyve. Ja disa fragmente:

“Më duket sikur Perëndia ka filluar qysh herët – dhe vazhdon akoma – të na tregojë se sa shumë pisllek dhe papastërti ka në zemrat tona. Jam e sigurt se do të kisha vdekur në vend, nëse Ai do të ma kish treguar të gjithë mëkatën menjëherë. Por me natyrën e Tij të butë dhe plot hir Ai na tregon hap pas hapi se çfarë nuk i pëlqen. Dhe kjo s’ka të mbaruar. Mua më duket sikur kam muaj të tërë që rrëfej gabimet... po kështu edhe Davidi.

Në fillim të agjërimit Perëndia i bëri të qartë Davidit se e gjithë koha e agjërimit do të ishte e pavlerë nëse ai nuk do t’i tregonte të gjitha mëkatet e fshehura. Prandaj ai rrëfeu gjithçka para Zotit dhe u pendua. Pastaj Zoti tha: “Tani tregojë gruas tënde!” Me shumë dhimbje, përlulesi dhe keqardhje ai më tregoi mëkate të fshehura, për të cilat unë nuk e kisha fare idenë dhe as që mi kish rrokur mendja. Ishte padyshim Perëndia Ai që na solli deri në atë pikë dhe na inkurajoi e vërtetoi gjatë kësaj kohe me vargje të ndryshme.

Rëfimi i Davidit që si zilja e zgjimit për ne dhe për disa miqtë tanë të cilëve u treguam diçka. Perëndia e përdori këtë situatë për të na treguar se sa lehtë na turbullohet shikimi nga fryma e kohës, se sa pa zhurmë hyn mëkati derisa të na zotërojë krejt dhe se sa shumë ne veprojmë me kokën tonë pa pyetur Perëndinë. Herë pas here Perëndia na tregon se ne nuk e ruajmë zemrën. Perëndia na tregon të dyve se kemi lejuar idhuj në jetën tonë. Davidi hodhi pjesën më të madhe të koleksionit të tij jo të vogël muzikor. E di se këtë e bëri Perëndia, pasi mua nuk do të ma kishte vënë veshin.

Mund ta përmbledh me tre fjalë atë që na ndodhi: Dhimbje, pastrim dhe rizgjim. Tani e kuptoj se ç’është Rizgjimi. Rizgjimi nuk ndodh në një ndërtesë apo te shumë njerëz njëherazi, por në një zemër që i është përkushtuar dashurisë së lavdishme të Perëndisë dhe që reagon

ndaj përpjekjes dhe korigjimit të Tij. Mahnitem dhe jam mirënjohëse kur shoh se sa butë sillet Perëndia me mua në këtë proces. Ai më korigjon dhe më ripërtërin plot hir.

Që nga ajo kohë, në jetën tonë kanë ndodhur gjëra të mrekullueshme. Para disa mujash Davidi pyeti një grup burrash nëse kishin dëshirë të hanin bashkë mëngjes të hënave, një herë në dy javë. Aty ata luteshin për njëri-tjetrin dhe shkëmbenin mendime. Pasi Davidi u tregoi të gjithëve atë që kishte ndodhur me ne, gati të gjithë burrat e këtij grupi shkuan te gratë e tyre dhe rrëfyen këtë apo atë mëkat të fshehur. Perëndia vazhdon edhe tek ata procesin e pastrimit!

Ndërkohë takohemi edhe ne, gratë e tyre, me njëra-tjetrën për t'u lutur për bashkëshortët. Dhe këtu ndodh derdhja më madhështore dhe e natyrshme e Frymës së Shenjtë që kam parë ndonjëherë. Them e "natyrshme", sepse ne jemi të gjitha në bashkësi të ndryshme. Kjo derdhje nuk bëhet në një ndërtesë; është thjesht Trupi i Krishtit që i shërben njëri-tjetrit! Është me të vërtetë e çuditshme! Dhe duke qenë në bashkësi të ndryshme ne tregojmë në bashkësitë tona atë që ndodhi dhe kështu përhapet ky ndikim!

Ajo që ndodh në këtë familje duhet të ndodhë në miliona familje ku babai ka mëkate të parrëfyera në jetën e tij. Shumë kristianë janë të vetëdijshëm për mëkatet e parrëfyera, por ata mendojnë: "Nëse nuk i kushtoj rëndësi kësaj gjëje, ka për t'u larguar vetë." Ky është arsyesim i gabuar! Ka vetëm një mundësi për ta luftuar efektivisht mëkatit – pendimi me gjithë zemër dhe pastaj rrëfimi: "Kush i fsheh shkeljet e tij, nuk do të ketë mbarësi; por ai që i rrëfen dhe i braktis ato, ka për të fituar mëshirë" (Fja. 28:13).

Dhe kështu arrijmë tek arsyeja e vërtetë që na bllokoi për rrëfimin e mëkatit: krenaria. Ne mendojmë: "Nëse e rrëfej këtë mëkat, do të poshtërohem." Jo, edhe ky është arsyesim i gabuar! Kur rrëfeni mëkatet, ju përrulni vetveten. Por nëse refuzoni t'i rrëfeni ato, në fund do të poshtërohëni nga rrethana të jashtme!

Perëndia kurrë nuk do që të na përrulë. Mesazhi i Tij pa kompromis quhet: "Përrulu!" (krahajo 1 Pjetrit 5:6). Kjo është diçka që duhet ta bëni vetë. Askush tjetër nuk mund t'ju përrulë – madje as vetë Perëndia! Por nëse refuzoni të përruleni, herët a vonë do të vijë koha kur do të poshtërohëni.

Zgjidhni e merrni: Ju, ose përujeni dhe ia besoni veten hirit dhe dhembshurisë së Perëndisë ose refuzoni të përujeni dhe do të poshtërohemi me kalimin e kohës nga rrethana që ju dalin gjithnjë e më tepër jashtë kontrollit

## Kujt T'i Rrëfehemi?

Tani ndoshta bëni pyetjen: Kujt t'ia rrëfej mëkatet e mia? Dikush i është përgjigjur kështu kësaj pyetjeje: Rrëfimi duhet të jetë në po atë masë që është bërë mëkati. Pra, rrëfejani mëkatin gjithë atyre që vuajtën për shkak të tij.

Çdo formë e mëkatit para së gjithash drejtohet kundër Perëndisë. Megjithëse mbreti David me anë të mëkatit dëmtoi dy persona – Bath-Shebën, të cilën e joshi në tradhti bashkëshortore dhe burrin e saj Uriah, vrasjen e të cilit e organizoi me dredhi – ai i tha Perëndisë: “Kam mëkatuar kundër teje, vetëm kundër teje, dhe kam bërë atë që është e keqe për sytë e tu” (Psa. 51:4). Nën dritën bindëse të Frymës së Shenjtë, Davidi dalloi së mëkati i tij në radhë të parë ishte fyerje ndaj Perëndisë së shenjtë dhe të denjë për respektin më të madh.

Kur të rrëfeni mëkatet para Perëndisë, kini para sysh se nuk po i tregoni Atij diçka të re. Rrëfimi i mëkatit nuk ka për qëllim të informojë Perëndinë, por të nxjerrë në dritë mëkatin në mënyrë që të ndërmerret diçka. Perëndia nuk fal dot një mëkat të fshehur në errësirë. Nëse duam faljen e Tij, duhet t'ia ekspozojmë mëkatin dritës së lavdishme të fytyrës së Tij.

Nëse ende ngurroni të rrëfehemi, dua t'ju kujtoj këtë kërkesë të thjeshtë të Perëndisë: “Po t'i rrëfej mëkatet tona, ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi” (1 Gjonit 1:9). Kjo fjalë inkurajuese është njëkohësisht edhe paralajmëruese. Nëse rrëfehemi, Perëndia është zotuar t'ju falë. Por Ai kurrë nuk është zotuar të falë mëkate të parrëfyera.

Kini gjithashtu parasysh se kur Perëndia fal, Ai na pastron nga çdo padrejtësi e lidhur me mëkatin.

Nëse jeni falur, pra, jeni pastruar nga çdo padrejtësi. Nëse zemra juaj nuk është pastruar, ka mundësi që ende nuk jeni i falur. Ndoshta nuk jeni penduar me të vërtetë. Në shumicën e rasteve, mëkati ynë



lëndon persona të tjerë. Në raste të tilla ne jemi të detyruar, brenda mundësive, të rrëfëhemi para njërit apo më shumë personave të lënduar.

Nëse babai i familjes mëkaton, ka mundësi që faji i tij në njëfarë mënyre të prekë gjithë familjen. Normalisht, personi i parë te i cili ai duhet të rrëfëhet, është e shoqja. Nëse fëmijët janë ende të parritur, ai duhet të ketë kujdes të mos flasë për mëkatin në atë mënyrë që mund të lëndonte ndërgjegjet e tyre të brishta. Para se të rrëfëjë mëkatin, babai duhet t'i lutet sinqerisht Perëndisë që ta paraprijë dhe të përgatisë zemrat e anëtarëve të familjes. Ai duhet t'i lutet Perëndisë që t'i tregojë kur dhe si t'i rrëfëjë mëkatet.

Nëse e keni seriozisht dhe jeni i hapur ndaj Frymës së Shenjtë, Ai do t'ju tregojë konkretisht se cilat mëkate duhen rrëfyer. Disa mëkate të manifestuara zakonisht te baballarët janë padurimi, acarimi dhe zemërimi i pakontrolluar. Baballarët, ashtu si të gjithë burrat, tundohen shpeshherë edhe nga disa forma të papastërtisë seksuale, qoftë në realitet apo imagjinatë. Pornografia është një mëkat që skllavëron një numër të madh burrash në kohën tonë.

Bibla nuk flet asnjëherë për mëkate të "vogla". Te 1 Gjonit 5:17, apostulli na kujton se "çdo paudhësi është mëkat". Midis drejtësisë dhe mëkatit nuk ka zonë neutrale (asnjanëse). Çdo gjë e padrejtë është mëkat.

Nga ana tjetër, Bibla disa mëkate i kategorizon si të "mëdha". P.sh. kur Jozefi u tundua për tradhëti bashkëshortore me gruan e Potifarit, ai thirri: "Si mund të bëj unë këtë të keqe të madhe dhe të kryej një mëkat kundër Perëndisë?" (Zan. 39:9). Ashtu si Davidi, edhe Jozefi e kishte të qartë se do të bënte mëkat në radhë të parë kundër Perëndisë.

## Jashtë Zonës Së Muzgut

Sot shumë kristianë jetojnë në atë që unë po e quaj "zonë muzgu". Nga njëra anë, ata nuk ecin nën dritën e qartë diellore të favoreve të Perëndisë duke iu bindur Atij pa kushte; nga ana tjetër, nuk jetojnë as në errësirën e thellë të mëkatit.

Mirëpo ungjilli nuk lë hapësirë për asnjësi frymërore. Nëse

keni dëshirë të jeni baba sipas zemrës së Perëndisë, duhet të jeni i gatshëm t' i hapni Atij zemrën dhe jetën tuaj. Duke e lejuar Perëndinë të nxjerrë në dritë çdo mëkat dhe të kryejë veprën e pastrimit brenda jush, ju dilni nga kjo zonë muzgu dhe hyni në dritën e qartë diellore të favorit të Perëndisë. Nën këtë dritë do të kuptoni gjithnjë e më tepër se ç' do të thotë të jesh baba.

## Por Ju Mund Të Dilni Me Sukses

Përmes leximit të kapitujve të mëparshëm, ju u ballafaquat me dështime në disa aspekte të jetës suaj. Keni arritur të dalloni se nuk keni qenë një baba ashtu siç e dëshiron Perëndia – dhe ashtu siç ka nevojë urgjente familja juaj. Tani ka ardhur koha të merrni një vendim. Kthejini kurrizin dështimit dhe nënshtrojani vetveten Perëndisë për shërbesën si atë. Nëse jeni i gatshëm për këtë, ndërmerrni këto katër hapa.

### 1. Zini Vendin si Kreu i Familjes

Kjo kërkon vendim dhe nënshttrim. Bëni një lutje pak a shumë të tillë: “Zot, e pranoj se më ke ngarkuar përgjegjësinë për të qenë kreu i familjes sime. Sipas vendimit tim të vullnetshëm, e pranoj këtë pozicion dhe përgjegjësinë që lidhet me të. Për këtë detyrë ta nënshtroj ty veten time.”

Pasi të keni bërë këtë akt nënshttrimi, Perëndia do të fillojë t’ju pajisë me autoritetin e duhur që ju nevojitet për të qenë kreu i familjes. Ky është ndikimi i një parimi që përshkon si fill i kuq gjithë Shkrimin. Perëndia nuk jep kurrë përgjegjësi pa autoritet dhe autoritet pa përgjegjësi.

Centurioni romak dërgoi lajmëtarin e tij te Jezusi me qëllim që Ai

të vinte e t'i shëronte shërbëtorin, i cili ndodhej në prag të vdekjes. Jezusi niset bashkë me lajmëtarin për te shtëpia e centurionit. Por para se të arrinte atje, centurioni dërgon dikë për t'i thënë:

“Zot, mos u mundo, sepse unë nuk jam i denjë që ti të hysh nën çatinë time. Prandaj nuk e çmova veten të denjë të vij tek ti; por ti fol një fjalë dhe shërbëtori im do të shërohet. Sepse dhe unë jam një njeri nën autoritet dhe kam nën vete ushtarë; dhe i them njerit: ‘Shko’, dhe ai shkon; dhe një tjetri: ‘Eja’, dhe ai vjen; dhe shërbëtorit tim: ‘Bëje këtë’, dhe ai e bën”.

(Luka 7:6-8)

Ky centurion romak kishte dalluar se autoriteti i Jezusit në sferën frymërore ishte i ngjashëm me autoritetin e atij vetë në sferën ushtarake. Në një frazë të vetme, ai përmbledh kushtin thelbësor të ushtrimit të autoritetit në çdo fushë: të jesh vetë nën autoritet. Autoriteti gjithmonë transmetohet nga lart poshtë.

Aty nga fundi i shërbimit të tij mbi tokë, Jezusi u tha dishepujve, “Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell dhe në tokë” (Mateu 28:18). Prandaj gjithë autoriteti në mbarë universin zbret prej Perëndisë Atë nëpërmjet Birit të Tij, Jezu Krisht.

Te 1 Kor. 11:3 Pali përshkruan sesi zbret ky zinxhir autoriteti mbi çdo familje tokësore: “Por dua që të dini se kreu i çdo burri është Krishti, edhe kreu i gruas është burri; edhe kreu i Krishtit është Perëndia”. Këtë mund ta paraqesim kështu:

Perëndia Atë  
Krishti  
Burri (bashkëshorti)  
Gruaja (bashkëshortja)

Kështu, autoriteti si burrë dhe baba varet nga nënshtrimi juaj ndaj Jezusit. Nëse i nënshtroheni Atij si Kreut tuaj, gjithë autoriteti i qiellit do te rrjedhë nëpërmjet jush në familjen tuaj dhe ju do të mund të kryeni detyrën si kreu i familjes. Por, nëse nuk i nënshtroheni Jezusit, mundohuni sa të doni në mish – bërtisni, përplasni këmbët ose in-

atosuni dhe madje përdorni dhunën – e megjithatë vazhdimisht do t’ju mungojë diçka: ai autoriteti i mirëfilltë i dhënë nga Perëndia dhe vetëm ky autoritet ju bën të jeni kreu efektiv i familjes suaj.

## 2. Besoni te Perëndia dhe Merrni Hir

Roli si baba është thirrje e Perëndisë dhe po aq i shenjtë sa edhe roli si ungjilltar apo pastor. Nëse Perëndia do t’ju kishte thirrur në një nga këto dy shërbesa, nuk do të mund t’i përmbushnit ato vetëm me aftësitë tuaja natyrore. Do ta kërkonit Atë (Perëndinë) për t’ju dhënë hirin e duhur me qëllim që t’ia dilnit mbanë. Prandaj, po ashtu besojini Perëndisë që t’ju japë hir për të qenë një atë i suksesshëm.

Ja këtu disa fjalë inkurajuese nga Hebrenjve 4:16 “Le t’i afrohemi, pra, me guxim fronit të hirit, që të marrim mëshirë e të gjejmë hir, për të pasur ndihmë në kohën e duhur”.

Mos harroni se e keni rrugën të hapur për te froni i Perëndisë që sundon gjithë universin dhe që ka çdo situatë e person nën kontroll. Vini re gjithashtu se ky është një fron hiri, prej të cilit derdhet falas dhe pa e merituar favori i Perëndisë mbi të gjithë ata që vijnë nëpërmjet flijimit të Jezusit në kryq. Jeni i ftuar të vini me guxim dhe jo duke ngurruar e dyshuar. Nuk keni pse te zvarriteni si nevojtar, ju jeni fëmijë i Perëndisë, Atit tuaj, i mirëpritur në çdo kohë në praninë e Tij. Nëse vini mbi këtë bazë, Perëndia ju ofron dy gjëra: mëshirë dhe hir. Asnjëra prej tyre nuk mund të fitohet me mundim njerëzor; duhet t’i merrni si dhuratë nga Perëndia.

## Mëshirë për të Kaluarën

Mëshira merret me të kaluarën. Ajo mbulon gjithë gabimet dhe dështimet që ju bëjnë të ndieheni i paaftë. Sapo të jeni rrëfyer dhe penduar për të gjitha mëkatet e kryera, ato nuk mund të përdoren më kundër jush.

Ka të ngjarë që t’ju vijnë ndër mend skena ende të freskëta nga e kaluara – ngjarje kur ju vepronit apo reagonit ashtu siç nuk i ka hije një ati. Por kur pendoheni dhe i rrëfeni ato, lajmi i mrekullueshëm i ungjillit ju siguron se Perëndia i fshin këto mëkate nga kujtesa e tij.

Kjo është shprehur në gjuhë të gjallë të bukur te Mikea 7:18-19

“Cili Perëndi është si ti, që fal paudhësinë dhe kapërcen shkeljen e mbetjes së trashëgimisë së tij? Ai nuk e mban përgjithnjë zemërimin e tij, sepse i pëlqen të jetë i mëshirshëm. Atij do ti vijë përsëri keq për ne, do të shkelë paudhësitë tona. Ti do të hedhësh në fund të detit tërë mëkatet tona.”

Kur të keni përmbushur kushtet e Perëndisë, Ai do t’i hedhë pas shpine mëkatet tuaja duke i fundosur në oqeanin e harresës. Këtu, Kori ten Bum (Corrie ten Boom) ka shtuar: “Dhe kur Perëndia i hedh mëkatet tona në oqean, ai ngul aty tabelën: “Ndalohet peshkimi!” Nëse Perëndia i plotfuqishëm i ka harruar mëkatet tuaja, përse ju ta çoni prapë mendjen tek ato?

## Hir për të Ardhmen

Sapo të keni mbyllur hesapet me të kaluarën, mund të hidhni sytë tek e ardhmja e të kërkonin hirin që ju nevojitet për të kryer me sukses detyrën si atë. Ashtu si mëshira, edhe hiri nuk mund të fitohet; ai mund të merret vetëm me anë të besimit.

Domethënia e hirit është formuluar pak a shumë kështu: “Favor falas dhe i pamërituar ndaj dikujt që nuk i takon dhe ndaj dikujt që në fakt meriton të keqen.” Për shkak të marrëdhënies së krijuar midis jush dhe Perëndisë me anë të Jezut Krishtit, Perëndia ju sheh me mirëdashje (favor). Ai gëzohet për ju. Ai ju dëshiron më të mirën. Ai dëshiron që ju të keni sukses në çdo rrethanë – para së gjithash si atë!

Apostulli Pali u gjend shumë herë nën trysni të jashtëzakonshme dhe para provash tepër të vështira. Në një moment i thirri Perëndisë për çlirim, por përgjigjja e Perëndisë qe: “Hiri im të mjafton” (2 Korintasve 12:9). Do të mjaftojë edhe për ju! Ndoshta ju nuk duhet të provoni gjithë ato që provoi Pali. Por cilatdo që të jenë rrethanat dhe përvojat, mesazhi i Perëndisë për Palin vlen edhe sot: “Hiri im të mjafton.”

Hiri na bën të ngrihemi përmbi aftësitë tona natyrore. Kur ne i kemi mbaruar rezervat tona, le t’i lutemi Perëndisë të na japë hir – aftësimin e Tij të mbinatyrshëm. Hiri fillon aty ku mbarojnë aftësitë tona.

Kjo vlen për ju si atë. Do të ketë kohë kur ju do ta ndjeni veten të

paaftë për këtë përgjegjësi. Pikërisht në këtë moment duhet të mbani fort hirin e Perëndisë. Pranoni hapur dhe sinqerisht se i keni harxhuar rezervat dhe thuajini Atij: “Zot, unë jam i varur krejtësisht prej teje në çdo gjë të pamundur për mua.”

Dhe ashtu si Pali, do të konstatooni se aty ku mbarojnë rezervat tuaja, nisni të zbuloni se ç’mund të bëjë hiri i Perëndisë. Dhe do të mund të thoni si Pali: “Kur jam i dobët, atëherë jam i fuqishëm” (2 Kor. 12:10).

### **3. Studioni “Përshkrimin e Punës”**

Ndoshta është e nevojshme të lexoni edhe njëherë kapitujt 8, 9 dhe 10 në të cilat trajtohen përgjegjësitë e atit si prift, profet dhe mbret. Vini re sferat ku ndjeni dobësi. Pastaj lutjuni Perëndisë t’ju tregojë sesi mund të përmirësoheni.

Por të mos harroni kurrë një gjë: Perëndia është në anën tuaj. Atij i pëlqen vendimi që keni marrë për të qenë kreu i familjes. Dhe mos harroni se kur varemi plotësisht prej tij, zbulojmë se Ai e justifikon gjithë besimin tonë!

### **4. Kushtojni Kësaj Pune Gjithë Kohën e Duhur**

Se sa prioritet i kushtojmë diçkaje, duket te koha që shpenzojmë për të. Koha është një kriter në bazë të të cilit fëmijët tanë gjykojnë se sa të rëndësishëm janë ata për ne. Ne që jetojmë në shoqërinë e sotme perëndimore ndodhemi nën një trysni gjithnjë e më të madhe. Sa më shpejt ta kryejmë një detyrë të ngarkuar, aq më të sukseshëm jemi. Mirëpo kjo nuk është metodë efikase për matjen e suksesit në marrëdhëniet njerëzore — aq më pak në marrëdhëniet me fëmijët tanë!

Lexova njëherë një artikull mbi dy prindër tepër të suksesshëm në profesionet e tyre. Njëri ishte avokat dhe tjetri punonte në botën e biznesit. Ashtu si shumë prindër sot edhe ata kishin për synim t’u kushtonin dy apo tre fëmijëve të tyre një pjesë të vogël të kohës, por duke pasur kujdes që kjo të ishte një “kohë cilësore”. Me fjalë të tjera, gjatë kësaj “kohe cilësore”, ata përqendroheshin intensivisht te fëmija.

Nga leximi i këtij artikulli nuk dallohej qartë se ç’bënin ata me fëmijët gjatë kësaj “kohe cilësore”. Por reagimi im personal ishte ky:

Po të isha fëmijë, nuk do të kënaqesha me një racion të paktë të të ashtuquajturës “kohë cilësore”. Si fëmijë – me siguri këtë e dëshirojnë të gjithë fëmijët – dua të ndiej se prindërit janë afër meje sa herë që të kem nevojë për ta.

Disa prej nesh, prindërve – sidomos baballarët – le të pyesin veten se si do të ndieheshin nëse Ati ynë në qiell do të na jepte vetëm një kohë të racionuar të pranisë së tij. Sa mirënjohës jam duke ditur se Ati ynë në qiell nuk është i tillë! Ai është gjithnjë afër nesh, ditë e natë. Ai ka premtuar: “Para se të më thërrasin, unë do të përgjigjem; do të jenë ende duke folur kur unë do t’ua plotësoj” (Isaia 65:24).

Dihet se ne si baballarë hasim vazhdimisht në shumë pengesa. Disa janë të natyrës fizike; kemi gjithashtu edhe detyrime që na hanë kohë e nuk i lëmë dot pas dore. Në fund të fundit, vendimtar nuk është numri i orëve që kalojmë çdo ditë me fëmijët, por ndjesia e fëmijës se ne i gjendemi pranë dhe se e ia vëmë vërtet veshin kur na thotë diçka. A kemi mundësi tu japim atë siguri që na jep Perëndia, “Do të jenë ende duke folur kur unë do t’ua plotësoj”?

Shumë vite më parë, kur pjesa më e madhe e fëmijëve jetonin akoma te Lydia dhe unë në shtëpi, qemë ulur njëherë si familje rreth tryezës së ngrënies dhe po bisedonim fare lirshëm mbi gjërat frymërore. Kisha në prehër vajzën tonë 10-vjeçare. Krejt papritur – askush nuk u lut për të në atë moment – ajo u mbush në mënyrë të mbinatyrshme me Frymën e Shenjtë dhe nisi të lavdëronte Zotin në gjuhë të reja, ashtu siç ia dha Fryma.

Më vonë pyeta veten se përse ajo ishte e hapur pikërisht në atë moment për Frymën e Shenjtë? Nxora përfundimin se pikërisht në kohën kur ishte ulur në prehrin tim, ajo e ndjeu veten krejtësisht të sigurtë se ne e donim dhe në atë moment u thye çdo pengesë ndaj Frymës së Shenjtë.

Si baballarë duhet t’i bëjmë një pyetje vetes: A e ndiejnë anëtarët e familjes këtë atmosferë dashurie dhe sigurie? Për të krijuar këtë lloj atmosfere nuk mjafton një “kohë cilësore” e shkurtër. Ndoshta duhet të bëni sakrificë p.sh. duke hequr dorë – të paktën për njëfarë kohe – nga një dëfrim apo sport i preferuar. Por duke e bërë këtë, ju i transmetoni fëmijës një mesazh pa fjalë. I thoni: “Ti je tepër i rëndësishëm për mua!”



## Atësi Frymërore

Në kapitullin 8, thashë se një atë i vërtetë është shembulli më i përkryer i Perëndisë që mund të arrijë një njeri, sepse atësia është zbulesa më e fundit e vetë Perëndisë. Disa mund të lëndohen nga kjo. “Po unë nuk jam i martuar”, mund të thotë dikush. Ose, “Unë jam i martuar, por nuk kam fëmijë. A mos do të thotë kjo se unë nuk mundem kurrë të bëhem i ngjashëm me Perëndinë?”

Faleminderit Zotit, përgjigjja është “jo!” Ndoshta ti nuk do të bëhesh kurrë baba nga ana natyrore, trupore. Por ty të mbetet hapur një formë tjetër atësie: atësia frymërore. Me këtë unë nënkuptoj një atësi që rrjedh nga një marrëdhënie frymërore, jo trupore. Kjo lloj atësie nuk është aspak inferiore apo e dorës së dytë. Në të vërtetë, si shembuj të kësaj atësie mund të përmendim disa nga karakteret më domethënës të Biblës.

Shembulli i parë dhe më spikatës është Abrahami. Natyrisht, ai ishte baba natyral i fëmijëve të lindur nga Hagari, Sara dhe, në fund, Këtura. Por përtej kësaj, Bibla na e paraqet Abrahamin si një shembull të shkëlqyer të atësisë frymërore.

Te Romakëve 4:13 Pali thotë: “Sepse premtimi për të qenë trashëgimtar i botës, iu bë Abrahamit dhe pasardhësve të tij, jo nëpërmjet ligjit, por nëpërmjet drejtësisë së besimit”. Ai vazhdon:

“Prandaj trashëgimia është nëpërmjet besimit; në këtë mënyrë ajo

është nëpërmjet hirit, me qëllim që premtimi të jetë i siguruar për të gjithë pasardhësit, jo vetëm për atë që është nga ligji, por edhe për atë nga besimi i Abrahamit, i cili është ati i ne të gjithëve (siç është shkruar: 'Unë të bëra atin e shumë kombeve'), para Perëndisë që ai besoi, i cili u jep jetë të vdekurve dhe thërret ato që nuk janë sikur të ishin. Ai, duke shpresuar kundër çdo shprese, besoi për t'u bërë ati i shumë kombeve sipas asaj që i ishte thënë: 'Kështu do të jetë pasardhja jote.' (v. 16-18)

Prandaj, në kuptimin frymëror, Abrahami u bë atë i shumë kombeve. Mbi ç'bazë i bëhet atij ky nder kaq i madh? Mbi bazën e një besimi të fortë, të palëkundur, të shprehur në një bindje pa kushte. Kjo bindje mori formë përfundimtare në përgjigjen e Abrahamit ndaj kërkesës së Perëndisë për të ofruar birin e tij, Isakun, si flijim.

Në këtë mënyrë, Abrahami hapi një rrugë të cilën duhet ta ndjekin të gjithë besimtarët e tjerë. Te Romakëve 4:20 Pali thekson qëndrueshmërinë e besimit të Abrahamit: "Madje nuk dyshoi me mosbesim në premtimin e Perëndisë, por u forcua në besim duke i dhënë lavdi Perëndisë. "

## Pali si Shembull

Një tjetër shembull spikatës i atësisë frymërore na jepet tek apostulli Pal. Te 1 Kor. 4:14-16, ai u shkruan kristianëve në Korint:

"Këto nuk po i shkruaj që t'ju turpëroj, por që t'ju paralajmëroj si fëmijët e mi të dashur. Sepse, edhe sikur të kishit dhjetë mijë mësues në Krishtin, prapëseprapë nuk keni shumë etër, sepse unë ju kam lindur në Krishtin Jezus, me anë të ungjillit. Prandaj ju bëj thirrje të bëheni imituesit e mi!"

Nëpërmjet farës që mbollti në zemrat e njerëzve në Korint, Pali u bë atë i shumë fëmijëve frymërore.

Një shërbëtor i Perëndisë që predikon me besnikëri fjalën, mund të ngjizë shumë fëmijë frymërorë. Por, duhet të ngulisim në mendje parimin e caktuar nga Perëndia te Zanafilla 1:29, në fillim të krijimit:

## Atësi frymërore

“Dhe Perëndia tha: ‘Ja unë po ju jap çdo bar që lëshon farë mbi sipërfaqen e mbarë tokës dhe çdo pemë të ketë fruta që përmbajnë farë; kjo do t’ju shërbejë si ushqim.’”

Fryti i pemës përmban farën. Predikimi i një personi, i cili çon një jetë të pafrytshme nuk përmban atë farën e nevojshme për t’u dhënë jetë njerëzve të tjerë. Kjo është edhe arsyeja përse shumë predikime zgjojnë vetëm një reagim të përkohshëm emocional, por nuk japin fryt të përhershëm.

Te Filipianëve 2:20-22 Pali ilustron një lloj tjetër atësie frymërore. Mbi bashkëpunëtorin e tij më të ri, Timoteun, ai thotë:

“Sepse nuk kam asnjë në një mendje me mua, që të kujdeset sinqerisht për gjërat tuaja. Sepse të gjithë kërkojnë interesin e vet dhe jo ajo të Jezu Krishtit. Por ju e njihni provën e tij sesi i shërbeu bashkë me mua ungjillit, si një bir i shërben të atit.”

Te Vep. 16:1-3 na tregohet pjesërisht mbi udhëtimin e dytë misionar të Palit. Këtu thuhet se Timoteu, kur u takua për herë të parë me Palin në zonën e Derbës dhe të Listrës, ishte tashmë një besimtar për të cilin udhëheqësit e bashkësisë së atjeshme flisnin vetëm fjalë të mira. Duke dalluar potencialin frymëror të ky djalë i ri, Pali e fton atë për ta shoqëruar në udhëtimet e mëvonshme. Që nga kjo kohë Timoteu u bë bashkëpunëtor i Palit dhe kjo marrëdhënie vazhdoi deri në vdekjen e këtij të fundit.

Në këtë rast Pali u bë atë frymëror për Timoteun jo nëpërmjet shpalljes së ungjillit, por nëpërmjet një marrëdhënieje personale ku ai e bëri Timoteun bashkëpunëtor të besuar. Në këtë mënyrë, Timoteu jo vetëm që mori udhëzime frymërore, por edhe e ndoqi Palin në fazat e ndryshme të shërbesës së tij të shumanshme. Ai pa me sytë e tij se si Pali e zbatonte mësimin nën trysninë dhe vështirësitë e jetës së përditshme.

Në fund të jetës së tij Pali i shkruan Timoteut:

“Por ti ndoqe mësimin tim, sjelljen, qëllimin, besimin, zemërgjerësinë, dashurinë, durimin, përndjekjet, vuajtjet, që më ndodhën në Antioki,

## Etër

në Ikon dhe në Listra; çfarë përndjekjesh hoqa! Dhe Perëndia më shpëtoi nga të gjitha. Por edhe të gjithë ata që duan të rrojnë me perëndishmëri në Krishtin Jezus, do të përndiqen.”

(2 Timoteut 3: 10-12)

Timoteu nuk mori udhëzime në formë leksionesh në një klasë mësimi nga Pali, por në praktikë, në të përpjetat dhe tatëpjetat e një jete të mbushur me rreziqe. Ai jo vetëm që dëgjonte predikimet e Palit, por, ç’ ishte më e rëndësishmja, asistonte personalisht duke parë se si Pali vinte në jetë atë që predikonte. Atësia frymërore e Palit për Timoteun rezultoi nga kjo marrëdhënie e ngushtë personale.

Kishte edhe disa djem të tjerë me të cilët Pali mbante marrëdhënie të mira ashtu si me Timoteun, ndoshta jo po kaq të ngushta. Këtu përfshihej Titi, Sopatri nga Berea, Aristarku dhe Sekundi nga Thesalonikasit, Gai nga Derba, Tikiku dhe Trofimi nga Azia.

Një nga gjërat më të nevojshme për kishën tonë bashkëkohore janë burrat që luajnë një rol të tillë si ai i Palit me Timoteun. Kam përmendur tashmë se shoqëria jonë ka nevojë urgjente për burra që të jenë etër të vërtetë. Kjo nevojë nuk është më e paktë nëpër bashkësi. Ne kemi burra që organizojnë, predikojnë, administrojnë dhe shfaqin të gjitha llojet e funksioneve fetare. Por sa prej tyre u përkushtohen djemve të rinj dhe ndajnë me ta sukseset dhe dështimet në ashpërsinë dhe turbullimet e jetës së përditshme kristiane? Sa prej tyre janë të gatshëm të ndajnë çastet e dobësisë dhe të dëshpërimit po të jetë nevoja?

Te 1 Thesalonikasve Pali na prezanton atë që mund ta quajmë “brezi i tretë” i atësisë frymërore. Ai flet për Silën, Timoteun dhe vetveten:

“Siç e dini sikundër këshilluam, ngushëlluam dhe iu përgjëruam secilit prej jush, si bën një atë me bijtë e vet, që të ecni denjësisht ndaj Perëndisë, që ju thërret në mbretërinë dhe lavdinë e tij.”

(1 Thesalonikasve 2: 11-12)

Këtu Timoteu ndërmori bashkë me Palin dhe Silën rolin e atit frymëror për besimtarët në Selanik. Ky bir frymëror i Palit tani figuron si atë frymëror për thesalonikasit. Këtu na jepen gjithsej tre breza

## Atësi frymërore

frymërore: Pali, si atë për Timoteun, i cili nga ana e tij u bë atë për thesalonikasit. këtë mund ta paraqesim si më poshtë:

Pali  
Timoteu  
Thesalonikasit

### Një Jetë në Besim dhe Bindje

Në kapitullin 7, përmenda se Jezusi nuk ua zbuloi dishepujve Atin si një koncept teologjik. Ashtu siç tha te Gjoni 17:6, Ai “manifestoi “emrin e Atit me mënyrën e vet të jetesës para syve të dishepujve. Ishte një jetë në komunikim të paprerë me Atin, një varësi çast-pasçasti dhe një bindje e pagabuar ndaj vullnetit të Atit.

Po kështu edhe atësia frymërore mund të jetë më shumë sesa një kuptim apo koncept i zbrazët teologjik. Kjo shprehet me një jetë e jetuar në besim dhe bindje dhe bëhet shembull ndjekës për të tjerë.

Një atë frymëror duhet të jetë i aftë të japë të njëjtin urdhër si Jezusi: “Më ndiq!”. Ose ashtu si Pali kristianëve në Korint, “Jini imitues të mi, ashtu si unë jam i Krishtit” (1 Kor 11:1).

Në ushtrinë moderne izraelite ekziston ky rregull: Komandanti nuk u thotë trupave, “Përpara!” Ai thotë, “Pas meje!” E njëjta gjë vlen edhe për ushtrinë e Perëndisë.

Përsa i përket karakterit, Perëndia ua nënshtron shërbëtorët e tij testeve më të rrepta. Prandaj duhet të bëjmë pyetjen se çfarë kushtesh karakteri duhet të përmbushë një burrë i cili dëshiron të luajë rolin e një ati frymëror. Për të marrë përgjigje le të përmbledhim shkurtimisht tiparet më të rëndësishme të karakterit të atyre burrave që i kemi si shembull të atësisë frymërore.

### Abrahami

Siç e pamë, aspekti më spikatës i karakterit të Abrahamit është besimi i palëkundur dhe bindja e menjëhershme, totale ndaj gjithçkaje që Perëndia kërkoi prej tij. Një shembull i mrekullueshëm për këtë është reagimi i tij kur Perëndia i kërkoi si flijim të birin, Isakun.

Padyshim që Isaku ishte gjëja më e dashur për Abrahamin. Për më tepër, ashtu siç thekson autori i letrës së Hebrenjve, Isaku ishte kanali nëpërmjet të cilit Abrahami do të merrte të gjitha bekimet që Perëndia i pati premtuar atij. Por, pavarësisht nga kjo, Abrahami nuk u lëkund për asnjë çast. Ai jo vetëm që u bind; ai u bind menjëherë, pa hezitim:

“Kështu Abrahami u ngrit herët në mëngjes, i vuri samarin gomarit, mori me vete dy shërbyes dhe të birin Isak dhe çau dru për holokaustin; pastaj u nis drejt vendit ku i kishte thënë Perëndia të shkonte.”  
(Zan. 22:3)

## Pali

Nëpërmjet lajmit të ungjillit, Pali u bë për dy arsye atë i shumë kristianëve në Korint. Së pari, Pali nuk ofroi në predikimet e tij – në kundërshtim me disa predikues të kohëve tona- përgjigje të thjeshtësuara e banale mbi problemet e jetës. Në qendër të mesazhit të tij drejtuar korintasve qëndronte kryqi. Ai këtë e nënvizon te 1 Kor. 2:1-2.

“Edhe unë, o vëllezër, kur erdha te ju, nuk erdha me shkëlqim fjalësh a urtësie, që t’ju shpall dëshminë e Perëndisë, sepse e vendosa që të mos di tjetër gjë ndër ju, veç Jezu Krishtit edhe atë të kryqëzuar.”

Por jo vetëm predikimi i tij përqendrohej te kryqi; shumë më e rëndësishme që se ai e kish përjetuar kryqin në jetën e vet, ashtu siç shkruan te Galatasve 6:14

“Sa për mua, kurrë mos qoftë që unë të mburrem, veçse për kryqin e Zotit tonë Jezu Krisht, nëpërmjet të cilit bota më është kryqëzuar edhe botës.”

Pali kishte aq shumë fëmijë frymërorë në Korint, pasi lajmi i tij drejtohej nga kryqi dhe kryqi u vërtetua në vetë jetën e tij, ndërkohë që ai ia kishte nënshtruar ambicien personale dhe egoizmin një procesi pa kompromis të vetëkryqëzimit.

## Atësi frymërore

Si kontrast, një mesazh pa kryq i një predikuesi të pakryqëzuar nuk mund të sjellë ato lloje fëmijësh frymërorë që Perëndia i dhuroi Palit në Korint.

### Pali, Sila dhe Timoteu

Pamë se Pali, Sila dhe Timoteu na u paraqitën te 1 Thesalonikasve si etër frymërorë. Pali u shkruan thesalonikasve:

“Ju jeni dëshmitarë, edhe Perëndia, si jemi sjellë të shenjtë, të drejtë dhe pa të meta, me ju që besoni, siç e dini sikundër këshilluam, ngushëlluam dhe iu përgjëruam secilit prej jush, si bën një atë me bijtë e vet, që të ecni denjësisht ndaj Perëndisë, që ju thërret në mbretërinë dhe lavdinë e tij.”

(1 The. 2:10-12)

Këtu Pali nxjerr në pah dy aspekte të sjelljes së tre burrave. Së pari: Shembullin e tyre. Jeta e tyre ishte e “patëmetë”. Së dyti: Ata kishin zemër atërore për thesalonikasit. Ata u paraqitën nxënësve të tyre standardin më të lartë dhe u bënë thirrje e i paralajmëronin për të arritur këtë standard. Ashtu si prindërit natyrorë janë krenarë për sukseset e fëmijëve të tyre, kështu edhe këta tre burra dëshironin patjetër të shihnin se si nxënësit e tyre do të bëheshin kristianë të suksesshëm dhe të frytshëm.

### Çfarë Cilësish?

Po të përmbledhim cilësitë më të rëndësishme të karakterit të tre burrave të sipërpërmendur, do të kishim pak a shumë këtë rezultat:

Besim i Patundur  
Bindje e menjëhershme dhe e pakufizuar  
Shpallja e një mesazhi të drejtuar nga kryqi  
Aplikimi i kryqit në jetën personale  
Sjellje e paqortuar kristiane  
Dashuri atërore për besimtarët e rinj

Zelli për t' u kujdesur për suksesin e tyre  
Atësi praktike: Adoptimi

Një lloj tjetër atësie duhet ta pozicionojmë diku aty midis atësisë së natyrshme trupore dhe asaj thjesht frymërore për të cilën folëm më lart. E kam fjalën për adoptimin e fëmijëve, prindërit e të cilëve nuk munden ose nuk duan të kujdesen për ta – duke i marrë nën kujdestari e patronazh apo duke i adoptuar de fakto sipas të gjitha rregullave ligjore.

Në lidhje me këtë, më vjen herë pas here në mendje përcaktimi i Jakobit mbi shërbesën e pëlqyer nga Perëndia :

“Feja (shërbesa) e pastër dhe e patëmetë përpara Perëndisë, Atit është kjo: të vizitosh jetimët dhe të vejat në shtrëngimet e tyre dhe ta ruash veten të panjollë nga bota.”

(Jak. 1:27)

Ju lutem të vini re ndryshimin midis shërbesës dhe shpëtimit. Shpëtimit e bëri Perëndia për ne. Ne i kundërpërgjigjemi Perëndisë duke i dhënë nder me anë të shërbesës. Shërbesa jonë është përgjigje e shpëtimit të Perëndisë.

Kohët e fundit më vijnë shumë shpesh në mendje këto vargje të Jakobit. Më duket çudi e madhe që miliona kristianë, lexues të Biblës, nuk paskëshin dëgjuar kurrë se ç' thotë Jakobi në këto vargje. Në përshkrimin e llojit të shërbesës së pëlqyer nga Perëndia, ai ia nis me anën pozitive – d.m.th. me gjërat që Perëndia pret nga ne. Së pari, Jakobi përmend vizitën – mbajtjen dhe kujdesin për – jetimët dhe të vejat. Pastaj ai vazhdon me anën negative dhe e mbyll duke paralajmëruar lexuesit, “... ta ruash veten të panjollë nga bota.”

Për më shumë se pesëdhjetë vjet kam dëgjuar predikime të ndryshme nga gjithfarë folësish. Kam dëgjuar shumë mesazhe të zjarrta mbi rëndësinë e mbajtjes pastër të vetvetes. Por nuk mbaj mend të kem dëgjuar as edhe një predikim të vetëm mbi detyrimin tonë për t' u kujdesur për jetimët dhe të vejat.

Mirëpo Bibla nënvizon në mënyrë të vazhdueshme, si në Dhjatën e Vjetër, ashtu edhe në Dhjatën e Re, përgjegjësinë për kujdesin ndaj



jetimëve dhe të vejave. Duke analizuar mesazhet e profetëve në Dhjatën e Vjetër, arrita në përfundimin se ka tre mëkate kryesore që fyejnë Perëndinë. I pari është idhujtaria; i dyti, tradhtia bashkëshortore; i treti, dështimi të kujdesi ndaj të vejave dhe jetimëve. Mua më duket se Perëndia këto tre mëkate i mat me të njëjtin kut.

Është e vërtetë se dy të parët janë mëkate të kryera me dashje, ndërsa i treti duket vetëm si një mëkat i lënies pas dore. Por kjo nuk ia pakëson atij rëndësinë. Ne shpallemi njësoj fajtorë, si për ato vepra të mira që nuk i bëmë, po ashtu dhe për gjërat e këqia që bëmë.

Sigurisht që nuk na mungojnë rastet për kujdes ndaj jetimëve dhe të vejave; bota është e mbushur plot me ta. Në kohën e botimit të këtij libri, vetëm në Ugandë kemi miliona jetimë nga SIDA. Dhe ky është vetëm një vend relativisht i vogël në kontinentin e gjerë afrikan. Kur epidemia e SIDA-s të shpërthejë edhe në nënkontinentin e Indisë, pasojat e saj do të jenë akoma më asgjesuese sesa në Afrikë.

Disa kristianë të Perëndimit ndoshta mendojnë se: “Ky është problem i kombeve të prapambetura e të paqytetëruara. Ne nuk mbajmë përgjegjësi për to.”

Unë nuk jam i këtij mendimi. Unë besoj se jam ruajtësi i vëllait tim, pavarësisht nga ngjyra e lëkurës apo vendi prej nga vjen. Po ashtu, edhe problemi i jetimëve dhe të vejave nuk kufizohet vetëm brendapërbrenda vendeve të botës së tretë. Ky problem është po aq i rëndë edhe në kombet e Perëndimit, vetëm se në një formë tjetër. Në kapitullin 12, tërhoqa vëmendjen se po përballemi gjithnjë e më shumë me të rinj pa prindër – numri i tyre ka arritur miliona. Këta fëmijë janë në “robëri”, sepse baballarët e tyre kanë flakur tej përgjegjësinë. Fjalori gjuhësor këta fëmijë nuk i përcakton si jetimë, por halli i tyre është po aq i madh.

Shkatërrimi progresiv i familjeve në Perëndim po prodhon gjithnjë e më tepër fëmijë që rriten vetëm me një prind. Në rastet më të shumta ky prind nuk është babai, por nëna. Disa janë të mendimit se vështirësitë lindin për shkak të sjelljes mëkatore të nënave. Është e vërtetë se shumë fëmijë të nënave beqare kanë lindur jashtë martesë. Mirëpo, në cilin ungjill thuhet se Jezusi na ndaloka të tregojmë dhembshuri për mëkatarët? Përveç kësaj, këta fëmijë pa prindër janë ata që vuajnë më tepër – dhe ata nuk kanë mëkatuar. Shtoj këtu se

një shumicë e mirë grash kanë mbetur të vetme jo për faj të tyre. Ato ishin martuar ligjërisht, u lindën burrave të tyre një apo më shumë fëmijë dhe pastaj u braktisën pa ndonjë arsye konkrete.

E megjithatë, trupi i Krishtit në ditët tona as që ia vë veshin numrit gjigand të nënave të vetme. E përfytyroj mirë se Jezusi do të na thoshte po atë që tha edhe në kohën e Isaias:

“Lahuni, pastrohuni, largoni nga prania ime ligësinë e veprimeve tuaja, mos bëni më keq. Mësoni të bëni të mirën, kërkoni drejtësinë, ndihmoni të shtypurin, sigurojini drejtësi jetimit, mbronni çështjen e gruas së ve.”

(Isaia 1: 16-17)

Disa kristianë do të pohonin pa pikën e dyshimit se fjalët e fillimit nuk kanë të bëjnë fare me ta. Por, siç e thashë, ne jemi të gjithë fajtorë, si kur lëmë pas dore diçka, po ashtu edhe kur bëjmë të keqen. Nuk duhet të harrojmë se Isaia u drejtohet njerëzve që e mbanin veten për shumë besimtarë, të cilët Perëndia i kishte paralajmëruar para pak kohe:

“Mos sillni më blatime të kota; temjani është neveri për mua; nuk mund t’i duroj të hënat e reja dhe shabatet, thirrjen e asambleve dhe paudhësinë bashkë me kuvendet solemne.” (v. 13)

Te Luka 6:46 Jezusi u bën një akuzë të ngjashme njerëzve të asaj kohe. Ai i qortonte ata jo për atë që bënë por për atë që nuk bënë: “Pse më thërrisni: ‘Zot, Zot! Dhe nuk bëni atë që ju them?’ ”

Shumë njerëz në kulturën tonë perëndimore reagojnë me cinizëm ndaj krishtërimin dhe e mbajnë atë për një mbeturinë të së kaluarës. Kanë ndjesinë se krishtërimi nuk ofron asgjë në lidhje me problemet e sotme. Këtyre njerëzve nuk u bëjnë përshtypje predikimet. Ata duan të shohin se si ungjilli u sjell rezultate pozitive, praktike.

Një kontribut i dukshëm, objektiv që mund të japë bashkësia, do të ishte edhe tregimi në forma të ndryshme i atësisë, ashtu siç e kemi trajtuar deri tani. Një shumicë të rinjsh në ditët tona e kuptojnë se u mungon diçka në jetë. Atë, ata janë duke e kërkuar në vende të

## Atësi frymërore

ndryshme: te droga, tek alkoholi, te grupet gangstere dhe klikat, tek okultizmi, te fetë e dyshimta dhe te lojrat e dhunës në kompjuter. Por në fakt, ata pa e ditur janë duke kërkuar një atë.



## Ku Janë Etërit Frymërorë?

Në dy dekadat e fundit të shek. të 20-të, dy ungjilltarë me famë botërore bënë analiza të kujdesshme në lidhje me njerëzit që u ishin përgjigjur predikimeve të tyre gjatë fushatave ungjillizuese dhe ishin regjistruar si të kthyer në besimin kristian. Për paraqitjen dhe organizimin e këtyre fushatave, si edhe për kujdesin ndaj të porsakthyerve në besim, duheshin asistentë të panumërt dhe shuma tepër të mëdha parash. Mund të themi se nuk u kursyen as lodhja e as të hollat. Por rezultatet e analizave qenë tronditëse. Njëri nga ungjilltarët arriti në përfundimin se vetëm 5% e të porsakthyerve ishin bërë kristianë të përkushtuar; tek ungjilltari tjetër vetëm 3%.

Po theksoj këtu se këto shifra në përqindje nuk rezultojnë nga ndonjë institut laik (i botës jobesimtare) i cili ka paragjykime kundrejt ungjillizimeve. Në të dyja rastet analizat u bënë nga vetë organizatat e ungjilltarëve. Dua gjithashtu të nënvizoj se nuk dua të kritikoj asnjërin prej ungjilltarëve. I çmoj shumë që të dy si vëllezër të qëndrueshëm në Zotin.

Mirëpo këtu duhet shtruar pyetja se ç' do të ndodhte nëse një firmë e zakonshme biznesi, e cila ka investuar shuma të mëdha në një projekt, do të nxirrte vetëm 5% ose më pak të fitimit që pritej. Jam pothuajse i sigurt se kjo firmë do të falimentonte. A nuk do të ishte e ndershme të arrinim në përfundimin se Trupi i sotëm i Krishtit, ashtu siç e tregon statistika, ka falimentuar frymërisht?

Nuk mund të themi se mungesa e rezultateve të pritura u shkaktoi nga defekte në lajmin e predikuar ungjillor. Që të dy ungjilltarët theksuan qartë dhe prerë domosdoshmërinë e rilindjes dhe përshkruan qartë rrugën e shpëtimit. Ndoshta pati një pikë ku predikimi nuk arriti sa duhet standardin e Dhjatës së Re: Nuk u vu theksi i duhur te gjyqi i Perëndisë mbi mëkatin. Por vetëm kjo pikë nuk do të mjaftonte për të shpjeguar mungesën e përhershme të frytit të këtyre ungjillizimeve.

Sipas vlerësimit tim, arsyeja kryesore e këtyre rezultateve zhgënjese duhet kërkuar te gjendja e përgjithshme e bashkësisë së sotme. Në kohën kur isha pastor, unë njëherë u angazhova të ndihmoj si udhëheqës frymëror në shoqërimin e të porsakthyerve, gjatë një fushate ungjillore e cila raportonte suksese të bujshme. Ne, udhëheqësit frymërorë, jo vetëm që duhet të flisnim gjatë takimit me të interesuarit, por, përveç kësaj, duhet të mbanim kontakt të vazhdueshëm me njerëzit që kishim nën kujdes – me anë telefonatash, letrash ose ftesash për takime personale. Unë personalisht shoqëroja 22 veta, për të cilët mbaja ditar të hollësishëm. Në fund, pasi kisha përdorur çdo mjet që më ishte vënë në dispozicion për shoqërimin frymëror të të porsakthyerve, arrita në përfundimin se vetëm dy persona u bënë kristianë të devotshëm. Që të dy u bënë anëtarë të bashkësisë sime. Për vite me radhë unë vrojtoja jetët e tyre. Ata u bënë kristianë të qëndrueshëm e të frytshëm.

Ku qëndronte suksesi i këtyre të dyve? Me siguri jo te fakti se unë udhëhiqja ndonjë bashkësi të madhe, imponante. Në asokohe kishim vetëm pesëdhjetë anëtarë! Sipas përfundimit që arrita, vendimtar qe fakti se u ofrova atyre të dyve, ashtu si munda, një lloj atësie frymërore.

Duke kërkuar arsyet se përse ata njëzet personat e tjerë nuk u poqën për t'u bërë besimtarë të përkushtuar, arrita në këtë përfundim: Ata ose nuk u lidhën fare me një bashkësi ose u lidhën me ndonjë bashkësi që nuk u ofroi atësi frymërore. Një reporter kristian e komentoj me këto fjalë situatën e atëhershme: "S'ka kuptim të marrësh një pulë të ngordhur për të ngrohur një zog të gjallë!"

## Krishtërim apo Kishërim?

Kanë kaluar pothuajse njëzet shekuj qysh nga koha kur Jezusi ngarkoi dhe dërgoi apostujt e parë. Që nga ajo kohë ka ndodhur pothuajse pa u ndier një ndryshim tronditës në radhët e krishtërimin. Krishtërimi është zëvendësuar nga kishërimi. Kishërimi prodhon anëtarë kishë; krishtërimi prodhon dishepuj. Kishërimi i bën besimtarët konformist. Krishtërimi i bën besimtarët të përkushtuar. Pjesa më e madhe e kristianëve të kohës sonë nuk e kanë fare idenë se sa shumë janë shmangur nga origjinali dhe standardet e ungjillit. Ata kanë krijuar një përfytyrim për krishtërimin nga ajo që shohin në kishën moderne.

Kur Jezusi dërgoi apostujt e parë, Ai u dha atyre udhëzime të qarta: “Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj të gjithë kombet” Mateu 28:19. Para kësaj Ai kish bërë një përcaktim më se të qartë se çdo të thotë të jesh nxënës (dishepull):

“Dhe turma të mëdha shkonin me të. Dhe u kthye dhe u tha atyre: ‘Nëse ndokush vjen tek unë dhe nuk urren atin e vet dhe nënën, gruan, fëmijët, vëllezërit dhe motrat, madje edhe jetën e vet, nuk mund të jetë dishepulli im. Dhe kush nuk e mbart kryqin e vet dhe nuk vjen pas meje, nuk mund të jetë dishepulli im.’”

(Luka 14:25-27)

Ky pasazh bën një kontrast të theksuar midis dy lloj njerëzish: nga njëra anë, turma e madhe që “shkonin me të” dhe nga ana tjetër, personi i veçantë i cili “vjen pas meje” (fjalët e Jezusit). Kishërimi kënaqet me turmat e mëdha që shkojnë me Jezusin. Krishtërimi fokusohet te çdo individ që ndjek Jezusin. Ai nuk ka interes të prodhojë “miq bashkudhëtarë”, por ndjekës të përkushtuar.

Nga përvoja e përshkruar më sipër si udhëheqës frymëror, si edhe nga disa rrethana të tjera të ngjashme, arrita të dalloj se për t’i bërë të porsakthyerit në besim kristianë të përkushtuar duhet të aplikojmë atësi frymërore. Janë të rralla ato raste kur i porsakthyeri arrin një nivel më të lartë frymëror sesa niveli i kishës ku ai bën pjesë. Aty ku nuk praktikohet atësi frymërore, pjesa më e madhe e të porsakthyerve

do të mbeten jetimë në frymë, nuk do të arrijnë të piquen për t' u bërë anëtarë të frytshëm të familjes së Perëndisë.

Në kapitullin 12, "Kur Etërit Dështojnë", përshkrova tiparet karakterizuese të të rinjve të cilëve u mungojnë etërit e vërtetë: mungesë disipline, mungesa e një qëllimi të qartë, mungesë rezistence ndaj çdo lloj joshjeje satanike dhe rruge të gabuar. Në disa aspekte edhe Trupi i Krishtit nuk ndryshon shumë nga bota. Shumë të rinj që thonë se janë të shpëtuar, nuk dallojnë kushedi çfarë prej moshatarëve të tyre jobesimtarë. Edhe ata nuk kanë një synim të qartë në jetë. Lëkundën sa andej-këndej, kur bëhet fjalë për çdo modë të re në fjalor, veshje, argëtim, po, madje edhe në stilet e adhurimit. Disa nga këta të rinj e përdorin adhurimin për t' i dhënë shprehje egoizmit të tyre. Ata rrallë dallojnë aty një takim personal me Perëndinë e shenjtë, të denjë për t' u respektuar. Përgjithësisht atyre u mungojnë dy gjëra në jetë: qëndrueshmëria dhe një qëllim i përcaktuar.

Rinia e kohës sonë, si ajo e botës, ashtu dhe ajo e bashkësisë, ka këto tre gjëra të përbashkëta:

### Zhgënjimin

Së pari, ata janë të zhgënjyer — mbi gjendjen e shoqërisë, mbi gjendjen e planetit tonë dhe mbi mungesën e drejtësisë shoqërore dhe kujdesit për më të dobëtit. Ata kanë ndjesinë se brezat e mëparshëm i kanë lënë në baltë dhe u kanë trashëguar probleme që duken si të pazgjidhshme.

Si përfaqësues i brezit paraardhës, më duhet të pranoj se të paktën në këtë pikë, këta të rinj kanë të drejtë. Ne po u lëmë atyre si trashëgim një kulturë dhe shoqëri që në shumë aspekte janë produkt i mëkateve tona — lakmi, egoizëm, indiferentizëm ndaj të dobëve dhe të varfërve. Megjithëse shumë prej nesh e quajnë veten kristianë, kemi përçmuar përmbushjen e kriterit të parë të një "shërbese të pastër e të panjollë": kujdesin ndaj jetimëve dhe të vejave. Nëse do të mundoheshim t' i ngulisnim me forcë brezit të ri standardet e besimit kristian, ata më shumë të drejtë do të na e kthenin: "Zbatoni njëherë vetë atë që predikoni; pastaj ju dëgjojmë se ç'keni për të thënë."



### **Kërkimin e Arit të Kulluar**

Karakteristikë për rininë e sotme është se ajo është në kërkim të vlerave origjinale. Po t' u afrojmë ar, ata do të marrin një thikë dhe do të gërryejnë në thellësi për të parë nëse ky është ar i pastër apo thjesht një metal pa vlerë, i larë në flori.

Nga të shtatë kishat e përshkruara te Zbulesa 2 dhe 3, mundet që kisha e Laodicesë të ketë ngjashmërinë më të madhe me Trupin e sotëm të Krishtit në botën perëndimore. Me siguri, ju kujtohet se Jezusi i thotë kësaj bashkësie: “Të këshilloj të blesh nga unë ar të kulluar në zjarr...” (Zbu. 3:18). Bashkësia e ditëve tona ka shumë ar të parafinuar në zjarr. Ne predikojmë me fjalë të zgjedhura dhe bëjmë pohime të fryra, por shumë shpesh ky ar nuk e përballon dot provën e zjarrit.

### **Radikalizmi**

Karakteristika e tretë e të rinjve të sotëm është radikalizmi. Ata nuk kënaqen me përgjigje të thjeshta e të sipërfaqshme. Atyre nuk u bëjnë përshtypje rregullat e sjellshme shoqërore apo traditat e nderuara. Në njëfarë mënyre, ata nuk kanë asgjë të shenjtë. Nëse një pemë jep fryte pa shije ose nuk jep fare fryt, ata reagojnë pa e zgjatur shumë: “Priteni!” (Ndaj predikimit të Gjon Pagëzorit ata do të kishin reaguar shumë pozitivisht!) Kjo klithmë e dëshpëruar dhe e paartikulluar dëshmon nevojën e tyre për një realitet atësie frymërore.

### **Nga Dobësia Në Forcë**

Duke arritur në këtë pikë, më duket sikur ju dëgjoj të ankoheni: “Por kërkesat tuaja ndaj një ati frymëror janë shumë të larta! Unë nuk do të bëhem dot kurrë si Abrahami apo Pali.”

Ashtu është, standardet e Perëndisë janë të larta. Ai kurrë s'ka për t' i ulur ato. Por edhe diçka tjetër është e vërtetë: Hiri i Perëndisë është i mjaftueshëm për ju. Për çdo përgjegjësi të dhënë, Perëndia jep edhe hirin e duhur për realizimin e kësaj përgjegjësie.

Abrahami dhe Pali nuk jepen te Shkrimi si standard për t' u arritur, por si shembull për tu ndjekur. Te Romakeve 4:12, Pali thotë se Abrahami është ati ynë nëse “ecim në gjurmët e besimit të tij.” Me

fjalë të tjera: Abrahami hapi një shteg besimi dhe gjithë besimtarët janë të thirrur t'i shkojnë atij pas.

Lexuam tashmë paralajmërimin e Palit: "Jini imitues të mi, ashtu si unë jam i Krishtit" (1 Kor. 11:1). Nëse hiri i Perëndisë e shndërroi Saulin, përndjekësin e kishës, në Pal, ndjekës i Krishtit, Ai mund t'ju shndërrojë edhe juve në imitues të Palit. Apostulli thotë te 1 Tim. 1:16, se kjo ishte arsyeja e vërtetë e shpëtimit të tij: "...që Jezu Krishti të tregojë së pari në mua gjithë zemërgjerësinë, për të qenë shembull për ata që do të besojnë në të për jetë të përjetshme."

Me pak fjalë, Pali thotë: "Nëse Perëndia arriti të më ndryshonte mua, Ai mund të ndryshojë këdo!" Dhe mos harroni se si Abrahami, ashtu edhe Pali, patën momente dobësie. Abrahami bëri disa gabime shumë të rënda. Ai arriti në një pikë aq të thellë dëshpërimi ngaqë Sara nuk po i lindte dot një mashkull dhe trashëgimtar, saqë shkoi dhe ngjizi një djalë me shërbëtoren e së shoqes. Më vonë, për të shpëtuar lëkurën e tij, i tha Abimelekut, mbretit të Gerarit se Sara ishte e motra dhe lejoi kështu që e shoqja të hynte në haremin e Abimelekut. Vetëm ndërhyrja e mbinatyrshme e Perëndisë pengoi që Sara të bëhej një nga gratë e Abimelekut (shih Zan. 20).

Por Perëndia asnjëherë nuk e hodhi poshtë Abrahamin. Dhe kështu në fund të fundit, Perëndia me hirin e tij e bëri Abrahamin ashtu siç e pati premtuar. Edhe Pali pati çaste dobësie të skajshme. Te 2 Kor. 1:8-9 Pali tregon për veten dhe shokët e tij:

"Sepse nuk duam, o vëllezër, që të mos dini për shtrëngimin që na ndodhi në Azi, ku u renduam tepër përtej fuqive tona, aq sa u dëshpëruam edhe për jetën. Për më tepër ne e kishim në veten tonë vendimin e vdekjes, që të mos besonim në veten tonë, por në Perëndinë që ringjall të vdekurit."

Perëndia lejoi te Pali këtë pikë dobësie të jashtëzakonshme, me qëllim që të arrinte deri aty sa të mos besonte më te vetja, por vetëm te Perëndia që është në gjendje të ngjallë edhe të vdekurit.

Pak më tutje, po te kjo letër, Pali përshkruan se si arriti të kuptojë se forca e Perëndisë bëhet e përkryer në dobësinë tonë. Më në fund, ai nxjerr përfundimin:

## Ku janë etërit frymërorë?

“Sepse, kur jam i dobët, atëherë jam i fuqishëm.”

(2 Kor. 12:10)

Është e vërtetë, Abrahami dhe Pali na jepen si shembuj etërisht frymërorë. Por ata u bënë etër frymërorë vetëm pasi dështuan në aftësitë e tyre njerëzore dhe ia besuan veten krejtësisht hirit të mbinatyreshëm të Perëndisë. Kjo ka vlerë edhe sot. Një burrë mund të bëhet atë frymëror vetëm atëherë kur reagon ndaj një dëshire që Perëndia ka futur në zemrën e tij dhe kur atij i shterojnë gjithë rezervat njerëzore. Pikërisht atëherë ai mbështetet te aftësimi mbinatyror i Perëndisë.

Te Mateu 4:19 Jezusi i thotë Pjetrit dhe Andreas: “Ejani pas meje dhe do t’ju bëj peshkatarë njerëzish”. Ky parim e ruan vlerën deri në ditët tona: Vendimtare në jetën tonë nuk është ajo që kemi nga vetvetja, por ajo që bën Jezusi te ne kur e ndjekim pas.

A shihni rreth jush të rinj, jeta e paqëndrueshme dhe pa drejtim e të cilëve është një klithje e heshtur për ndihmë? Keni arritur të kuptoni se ata kanë nevojë për një atë frymëror? A keni dëshirë t’i ndihmoni? Atëherë duhet të kuptoni se vetë Perëndia jua ka futur këtë dëshirë në zemër. Ai dëshiron që ju të bëheni një atë frymëror.

Kur ta keni kuptuar se cili është plani i Perëndisë për ju, nuk ka më shumë rëndësi se ç’jeni nga vetvetja. Rëndësi ka ajo që bën te ju Perëndia, kur ju i dorëzoheni Atij pa kushte. Thuajini Perëndisë se viheni në dispozicion ashtu si ta ndieni dhe ashtu si t’ju vijjnë fjalët. Pastaj mësoni çdo gjë në dorë të Tij!



## Një Fjalë Për Ata Që Nuk Kanë Etër

Duke lexuar kapitujt e mëparshëm, ndoshta keni dalë në përfundimin se ju nuk keni njohur kurrë një atë si atë që përshkrova deri tani. Nëse kjo është vërtetë, unë ju siguroj se si ju në këtë botë ka me miliona.

Natyrisht, secili prej nesh ka një atë biologjik, dikë prej të cilit vjen jeta jonë fizike. Por kjo nuk garanton kurrsesi se ne kemi një atë siç përshkruhet në Bibël dhe siç u mundova ta paraqes unë. Në të vërtetë, sot janë të rrallë në botë ata etër që ngjasojnë me këtë përshkrim!

Nëse nuk keni pasur një atë të tillë, shumë thellë brenda jush ndieni një boshllëk – një zbrazëtitirë që nuk është mbushur kurrë. Ka të ngjarë që ky boshllëk ka ekzistuar brenda jush prej një kohe kaq të gjatë, saqë nuk e vini më re. Megjithatë, ai ekziston brenda jush dhe për këtë shkak juve ju mungon diçka themelore si person.

Me këtë nuk dua të them se na nevojitet me çdo kusht një atë i përsosur. Vetëm një është Atë i përsosur – Ati Perëndi në qiell. Por një atë tokësor që përputhet me përshkrimin e Biblës e mbush këtë zbrazëti brenda jush edhe pse në shumë aspekte ai mund të jetë i papërkryer. Pra, ju nuk jeni pa një atë. Ju e dini nga përvoja se ç' do të thotë të kesh një atë.

Mirëpo, siç thashë, ka miliona që nuk e dinë këtë.

A mund t'ju ndihmoj sadopak duke treguar nga jeta ime personale?

Im atë, ashtu si çdo mashkull i rrethit tonë familjar, ka qenë oficer i ushtrisë britanike. Ai ishte një burrë me moral të lartë, i ndershëm dhe besnik ndaj detyrës – shkurt, një ushtar i zellshëm. Duke qenë se ai shërbente në trupat britanike të stacionuara në Indi, edhe unë linda atje, në qytetin Bangalore.

Kur linda, mjeku i tha nënës sime se ajo duhet t'i hiqte shpresat për të pasur fëmijë të tjerë. Kjo do të thoshte se unë do të rritesha pa motra e vëllezër. Prandaj, prindërit e mi menduan se kjo mungesë mund të plotësohej vetëm nëse im atë do të sillej me mua më shumë si një vëlla i madh, sesa si atë. Me sa duket, ata mendonin se një vëlla kishte për mua më shumë rëndësi sesa një atë. Për këtë arsye unë nuk e thërrisja atë kurrë me fjalët “atë” ose “babi”, por vetëm me emrin Peter. Nuk kam dyshuar asnjëherë në dashurinë e tij, por ai nuk tregoi kurrë ngrohtësi prindërore kundrejt meje. Nuk mbaj mend të më ketë marrë ndonjëherë në prehër ose të më ketë përkëdhelur.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, në moshën 25-vjeçare, pata një takim personal me Jezu Krishtin në një dhomë kazermë të ushtrisë britanike. Si rrjedhojë e kësaj, u bëra kristian i përkushtuar. Kjo përvojë më hapi sytë për realitetin e pushteteve frymërore, ndaj të cilave deri në atë çast kisha qenë i verbër.

Më ra në sy veçanërisht se India, vendlindja ime, ishte vorbulla e një mase marramendëse pushtetesh jashtëzakonisht të fuqishme frymërore – sigurisht jokristiane. Më dukej sikur disa prej këtyre pushteteve frymërore nga India më kishin ndjekur pas gjithë jetën dhe ishin përpjekur të fitonin kontroll mbi mua. Këtë nuk e arritën kurrë, por unë nuk mundesha t'i shpëtoja plotësisht ndikimit të tyre. Madje, para se të bëhesha kristian i bindur, kisha luajtur disa herë me mendimin për t'u bërë Yogi.

Duke studiuar Biblën si kristian, mësova se nëpërmjet rilindjes, Perëndia është bërë Ati im. Më vonë mbajta një predikim tri-pjesësh në gjuhën angleze, me titull “Knowing God as Father” (Të Njohësh Perëndinë si Atë). Shumë njerëz erdhën dhe më thanë se ky mesazh i kishte ndihmuar së tepërmi. E megjithatë unë predikoja, pa e ditur, thjesht një teori. E kuptoja shkëlqyeshëm këtë temë në teori, por më mungonte përvoja praktike e njohjes se Perëndisë si Atë. Madje, as që e kisha idenë se jetës sime i mungonte diçka.

## Një Zbulesë Personale

Por në 1996, pak kohë pasi kisha festuar 50-vjetorin e jubileut në shërbesë, Perëndia ndërhyri në jetën time. Një mëngjes, si zakonisht, kur Ruthi dhe unë ishim ulur në shtrat për t'u lutur, u preka papan-dehur nga pushtete të mbinatyrshme. Në atë moment u bëra shesh beteje i dy pushteteve frymërore kundërshtare.

Nga pas ishte ngritur mbi mua një krah i padukshëm, i cili mbante një diçka që dukej si kapuç i zi dhe që përpiqej të ma vinte këtë kapuç me forcë mbi kokë. Njëkohësisht, edhe Fryma e Shenjtë nisi të lëvizë nëpër trupin tim. Ajo ngjitej brenda meje duke nisur nga këmbët. Trupi filloi të më shkundej me forcë. Më vonë Ruthi më tha se fytyra ime ishte bërë e kuqe si zjarr. Kisha përshtypjen se këto dy pushtete frymërore bënë luftë me njëri-tjetrin. Fuqia e Frymës së Shenjtë që ngjitej nga poshtë-lart luftonte kundër krahut sipër që mundohej të më ngjeshte në kokë me forcë kapuçin e zi.

Më në fund fitoi Fryma e Shenjtë. Krahu me kapuçin e zi u tërhoq pas dhe u zhduk. Njëkohësisht, Fryma e Shenjtë fitoi kontroll mbi trupin tim dhe unë pata një ndjenjë të mrekullueshme paqeje dhe qetësimi.

Në të njëjtën kohë, pa arsytuar shumë, konstatova se për herë të parë në jetën time u gjenda në një marrëdhënie të ngushtë intime me Perëndinë si Atë dhe në atë çast për mua ishte gjëja më e natyrshme në botë t'i drejtohesha Atij me fjalën "Atë". Tanimë ky nuk ishte një titull teologjik por shprehje spontane e një marrëdhënieje personale.

Më pas, kur po mendoja në qetësi mbi këtë ndodhi, nxora përfundimin se krahu me kapuçin ishte manifestim i Shivës, njërit prej tre "Perëndive kryesore" të fesë hinduiste (që në të vërtetë nuk janë Perëndi, por pushtete të këqija satanike të botës qiellore).

Interpretimi im për atë që ndodhi u vërtetua qartë kur dy vite më vonë më ra rastësisht në dorë një përshkrim i "tre Perëndive kryesore" të Hinduizmit. Aty Shiva përshkruhej si një pushtet frymëror i cili zbret mbi një person dhe e izolon atë nga realitetet e botës qiellore. Pikërisht këtë donte të bënte ai krah i shtrirë nga mbrapa mbi kokën time. Jam pafundësisht mirënjohës që Fryma e Shenjtë më erdhi në ndihmë në këtë çast të vështirë dhe dëboi pushtetin e lig që deshi të merrte kontroll mbi mua!

Që nga ky përjetim në vitin 1996, marrëdhënia ime me Perëndinë Atë bëhet gjithnjë e më fortë dhe më e thellë.

## Një Marrëdhënie e Re

Kjo marrëdhënie e re ka një ndikim të thellë e të vazhdueshëm në jetën time. I kam shërbyer Krishtit sa më mirë që të ishte e mundur në këto pesëdhjetë vjet; Perëndia e bëri shumë të frytshëm shërbymin tim gjatë kësaj kohe. Por duke hyrë në një marrëdhënie të re me Perëndinë si Atin tim, nisa të provoj një intimitet në marrëdhënien me Të dhe një gradë sigurie që nuk e kisha njohur më parë.

Kjo marrëdhënie e re nuk m'i kurseu ato prova që vijnë në jetën e çdo kristiani, por më bëri të aftë t'u kundërvihesha këtyre provave me një masë më të madhe force të brendshme dhe besimi. Përveç kësaj, këto prova nuk hynë si pykë midis meje dhe Perëndisë; përkundrazi, më lidhën më shumë me Të.

Rreth tre vjet pas kësaj ndodhie të përshkruar më sipër, pata një nga përvojat më të dhimbshme të jetës sime kristiane. Pas një qëndrimi njëmuor në stacionin intensiv, Perëndia e mori pranë vetes gruan time të dashur, Ruthin. Humbja që ndjeva ishte e papërshkrueshme. Por gjatë gjithë kësaj kohe, nuk e humba për asnjë çast vetëdijen e pranisë së Atit tim të dashur.

Kur në varrimin e Ruthit, hodha sytë poshtë tek arkivoli me trupin e saj, ndjeva një dëshirë të fortë të thërrisja para gjithë të pranishmëve: "Atë, unë kam besim te ti. Të falenderoj, sepse je gjithnjë i mirë, i dashur dhe i drejtë. Ti nuk bën kurrë gabime. Ti bën gjithnjë më të mirën."

Vetëm vetëdija e marrëdhënies së ngushtë me Atin më bëri të aftë të them ato fjalë. Persona të ndryshëm që kishin qenë të pranishëm, më treguan më vonë se sa shumë i kishte prekur ky pohim.

Sidoqoftë, nuk dua që të krijoni përshtypjen se për të njohur Perëndinë si Atin tuaj personal ju duhet të kaloni nëpër po të njëjtat përvoja. Perëndia e trajton secilin prej nesh në veçanti. Nuk ka një procedurë standarde që duhet ndjekur nga shumica. Megjithatë ka disa parime biblike që vlejné për të gjithë.

Të Mateu 11:27, Jezusi përcakton parimet që duhen zbatuar



## Një fjalë për ata që nuk kanë etër

kur bëhet fjalë për njohjen e tij si Bir i Perëndisë dhe për njohjen e Perëndisë si Atin e Tij.

“Çdo gjë m’u dha në dorë nga Ati im, dhe asnjëri nuk e njeh Birin, përveç Atit; dhe asnjëri nuk e njeh Atin, përveç Birit dhe atij të cilit Biri don t’ia zbulojë.”

Ati dhe Biri bashkëpunojnë me njëri-tjetrin. Në fillim Ati zbulon Birin. Ky është hapi i parë, sepse vetëm përmes Birit arrijmë të njohim Atin. Te Gjoni 14:6 Jezusi thotë, “Askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje.” Pas kësaj vjen hapi i dytë, ku Jezusi zbulon Atin – por vetëm në përputhje me vullnetin e Tij sovran. Jezusi thekson se zbulesa e Atit i jepet vetëm atij që “Biri don t’ia zbulojë.”

Jezusi këtu flet për një zbulësë që mund ta japë vetëm Ai. Po bëj një vërejtje të rëndësishme: ekziston një ndryshim i madh midis njohjes teorike të Shkrimit dhe kuptimit të tij nëpërmjet zbulësës. Për më shumë se pesëdhjetë vjet pranova me zemër të hapur teorinë që pohon se Perëndia është Ati im. Por ishte një gjë krejt e ndryshme kur këtë pohim e mora nga një zbulësë e drejtpërdrejtë personale.

### Nëpërmjet Birit tek Ati

Pasi të keni arritur gjatë leximit deri te këto rreshta të fundit, ndoshta keni nxjerrë përfundimin se nuk keni atë; ju nuk e dini ç’do të thotë të kesh një atë të vërtetë. Tani ndodh diçka në zemrën tuaj – ndieni mall për një atë.

Ka të ngjarë që për shkak të rrethanave të së kaluarës, asnjë qenie njerëzore në këtë jetë nuk do të mund të bëhet atë për ju. Aq më tepër të falenderoni Perëndinë që keni mundësi ta njihni atë si Atin tuaj qiellor! Por, së pari, duhet të njihni Jezu Krishtin si shpëtimtarin tuaj personal, sepse nëpërmjet Tij ju keni marrë dhuratën e jetës së përjetshme.

### 1. Pranoni Jezusin Si Shpëtimtar

Nëse ende nuk e keni këtë siguri biblike, duhet që së pari të pranoni Jezusin si shpëtimtarin tuaj personal. Kjo domosdoshmëri është formuluar qartë te Gjoni 1:11-13:

“Erdhi te të vetët dhe të vetët nuk e pranuan, por të gjithë atyre që e pranuan, ai u dha pushtet të bëhen bij të Perëndisë, atyre që besojnë në emrin e tij, të cilët nuk lindën as prej gjakut, as prej vullnetit të mishit, as prej vullnetit të burrit, por prej Perëndisë.”

Tani, po të doni, mund të bëni një lutje pak a shumë të tillë:

*Zot Jezu Krisht, të pranoj ty si Birin e Perëndisë dhe si të vetmen rrugë për te Perëndia. Besoj se ti vdiqe në kryq për të shlyer mëkatet e mia dhe se u ringjalle së vdekurish. Të lutem të më falësh të gjitha mëkatet dhe unë të pranoj ty me besim si Shpëtimtarin tim. Eja në zemrën time dhe më jep dhuratën e jetës së përjetshme. Amen.*

Nëse e bëni këtë lutje me një besim të thjeshtë, prej fëmije do të thosha, Perëndia premton t’ju dhurojë sigurinë se Ai ju pranon si fëmijën e Tij. Te 1 Gjonit 5:10 apostulli na thotë se “ai, që beson në Birin e Perëndisë ka këtë dëshmi në vetvete.” Përsëri, te Romakët 8:16 Pali na thotë: “Vetë Fryma i dëshmon frymës tonë që jemi bij të Perëndisë.”

Tani filloni të falenderoni Perëndinë që ju pranoi dhe që u bëtë fëmija i Tij. Sa më shumë ta falenderoni, aq më shumë do të bëheni i vetëdijshëm se tani jeni me të vërtetë fëmija i Perëndisë. Fryma e Shenjtë do të dëshmojë për këtë së bashku me frymën tuaj.

## **2. Afrojuni Perëndisë Sikurse Atit**

Tani Jezusi është bërë për ju dera nëpërmjet së cilës i afroheni me guxim Perëndisë. Kështu jeni i hapur për të marrë zbulesën personale të Perëndisë si Atë qiellor, një zbulesë që mund ta japë vetëm Jezusi.

Tregova më sipër se kam jetuar si kristian i rilindur pesëdhjetë vjet para se të merrja zbulesën personale të Perëndisë si Atë. Me këtë nuk dua të them se edhe kristianët e tjerë duhet të presin kaq gjatë! Në fakt, këtë libër e kam shkruar për t’i ndihmuar ata që ta marrin më shpejt këtë zbulesë.

Mirëpo secili nga ne është krejtësisht i varur prej Jezusit. Ai është personi që na e dhuron këtë zbulesë. Jezusi vetë thekson me forcë: “...dhe asnjëri nuk e njeh Atin, përveç Birit dhe atij të cilit Biri don

## Një fjalë për ata që nuk kanë etër

t'ia zbulojë" (Mateu 11:27). Të gjithëve na bën shumë mirë të shkojmë deri në atë pikë ku arrijmë të dallojmë se jemi plotësisht të varur nga Perëndia.

Disa versione bashkëkohore të ungjillit e paraqesin Perëndinë si një automat qiellor: hedhim brenda një xheton, shtypim butonin e duhur dhe ja ku del shpejt e shpejt ajo që kërkuam. Por Perëndia nuk është automat. Ai është një Atë që i disiplinon fëmijët e Tij dhe pret prej tyre standarde të caktuara sjelljeje. Një nga disiplinat që Ai kërkon është që ne të përulemi para Tij: "Perëndia i kundërshton mendjemëdhenjtë, por u jep hir të përulurve" (1 Pjetrit 5:5).

Një tjetër disiplinë që duhet të mësojmë, është të presim Perëndinë. Nuk është e thënë që koha që na volit ne, të jetë edhe momenti i zgjedhur nga Perëndia. "Por ata që shpresojnë [presin] te Zoti fitojnë forca të reja" (Isaia 40:31). Jam munduar disa herë të numëroj gjithë premtimet e bëra për ata persona që janë të gatshëm të presin Perëndinë, por nuk ia dola dot – këto premtime janë aq të shumta!

Sa për veten time, unë besoj se Perëndia priti dhe ma tregoi zbulesën vetëm atëherë kur u sigurova se isha i gatshëm për ta marrë atë. Dhe padyshim, kur Ai ma dhuroi, ky thesar kishte edhe më shumë vlerë pas asaj pritjeje të gjatë!

## Lutuni, Kërkoni, Trokitni

Ka të ngjarë që ju tashmë e njihni Perëndinë si Atin tuaj, njohuri të cilën mund ta japë vetëm Jezusi. këtë unë nuk mund ta gjykoj. Ose ju jeni në po të njëjtat pozita si unë. Nuk keni asnjë hije dyshimi mbi faktin se jeni i rilindur. I shërbeni Perëndisë me gjithë zemër me aq sa dini e me aq sa keni mundësi. E megjithatë keni uri për diçka që kapërcen kufijtë e përvojave ekzistuese – për një marrëdhënie të thellë, intime, të pandërprerë me Perëndinë si Atin tuaj.

Dua t'ju inkurajoj të mos dorëzoheni dhe të këmbëngulni për të arritur deri tek ajo që Perëndia ka bërë gati për ju. Kaloni kohë në praninë e Jezusit. Shprehini Atij gjithë dëshirat më të thella të zemrës suaj. Lutjuni t'ju tregojë nëse ka diçka që ju ndan prej Tij. Jini i gatshëm ta ndiqni Atë pas edhe kur ju çon nëpër shtigje të panjohura. Kushtojani veten tuaj pa asnjë rezervë.

Njëkohësisht, mos u mbërtheni fort pas përfytyrimesh të caktuara përsa i përket takimit me Perëndinë. Në rastin tim, zbulesa e atësisë së Perëndisë erdhi si një përvojë e fuqishme e mbinatyrshme. Por ka mundësi që me ju Perëndia të sillt krejt ndryshe. Ndoshta juve ju ndodh ajo që i ndodhi Elias, kur po priste Perëndinë në malin Horeb (shih 1 Mbretërve 19:11-18).

Në fillim ai përjetoi tre shfaqje fuqie të mbinatyrshme: erën, tërmetin dhe zjarrin. Por Perëndia nuk ishte në asnjërën prej tyre. Këto u pasuan nga një zë si një shushuritje e ëmbël (v.12). Perëndia erdhi tek Elia qetësisht, pa shumë dramë. Por kur Elia e dëgjoi Atë, ai mbuloi fytyrën me gunë në shenjë adhurimi.

Në shushurimën e Perëndisë ka më shumë fuqi sesa në erën më të furishme apo te tërmeti e te zjarri! Ndoshta edhe ju do ta përjetoni kështu Perëndinë.

Sido që të jetë, më lejoni t'ju inkurajoj me një këshillë të Jezusit. Në secilin rast, forma e foljes që ai përdor tregon se bëhet fjalë për një veprim të përseritur ose të vazhdueshëm:

“Lypni dhe do t’ju jepet; kërkoni dhe do të gjeni; trokitni dhe do t’ju hapet.” (Mt. 7:7). Mos harroni, do t’ju jepet; do të gjeni; do t’ju hapet. Në vargun pasues Jezusi vijon me një tjetër fjalë sigurie dhe inkurajimi: “Sepse kushdo që lyp, merr; dhe ai që kërkon, gjen; dhe atij që troket, do t’i hapet.” Këtu përfshihen edhe ju!

Para se ta mbyllni këtë libër, bëni një përmbledhje të temës sonë kryesore:

Tek institucioni i familjes kemi zbulesën më komplekse të Perëndisë të dhënë nëpërmjet njeriut. Dashuria midis burrit dhe gruas pasqyron marrëdhënien midis Jezusit dhe bashkësisë së Tij. Dashuria e një babai për familjen e tij pasqyron dashurinë e Perëndisë për gjithçka që ai krijoi. Me anë të realizimit të planit të Perëndisë për familjen, bëhet e dukshme pasuria më e madhe që ai ka për njeriun. Në rast të kundërt, nëpërmjet refuzimit të planit të Perëndisë për familjen, mjerimi njerëzor arrin kulmin e tij.

Kjo është një temë për të cilën shoqëria jonë moderne duhet të marrë një qëndrim dhe të gjejë një përgjigje. Por është gjithashtu një temë, ndaj së cilës duhet të reagoni edhe ju si individ.







